

ISUF MUSLIU

E FOLMJA E PETRESHTICËS

2010

HYRJE

1. *Nuk ka histori gjuhe pa dialektologji dhe sidomos pa gjeografinë gjuhësore dhe të zbatuar mirë* – thotë gjuhëtari i njohur francez Antuan Meje (Antoine Meillet). Edhe për historinë e gjuhës shqipe, si dhe për gjuhën tonë të zbatuar, dialektologjia ka një rëndësi të dorës së parë, posaçërisht kur dimë që shqipja është njëra nga gjuhët e vjetra të Ballkanit, por e dokumentuar shumë vonë - me përmendoren shkrimore më të rëndësishme “Meshari” të Buzukut në shek. XVI (1555).

Zotërimi i dialekteve të një gjuhe është gjithmonë i domosdoshëm si plotësim i njohurive dhe i zotërimit të asaj gjuhe. Thesari gjuhësor në dialekte është një xeherore e pashtershme të dhënash. Njohja më e thellë e gjuhës shqipe, dhe sidomos njohja e fjalësit të saj, varet nga njohja e fjalëve që rrjedhin nga dialektet e saj (Cimohovski 2004, 25).

Dialektet a të folmet, nën ndikimin e proceseve të fuqishme të globalizimit, po treten si kripa në ujë e po zhduken, po letrarizohen. Prandaj mu për këtë arsye, shumë kohë më përpara dialektologu i njohur Pavle Ivić bënte thirrje të këtillë që ato të studioheshin e të arkivoheshin sa më parë:

“Dialektet tona po vdesin. U është sulur atyre shkolla, radio-televizioni, filmi, gazetat, librat, shërbimi ushtarak... Dialektet tona po bjerren bashkë me opingat, jelekët e qëndisur, kremtet vjetore, bukën e misrit, votrën e zjarrit dhe me shumë elemente të tjera „primitive“. Nuk është humbje ajo që po birret „pasuria e pashtershme e të folmeve tona popullore“, por humbje është në qoftë se ajo pasuri birret e paregjistruar. Sepse dialektet janë dokumente. Ato janë madje përmbledhja më e pasur me të dhëna për të kaluarën e jetës së popullit. Për dallim nga shkencat e tjera, e ngjashëm me etnografinë dhe folkloristikën, dialektologjia është shkencë në „cajtnot“. Ajo që në matematikë nuk zbulohet sot, do të zbulohet nesër, por në dialektologji jo” (Ivić 1990).

2. Përpara një rreziku të tillë ndodhen sot edhe të folmet e Kosovë dhe të folmet

shqipe përgjithësisht. Për këto të folme janë bërë disa hulumtime e studime monografike në rrafshin dialektologjik, ku janë evidentuar karakteristikat e tyre dialektore, por më shumë në rrafsh të përgjithshëm e përshtues.

Për të folmet e Kosovës ende nuk kemi një monografi të plotë sintetizuese a gjithëpërfshirëse, ashtu siç nuk kemi dhe një fjalor të plotë dialektor, onomastik e frazeologjik të këtij regjioni. Idriz Ajeti ka bërë një punim të mirë për ligjërimin shqip të Gjakovës në fillim të shekullit XIX (Ajeti 1998); *Të folmen e Shalës së Bajgorës* e ka bërë objekt studimi Latif Mulaku (L.Mulaku 2005); Ragip Mulaku na jep një studim monografik për *të folmen e Vuçitërnës e të fshatrave përreth* (R.Mulaku 2005), Mehmet Halimi për *të folmen e Karadakut* (Halimi 2008), Imri Badallaj për *të folmen e Hasit* (Badallaj 2001), Naser Pajaziti për *të folmen e Opojës* (Pajaziti 2005), Bajram Mehmeti për *të folmen e Deçanit me rrethinë* (Mehmetaj 2006). Për atë të Rahovecit H. Agani na jep disa të dhëna me interes në studimin e tij “*Fjalori i Ljubomir Kujunxhiçit*” (Agani 1981), që pasqyron të folmen e kësaj ane. *Të folmen e Kaçanikut* e ka bërë objekt studimi Fadil Raka (Raka 1984). *E folmja e Rugovës* trajtohet me një punim monografik nga Adem Hajdaraj (Hajdaraj 1996). Disa skica dialektologjike kemi dhe për të folmet në vijim: *Disa veçori morfologjike të së folmes së lokalitetit të Turiçevcit* (Hasan Kelmendi), *E folmja e lokalitetit të Klinës* (Shaqir Berani), *Vëzhgime mbi të folmen e fshatrave të Lugut të Drinit të Bardhë* (Abdullah Zyberi), *Sistemi foljor i së folmes së Balincës* (Tafil Kelmendi) (SGJ I 1978). Nga studiuesit e huaj, vlen të përmendim këtu vështrimin *E folmja e Kosovës dhe e Metohisë* të dialektologes së njohur ruse Agnia V. Desnickaja, në librin e saj *Gjuha shqipe dhe dialektet e saj*, një fashikull me interes në të cilin bëhet fjalë për tiparet kryesore dialektologjike të këtij areali linguistik shqiptar (Desnickaja 1972, 103). Të folmeve të Kosovës u ka kushtuar një studim special “*Të folmet shqipe gege të lindjes*” dhe C. Tagliavini (Desnickaja 1972, 112).

3. Studiuesit e lartpërmendur me punimet e tyre studimore kanë dhënë një

ndihmesë të mirë për dialektologjinë kosovare, por natyrisht jo gjithëpërfshirëse e shteruese. Kanë mbetur ende pa u hetuar sidomos të folmet e Kosovës qendrore, përkatësisht *ligjërimi i krahinës së Drenicës dhe ai i Lipjanit*. Përkitazi me këto treva janë bërë vetëm disa qëmtime onomastike, është regjistruar një material i pasur toponomastik, i cili kërkon një rishqyrtim më të hollësishëm dhe më të saktë gjuhësor.

Duke pasur parasysh rezultatet e deritanishme dialektologjike, sikundër shprehet me të drejtë albanologu i shquar polak V. Cimohovski (Cimohovski 2004, 25), “*Është e tepërt të bindet kushdoqoftë, se në lidhje me dialektologjinë e shqipës çdo gjë duhet të trajtohet përsëri*”. Kjo më ka dhënë shtysë që dhe unë t’i hyja në punë të tillë dhe të gjurmoja idiomën lokale të Petreshticës, një lokalitet i komunës së Shtimes, që përdalohet me veçori specifike dialektore dhe me thesare të çmueshme gjuhësore, me shpresë se do të kontribuojë sadopak në këtë fushë.

Në hulumtimet e deritanishme dialektologjike të truallit Kosovës kishte munguar një studim më i përimtuar për të folmen e një lokaliteti të veçantë, pra me përqendrim a fokusim në një zonë të caktuar rurale, ku do të shiheshin ruajtjet mbeturinore dhe inovacionet dialektale në përqasje me idiomat e tjera dialektore të Kosovës. Këtë detyrë e kemi marrë në këtë punim tonin, për një idiomë të Kosovës qendrore *E folmja e Petreshticës*, të komunës së Shtimes, të paraqitur dhe si disertacion doktorate në Fakultetin Filologjik të Universitetin e Tiranës (2008), nën drejtimin e mentorit tim Prof. Gjovalin Shkurtaj. Hulumtimet në këtë temë i kam bërë në terren që nga viti 2008-2010, ku kam vjelë një material shumë interesant për fonetikën, morfologjinë, sintaksën, leksikun dhe onomastikën e kësaj zone. Materiali është vjelë nga bisedat e lira, ndërsa një pjesë është nxjerrë me metoda të pyetësorëve. Në këtë punim pasqyrohet kryesisht gjuha e folur e brezit të vjetër përgjithësisht të pashkolluar, nga subjekte që e kanë ruajtur më mirë gjuhën tipike dialektore.

Për hartimin e këtij studimi monografik në radhë të parë do të falënderoja mentorin tim Prof. Gjovalin Shkurtaj, i cili e zgjodhi dhe e frymëzoi interesimin

tim për këtë temë. Po kështu, do të dëshiroja të falënderoja dhe informatorët nga terreni, të cilët e kanë ruajtur deri në ditët e sotme këtë të folme me koloritin e saj të veçantë, dhe nuk u kursyen të më jepnin një lëndë të pasur nga kjo e folme: fjalë e shprehje të rralla, toponime (emra të vendeve), etj.

Për të pasur një tablo më të plotë për arealin e hulumtimit për të folmen tonë në vështrim, këtu më poshtë do të japim një vështrim në vija të përgjithshme për rajonin e Shtimes dhe atë të Petreshticës, në aspektin historik dhe të sotëm të tyre.

KOMUNA E SHTIMES


Pozita gjeografike

4. Komuna e Shtimes gjendet në pjesën qendrore të Kosovës, me një sipërfaqe prej 134 km², gjegjësisht përfshin 1.2 për qind të territorit të Kosovës. Ka rreth 35000 banorë. Vetëm në qytetin e Shtimes jetojnë rreth 12000 banorë. Ka 22 vendbanime rurale dhe qytezën e Shtimes, prej të cilave 13 shtrihen në pjesën kodrinore - malore, ndërsa 9 prej tyre në pjesën rrafshinore.

Shumica e këtyre fshatrave mbajnë emra me burim gjuhësor të serbishtes, si refleks i pushtimit serb të Kosovës për një periudhë të gjatë qindrvjeçare.

Kryqëzimi i akseve rrugore të rëndësishme në relacionet Prizren – Shtime - Prishtinë dhe Prizren-Ferizaj-Shkup i japin kësaj zone karakterin e një zone të hapur. Komuna e Shtimes kufizohet me Komunën e Ferizajt, Lipjanit dhe Suharekës. Qyteti i Shtimes është 31 km larg nga kryeqendra e Kosovës Prishtina, 48 km nga Prizreni dhe 13 km nga Ferizaj. Shtimja është udhëkryq i rrugëve regjionale, këtë segment duhet ruajtur dhe zgjeruar edhe gjatë hartimit të Planit Gjeneral Urbanistik.

HARTA E KOMUNËS SË SHTIMES (THE MAP OF THE MUNICIPALITY OF SHTIME)



LALZIM SAHITI
SHTIMJA 2005
(DORAZAK INFORMATIV)

SHTIMJA NË BURIMET E LITERATURËS

5. Për Shtimen kanë shkruar mjaft autorë, duke iu qasur kësaj treve nga këndvështrime të ndryshme historike, gjeografike, etj. Një studim monografik me vlerë për këtë lokalitet, me informacion të pasur dhe me pretendime më shkencore, ka bërë autori Banush Imeri “*Shtimja me rrethinë. Dëshmi ekzistence e qëndrese*” (Prishtinë, 2003, 544). Në këtë botim, të ndarë në 9 kapituj, autori sjell të dhëna me interes dhe për popullsinë e Shtimes dhe rrethinës në shekullin XIX-XX, migrimet dhe ngulitjet e popullsisë, vendosjen e muhaxhirëve në disa vendbanime të Shtimes, popullsinë e Shtimes dhe fshatrave në bazë të regjistrimeve të shek. XX, për qytezën e Shtimes dhe vendbanimet (fshatrat) e kësaj komune:

Belinci

Caraleva

Davidovci

Devetaku

Duga

Gjurkovci

Gllavica

Godanci e Epërm

Godanci i Poshtëm

Karaçica

Llanishti

Lluzhaku

Mollopolci

Muzeqina

Petrova

Petroviçi

Petreshtica

Raçaku

Ranca

Rashinca

Topilla

Vojnovci, dhe

Zborci.

Në një kapitull flet dhe për riemërtimet fshatrave të komunës së Shtimes nga viti 2000. Në këto shtjellime sillen të dhëna me interes për historikun e këtyre fshatrave dhe një lëndë e pasur toponimike, sidomos dhe për fshatin Petreshticë.

6. Sipas historianëve të ndryshëm konsiderohet që Shtimja të ketë qenë e banuar nga fise dardane që nga koha e bronzit dhe hekurit, të shpërndarë në kala të shumta dhe vendbanime kodrinore e fushore. Në kohën e sundimit të Perandorisë Romake është zhvilluar rrjeti i vendbanimeve urbane dhe i rrugëve, të cilat lidheshin me sistemin rrugor të Perandorisë. Në Kosovë rrjeti i vendbanimeve, gjatë kësaj kohe, u dendësua dukshëm. Numri i kalave dardane, si ajo mbi fshatin Petrovë (e cila nuk ka asnjë shenjë sot), ishte mjaft i madh. Pas shkatërrimit të shumë kalave dardane antike (prej luftërave dhe tërmetit të fortë të vitit 518), u zhvillua sistemi i vendbanimeve në kohën bizantine (shek. IV-XII) dhe mesjetën e hershme serbe (1180-1389). Vlen të përmendet Kështjella mesjetare e Topillës, e cila gjendet në një ngushticë 10 km në jug të Shtimes. Kështjella gjendet mbi një shkëmb, të cilën populli e quan “Guri i Shtrenjtë”. Kjo kështjellë siguronte rrugën dhe shërbente për mbrojtjen e pjesës perëndimore të Fushës së Kosovës dhe të qytetit të Shtimes.

7. Vendbanimet e para, fshatrat e kësaj treve, pra dhe Shtimja, u krijuan shumë herët, si rezultat i kalimit prej mënyrës nomade të jetës së njerëzve në mënyrën e jetës në një vendbanim për një kohë të gjatë, pra jetës së ngulitur. Kjo u bë atëherë kur filloi punimi i tokës, zhvillimi i bujqësisë, sidomos lavërtarisë. Formimi i

vendbanimeve u bë sidomos në ato pika të caktuara ku njerëzit kishin kushte të volitshme për jetë, pra me klimë të mirë, me botë të zhvilluar bimore e shtazore, me ujë të bollshëm për vete dhe për shtazë, kulloso të begatshme dhe tokë cilësore për punë. Shtimja i kishte dhe i ka këto të mira natyrore: lumin Shtimjanja në mes, malet dhe tokën pjellore. Prej kohësh, kishte edhe rrugën që lidhte Perëndimin me Lindjen dhe anasjelltas. Të gjitha këto bënë që ky vendbanim të ekzistojë që nga kohët më të vjetra. Realisht kur është themeluar Shtimja, nuk ka burime të sakta historike të kohës. Mund të jetë formuar disa shekuj para se të përmendet në burimet mesjetare serbe e raguziane. Numri kaq i madh i shtëpive të këtij vendbanimi (109) për atë kohë, flet në të mirë të këtij konstatimi. Edhe disa nga fshatrat e territorit të Shtimes janë të vjetra dhe kanë pasur emërtimet që i kanë edhe sot, sepse në kohën e mesjetës, toponimet autentike të vendbanimeve, trojeve, fshatrave e qyteteve, u reduktuan deri në minimum. U bë përkthimi i tyre, rëndom i emrave të vendbanimeve dhe fshatrave të vogla, i atyre emrave, kuptimi i të cilëve dihej, ndërsa nuk u përkthyen ata emra, kuptimi i të cilëve kishte humbur për shkak të lashtësisë.

8. Shtimja, si toponim, dëshmoheret historikisht, mirëpo është emërtim që nuk përkthehet dhe gjatë shekujve na paraqitet në disa forma, por, për nga ndërtimi strukturor është i ngjashëm me emërtimin e sotëm. Në dokumentet mesjetare ajo për herë të parë përmendet në vitin 1326 kur Stefan Deçani, nga Oborri i tij mbretëror në Shtime, u lëshon diploma dubrovnikasve “*in laco disto Stimni*”, regjistruar në Dubrovnik, më 9 dhjetor të vitit 1329. Nga krejt kjo që u tha është vështirë të thuhet prerazi dhe të vërtetohet lashtësia e Shtimes, me gjithë ekzistimin e gjurmëve të kulturës materiale nga e kaluara e largët, pa hyrë kazma e arkeologëve, që tash pa frikë do të punonin, do të hulumtonin dhe më në fund do të thoshin fjalën përfundimtare për Shtimen dhe për të kaluarën e saj historike, edhe pse nga diplomat e sundimtarëve të Mesjetës dhe më pastaj të defterëve turq, gjejmë shënime të vlershme, që përforcojnë konstatimin se Shtimja është

vendbanim mjaft i moçëm. Meqë krisobulat, diplomat, aktdhurimet apo kartat etj., që ishin në përdorim në kohën e Mesjetës dhe gëzonin besim juridik, rëndësia më e madhe e tyre është se emrat e vendbanimeve dhe llojeve të tjera të makrotoponimeve përbëjnë një pasqyrë reale të topografisë të një pjese të truallit të sotëm të Kosovës, të dekadës së tretë e të katërt të shekullit XIV, atëherë kur edhe Shtimja si vendbanim përmendej në ato dokumente.

9. Gjatë hulumtimeve arkeologjike, të kryera nga Muzeu i Kosovës, në vitin 1976, u realizua pjesërisht projekti: “*Dardanët Parahistorikë në Dritën e Hulumtimeve Arkeologjike në Kosovë*”, ku në kuadër të këtij projekti nga tetë tumat ilire në Porodime të Shtimes, u gërmuan vetëm tri sosh. Me këtë rast është konstatuar se nekropolet e grupit kulturor dardan kanë qenë të tipit tumular me konstruksione të zakonshme për tumat ilire, unaza rrethore të përbëra prej gurëve të lumenjve dhe konstruksione të varreve. Këto tuma kishin dimensione të mesme dhe diametrin prej 13-18 m. Ato ishin dëmtuar qysh herët nga lëvrimi i tokës, me ç’rast janë shkatërruar edhe konstruksionet prej guri. Unaza rrethore, si pjesë e konstruksionit tumular është ruajtur në tërësi vetëm në tumën IV të nekropolit të Porodimes.

10. Pozita e përshtatshme gjeografike, sidomos në grykën e Carralevës dhe atë të Topillës, luajti rol të pazëvendësueshëm në zhvillimin e një sërë betejash. Gjatë vitit 1810 u zhvilluan beteja të rëndësishme kundër forcave osmane nën komandën e Dervish Pashës. Dhe më vonë rreth vitit 1910 Shtimja luajti rol vendimtar kundër forcave xhonturke, të cilat komandoheshin nga Xhafer Beu e Shefqet Dërgut Pasha, gjatë kësaj periudhe u arritën fitore falë pozitës së përshtatshme gjeografike në Grykën e Carralevës dhe komandantit të kryengritësve shqiptarë në rajonin e Shtimes, Isa Boletinit.

11. Shtimja dhe Petreshtica, sikurse dhe mbarë populli shqiptar i Kosovës, u përfshinë dhe nga flakët e luftës çlirimtare të vitit 1998-1999 kundër pushtuesit

qindravjeçar serb. I njohur për atdhedashurinë ndaj vendit të vet dhe i etshëm për liri, edhe populli i kësaj ane organizoi një rezistencë të armatosur kundër okupatorit serb, me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), që hapi luftë të armatosur kundër Serbisë, luftë kjo që konsiderohet vendimtare jo vetëm për çlirimin e Kosovës, por edhe për formimin e shtetit të Kosovës. Më 26 gusht 1998, policia dhe paramilitarët serbë, me forca të mëdha dhe teknikë të përsosur ushtarake, hynë në fshat dhe më parë i plaçkitën shtëpitë, kurse pastaj ua vunë flakën dhe dogjën deri në themele 90 shtëpi banimi dhe 70 lokale. Dogjën shkollën fillore me tërë dokumentacionin pedagogjik-administrativ, ambulancën e fshatit, granatuan xhaminë dhe shkaktuan dëme të mëdha. Nga ky fshat në radhët e UÇK-së kanë qenë 60 luftëtarë (Imeri 2003, 160).

PETRESHTICA

12. Petreshtica administrativisht i takon Komunës së Shtimes, në një largësi

përafërsisht 9 km në perëndim të kësaj komune, por gjeografikisht shkon me Drenicën e Epërme ose si i thonë banorët e kësaj ane Drenica e Pashës. Krahina e quajtur Drenicë kufizohet në veri me Mitrovicën dhe Kolashinin; në lindje me malet e Çiçavicës, të cilat e ndajnë nga Fusha e Kosovës, me malet e Gospojës, Goleshin dhe malet e Lipovicës; në jug me Cërnalevën, malet e Drenicës dhe Prekorupën, ndërsa në Perëndim me Podgorën, apo si e quajnë në popull Rrafshin e Dukagjinit. Nga popullata e vendit kjo zonë njihet me dy emërtime të bigëzuara: *Drenica e Pashës*, që zë pjesën juglindore (përfshin 18 fshatra), dhe *Drenica e Kuqe* (62 fshatra), të cilat dallohen dhe me karakteristika etnopsikologjike. *Drenica e Kuqe* e konsideron veten si më luftëtare nga *Drenica e Pashës*, sepse ia ka kthyer fjalën dhe armën pashës (sundimtarëve turq).

Folkloristi i njohur Anton Çetta në hulumtimet e tij shënon këtë legjendë për Drenicën e Pashës, pjesë e së cilës është dhe Petreshtica: “*Emri Drenica e Pashës është i lidhur me një ngjarje që ka pretendime historike. Pleqtë drenicas tregojnë se para një shekulli përafërsisht Jashar Pasha kishte pasë ardhur të shtrojë këto vise që njiheshin vetëm me emrin Drenicë. Duhet të ketë ardhur nga ana e Prishtinës, ku dhe sundonte, e që vendosur ndër fshatrat e pjesës lindore, konkretisht i hapi çadrat ndërmjet Çikatovës e Gllogovcit. Deri aty nuk ndeshi ndonjë kundërshtim. Kjo gjë e trimëroi dhe, duke pandehur që popullsia e kësaj treve do të pranonte çdo kërkesë të tij, dhe në anën tjetër sigurisht duke mos njohur mirë psikologjinë dhe zakonet e fshatarëve, kërkoi që t’i dërgonin një femër, siç thonë diskretisht pleqtë e këtij vendi, “me i ba hyzmet”. Drenicasit e morën si dhunë nderi kërkesën e tij, u grumbulluan dhe i dërguan fjalë: “Për çyshtu nuk t’njofim për pashë!” Njëkohësisht ia kthyen pushkën dhe e detyruan të tërhiqet dhe të zërë vend në pjesën më jugore të kësaj treve, e cila që atëherë u quajt Drenica e Pashës, sepse pushteti i Jashar Pashës u shtri vetëm në atë pjesë të kufizuar” (Çetta 1990, 11).*

13. Petreshtica është fshat i tipit malor, me prona të pakta bujqësore. Sipas

regjistrimit të vitit 1981 ka pasur 123 shtëpi, kurse sot ka rreth 182 shtëpi dhe përafërsisht 1511 banorë, të konfesionit islam, të gjithë të përkatësisë etnike shqiptare. Në vitin 1956 ky fshat ka pasur 80 shtëpi, dhe “*ishte me burra e jo me tulla, ka pasur burra të mençur, njerëz të ditur dhe familje të cilat janë njohur për bujari e mikpritje, që përmendeshin për odat e mëdha*” (Sahiti 2005, 15). Duke qenë vendbanim i tipit kodrinor-malor, afro 150 familje të këtij fshati, në periudha të ndryshme kohore, kanë migruar në drejtim të qendrave urbane si në Shkup, Ferizaj, Prishtinë, Lipjan, Shtime, Magurë. Në kohën e Mbretërisë së Serbisë disa familje të Petreshticës janë shpërngulur për në Turqi (Imeri 2003, 159). Popullata e këtij fshati është e besimit mysliman. Por gjurmët toponimike si *Kisha, Kroni Mitrit*, etj. tregojnë se popullata dikur ka qenë e konfesionit katolik. Nga popullsia e vendit ky lokalitet quhet Petreshticë, kurse banorët petreshticas. Banorët janë të fisit *Gash*, por disa shtëpi të fisit *Krasniq e Sop*. Fshati është i tipit kodrinor-malor dhe ka pak toka pune. Tokat që ishin nën ujtitje quheshin arat e vadës.

Për lokalitetin e Petreshticës flitet dhe në dy botime monografike, në një monografi për Drenicën të bashkautorëve Mehdi Bardhi-Violetë Bardhi (Bardhi 2009), në një botim tjetër “Kujtime” të autorit Jusuf B. Sahiti (Sahiti 2005), i lindur dhe i rritur në Petreshticë, por i mërguar në Izmir të Turqisë. Ndërkaq, për onomastikën e këtij lokaliteti në librin e R. Doçit “*Onomastika e Drenicës*” (2005).

Etimologjia e topikut Petreshticë

14. *Etimologjia e këtij topiku nuk është e paqartë. Në thelb ruan një emër vetjak Petre dhe sufiks sllav –shticë, sikurse dhe te Llapashticë, Prapashticë, etj. Kjo është një dukuri krejt e zakonshme dhe primare në toponomastikë, të cilën e pohon edhe Prof. Çabej: Katundet fisnore shpeshherë mbajnë emrin e themeluesit ose banorit të parë të tyre (SGJ V, 337).*

Emrin e këtij topiku e takojmë dhe në dokumentet e vjetra të shek. XV, në rajonin e zotërimit të Brankoviçit, në Kadastrin e regjistrimit të vitit 1455, me formën Selo Petruštica (Petraštica), me gjithsej 69 shtëpi dhe 81 banorë, me emra të konfesionit të krishterë (Oblast Brankovića 1972, 225). Forma gjuhësore Petruštica (Petraštica) dëshmon për proveniencën vllahe të këtij toponimi, si një ngulim baritor, e cila është ruajtur dhe deri më sot nga banorët vendës si Petreshticë.

Për praninë e elementit baritor vllleh në këto hapësira dëshmojnë dhe topikë të tjerë, si p.sh. emri i vendbanimit *Magurë*, që ndodhet jo larg Petreshticës, etj. Trajta *Pjetërshiticë*, që ka propozuar një Komision për riemërtimin e emrave të vendeve në Republikën e Kosovës, fill pas çlirimit të Kosovës nga okupatori serb, na duket se nuk është e mbështetur filologjikisht, sepse fonetikën, morfologjinë dhe semantikën e toponimeve si material gjuhësor mund ta ndërrojë vetëm popullata përkatëse e atij vendi në rrjedhë të kohës, dhe jo komisionet e formuara ad hoc. Ndryshe, do të pritej që dhe emri i fshatit *Petrovë* i komunës së Shtimes të bëhej *Pjetërovë*, pavarësisht se *e*-ja nuk hapet në *-je* në këtë areal linguistik!

Patronimikat

15. Petreshtica sot ka këto lagje ose patronime:

Arifovit – sipas të parit të tyre Arifit.

Bregi – lagje prej disa familjesh.

Dashlakët (nga serb. *Doshlak*, të ardhur këtu nga një pjesë tjetër e fshatit).

Dina – patronim në lagjen Lugu.

Dugojt – të ardhur nga fshati i afërm Dugë, tani i braktisur krejtësisht.

Fangt – patronim.

Ferojt – patronim

Gashi – lagje që ka marrë emrin sipas emrit të fisit.

Harost – patronim.

Mahalla e Musojve (Musojt) – sipas të parit të tyre Musës.

Saitoviçe – familje e Sahitajve.

Lugovit – patronim.

Fshatrat *Petreshticë*, *Dugë* (sot i braktisur) dhe *Karaçicë* i takojnë të ashtuquajturës *Drenica e Pashës (Drenica e Naltë)*, që ndodhet kundruall *Drenicës së Poshtme* ose *Drenica e Kuqe*.

Të gjitha familjet e Petreshticës i takojnë fisit *Gash*, (përveç *Dugajve* që i takojnë familjes *Krasniqi*), dhe nuk martohen ndërmjet veti, brenda fisit.

DUGA

16. Është me interes të evidentojmë këtu dhe lëndë onomastike (patronimet dhe toponimet) e fshatit Dugë, sot pothuajse të pabanuar, që ndodhet afër Petreshticës. Disa familje nga ky fshat janë vendosur në Petreshticë.

Lagjet (familjet):

Ademavitët

Asllanavitët

Dautavitët

Rrahmanavitët

Zajkavitët

Toponimia

17. *Agraxhë (në)* – vend i rrethuar.

Ahishta – vend me dru ahu.

Ara Dodës – arë, tani livadhe.

Ara Lakit – livadhe, afër fshatit.

Ara Lugit – arë.

Brexhet – brigje.

Bretenc – majë mali mbi 1000 metra lartësi mbidetare.

Grapa Arushës – gropë.

Gurra Balës – krua, burim uji.

Kodra Gatë – kodër.

Kodra Musta Bashit – kodër.

Kodra Shejës – kodër.

Kroni Ibrit – krua.

Kroni – burim uji.

Lajthia – vend i pasur me lajthi.

Livadhi Hijës – livadh.

Lugi Firajës – lug me fier.

Pipajë – vend me drunj palnje.

Rudina – vend në pyll.

Rudinat e Zajkaviçe – vende në pyll.

Rrafshi Zabelev – vend i rrafshët.

Vorret e Fanav – varreza të vjetra.

E FOLMJA

18. Objekti themelor i studimit për të folmen e Petreshticës përfshin disa kapituj, vështruar në rrafshin sinkronik, por herë-herë dhe në atë diakronik (etimologjik), siç janë:

I. *Fonetika*

II. *Morfologjia*

III. *Fjalëformimi*

IV. *Sintaksa*

V. Leksiku

VI. Onomastika

VII. Tekste

E folmja e Petreshticës përveçohet me tipare që e dallojnë atë nga të folmet e tjera, si në rrafshin leksikor, ashtu dhe në rrafsh të tjera, khs. p.sh.: *a po do ujë, a po vjen* (Petreshticë) – *a po dush ujë, a po vish* (Suharekë).

Materiali që do të sjellim në vijim jep një pamje më të plotë të atyre ndryshimeve ndërdialektore me të folmet e Kosovës, si dhe ngjashmëritë mes tyre.

I. FONETIKA

VEÇORITË E PËRGJITHSHME FONETIKE

19. Në të folmet e gjuhës shqipe përgjithësisht si dhe në dialektet e saj dallimet më të mëdha vërehen në fushën e fonetikës. Ndryshimet më të shumta në gjuhën tonë hetohen në realizimin e inventarit të fonemave zanore. Për të kuptuar si duhet këtë çështje të fonetikës së gjuhës shqipe, mendoj që na ndihmon më së miri shkoqitja që i kanë bërë kësaj problematike dialektologët më të njohur shqiptarë: Jorgji Gjinari dhe Gjovalin Shkurtaj në librin universitar *Dialektologjia*, ku theksojnë: “*Pamja reale e dallimeve të fonemave në inventarin e tyre del kur shihet çdo fonemë në vetvete. Disa të folme me veçori të njëjta fonetike formojnë së bashku një areal dialektor, që shtrihet në një hapësirë gjeografike. Çdo areal ka një inventar të caktuar fonemash, që e dallon atë nga arealet e tjera dialektore. Asnjë areal nuk e ka gjithë numrin e inventarit të fonemave zanore të të gjitha të folmeve të marra së bashku. Në çdo areal inventari i fonemave zanore është gjithmonë më i vogël se inventari i përbashkët i të folmeve të dy dialekteve. Areali me inventarin më të vogël ka gjashtë fonema zanore, kurse areali me inventarin më të madh ka nëntëmbëdhjetë fonema zanore. Arealet e tjera kanë një inventar që lëviz nga shtatë deri në shtatëmbëdhjetë fonema*”¹.

Në këtë mes të folmesh, e folmja e Petreshticës bën pjesë në arealin e të folmeve të gegërishtes verilindore me inventarin më të madh të fonemave zanore. Këtu hyjnë pastaj grupet e zanoreve, togjet e bashkëtingëlloreve si dhe ndërrimet

¹ Jorgji Ginari – Gjovalin Shkurtaj, *Dialektologjia*, Tiranë, 2003, f. 179.

fonetike, siç janë: *asimilimi, shurdhimi, sonorizimi, disimilimi, reduktimi, kontraksioni i zanoreve, kontraksioni i bashkëtingëlloreve, opozicioni i fonemave, elizioni, afereza, sinkopa, apokopa, epenteza, metateza, aglutinacioni*, etj. Të gjitha këto fenomene fonetike e karakterizojnë dhe të folmen e Petreshticës, e cila, siç theksuam, përkon shumë me të folmet e gegërishtes verilindore. Është me interes që në këtë kapitull të theksohet që e folmja e Petreshticës me disa tipare specifike fonetike e morfologjike përkon me grupin e të folmeve që e veçojnë deri diku nga të folmet e Drenicës, të Vuçiternës, të Shalës së Bajgores, të fshatrave të Llapit e të atyre të Gollakut dhe e afrojmë me të folmet e fshatrave të Shtimes, të Lipjanit, të Ferizajt, të Karadakut të Gjilanit, të Kaçanikut dhe shtrihen edhe në arealin e të folmeve shqipe të Maqedonisë. Këto veçori specifike do t'i paraqesim gjatë shtjellimit të pjesëve të fonetikës dhe të morfologjisë së kësaj së folmeje.

Sistemi i fonemave zanore dhe i atyre bashkëtingëllore

20. Në të folmen e Petreshticës realizohen 19 fonema zanore, pra aq sa kemi dhe në pjesën më të madhe të të folmeve të tjera të gegërishtes verilindore. E folmja e këtij fshati, të cilën e kemi marrë ta studiojmë nga aspekti i dialektologjisë, për nga numri i fonemave që ka në sistemin e saj përkon plotësisht me pjesën më të madhe të arealit gjuhësor të gegërishtes veriore dhe dallon ndjeshëm nga grupi i të folmeve të dialektit të toskërishtes, ku realizohen pothuajse vetëm zanore gojore. Ndërkaq, për sa i përket inventarit të fonemave bashkëtingëllore, kjo e folme ka në sistemin e vet 27 sosh, pra mungojnë çiftet e palataleve **q,gj**, të cilat sikurse në pjesën dërrmuese të të folmeve të gegërishtes veriore, edhe këtu janë kthyer ose janë njëjtësuar me afrikatat **ç,xh**. Po përmendim që në arealin e të folmeve të gegërishtes veriore, vetëm të folmet e Preshevës dhe të Bujanovcit i dallojnë qartë palatalet **q, gj**, nga afrikatat **ç,xh**², të cilat vërehen shkoqur në shembujt që jepen

² Dr, Idriz Ajeti, *Rreth disa veçorive të të folmeve shqiptare të rrethit të Preshevës dhe të Bujanovcit*, te "Studime gjuhësore në fushë të shqipes II", Prishtinë, 1985, f. 265.

për të dyja çiftet e këtyre bashkëtingëlloreve.

Zanoret³

21. Shqipfolësit e Petreshticës kanë zanore të gjata, të shkurtra, zanore gojore, zanore të përparme, të prapme dhe zanore hundore. Mbështetur në këto që thamë, mund ta paraqesim këtë skemë të sistemit zanor, përfshirë këtu natyrisht dhe variantet fonematike:

i:, y:, e:, a:, o:, u:

ĩ, ŷ, ě, ă, ǒ, ů

ĩ, ŷ, ě, ă, ů

³ Zanoret e gjata i kemi shënuar me dy pika / : / prapa tyre, si , p.sh: *ka: / dhi: / lo:p / u:r* etj.;

Të shkurtrat me / ˘ /, si, p.sh.: *măĭ , xhăk, lăk* etj.;

Zanoret hundore me / ^ /: *kâ:m, me dhâ:n, me thâ:n, me lâ:n* etj.;

Zanoret e përparme hundore i kemi shënuar, ta zëmë vokalin *e*, kështu: *é, vén, sén, lén, dhén, çén, rén* etj.;

Zanoret e prapme: *ê*.

Përveç këtyre fonemave me variantet e tyre: të gjata, të shkurtra dhe hundore, dallohen në këtë të folme dhe zanore të përparme dhe të prapme:, p.sh: *é* dhe të prapme : *è*.

Theksi

22. Vendi i theksit ka rëndësi të madhe në fonetikë si për dallimin e dy dialekteve të gjuhës sonë, gegërishtes dhe toskërishtes, ashtu edhe për dallimin e të folmeve të veçanta brendapërbrenda këtyre dialekteve. Vendi ku bie theksi në disa fjalë të brumit të shqipës dhe në analogji me këtë edhe në disa fjalë që shqipja i ka huazuar nga turqishtja merret si tipar fonetik që dallon të folmet e dialektit të toskërishtes nga të folmet e gegërishtes. Kështu, për shembull, në fjalët e fondit autokton të shqipës: **njerí-u, verí-u, kallí-ri, qírí-u, aí, gjetíu** etj., derisa në të folmet e dialektit të Jugut përgjithësisht dhe të gegërishtes jugore theksi bie në rrokjen e dytë të tyre : **verí-u, njerí-u, kallí-ri, qírí-u, aí, gjetíu**, në të folmet e dialektit të Veriut theksi në këto fjalë ka lëvizur nga rrokja e prapme në rrokjen e përparme. Kështu edhe në të folmen e Petreshticës si dhe në mbarë të folmet e gegërishtes verilindore theksi në këto fjalë bie në rrokjen e parë të tyre, do të thotë edhe këtu, duke lëvizur nga rrokja fundore në rrokjen para saj ai mëshon në zanoren nistore: **vérí (po fryn vérí), níerí, (e pa:sh níerí, kállí i grúnít, grúní ka çí:t kállín, çírí (po bân dri:t çírí), aí e dí ma mi:r kí: pu:n se ún** etj. Në lidhje me këtë çështje mund të theksojmë që toskërishtja me të folmet e saj e ka ruajtur gjendjen e vjetër të shqipës në moslëvizjen e vendit të theksit të këtyre

fjalëve në krahasim me të folmet e gegërishtes, të cilat në këta dy shekujt e fundit e kanë zhvendosur theksin, siç thamë në rrokjen e parë, kështu që dialekti i Veriut na del inovator.

Po t'i shikojmë shkrimet e vjetra të shqipes të shekujve XVI-XVII mund të vërejmë që në to theksi në fjalët e sipërshënuara bie në rrokjen e dytë dhe këta emra përdoren në dy trajta: në trajtën e shquar dhe në atë të pashquarën. Ndërkaq, në të folmen që e kemi objekt studimi, pra në ligjërimin e Petreshticës dhe në të folmet gegërishtes veriore theksi i tyre është zhvendosur në rrokjen e parë, pra bien mbi vokalin e parë: **víri, níeri, kállli, qíri, aí**, dhe këto fjalë përdoren vetëm në trajtën e pashquar, pra këtyre u mungon trajta e shquar që e kanë në të folmet e toskërishtes.

Në analogji me këto fjalë të burimit të shqipes, edhe fjalët që shqipja e i ka huazuar nga turqishtja, si: **xhezvë, teneçé, xhadé, hurmá, bakllavá, sarmá, pará, dajré, kafé**, e shumë të tjera, theksi në të folmen e Petreshticës dhe në të gjitha të folmet e gegërishtes veriore bie në një rrokje më përpara: **xhézvë, tenéçë, xhádë, húrmë, balla:v, sármë, páрэ, dájрэ, káfě** etj. Veçorinë e zhvendosjes së theksit në rrokjen parafundore ne i kemi vënë re edhe në punimin tonë të magistraturës “*Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare në Zvicër*”⁴, kur kemi bërë fjalë për tiparet e përbashkëta të të folmeve të gegërishtes verilindore. Në analogji me këta emra të përgjithshëm të gurrës orientale, edhe disa emra personale me burim turko-arab të gjinisë femërore në këtë të folme e kanë lëvizur theksin nga rrokja fundore në atë parafundore, si: **Fatíme, Hatíxhe, Hanífe, Nefíse, Sherífe**, etj., nga **Fatimé, Hatixhé, Hanifé, Nefisé, Sherifé**, etj.

Po kështu në fjalët e huazuara nga turqishtja të tipit: **babá-i, agá-i, pashá-i** e ndonjë tjetër, në të folmen tonë si dhe në të folmet e dialektit të gegërishtes verilindore theksi bie në rrokjen e parë, përkatësisht në vokalin e parë të fjalës: **bá:b, á:g, pá:sh** në trajtën e pashquar, kurse në trajtën e shquar, gjysmëzanoren -ë fundore të trajtës së pashquar, e cila nuk dëgjohet së shqiptuara, e bëjnë **a** të

⁴ Shih: Prof. Mr. Isuf Musliu, *Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare në Zvicër*, Tiranë, 2008, f. 32.

patheksuar: **bábă, ágă, páshă**. Në lidhje me fenomenin fonetik të këtyre fjalëve, dialektologu i shquar prof.dr. Gjovalin Shkurtaj në studimin e tij për *të folmen e Kelmendit*⁵ thekson me të drejtë që **a**-ja e gjatë, përkatësisht e theksuar, është bërë e patheksuar, kurse nyja e prapme shquese është zhdukur krejtësisht.

Vendi i theksit lëviz në të folmen e Petreshticës në fjalët e prejardhura dhe të përbëra, ashtu si dhe në të folmen e Shalës së Bajgorës (Shih: L. Mulaku, f. 32), duke u shkurtuar zanorja e theksuar e fjalës bazë, nga e cila theksi kalon në prapashtesën e fjalës: **udhta:r, kpucta:r, punto:r, fajto:r, syzi:, syze:z**, etj. Dukuria e lëvizjes së theksit pas elizionit a shkurtimit që pësojnë emrat e burimit oriental: **Behlul, Mehmet, Bejtullah, Hajrullah, Beqir, Fejzullah**, etj., e vënë re nga L. Mulaku për të folmen e Shalës së Bajgorës, vlen edhe për të folmen e fshatit Petreshticë dhe për të folmet e tjera të gegërishtes veriore, si: **Be:h, Me:h, Be:jt, Ha:jr, Be:ç, Fe:jz**, etj.

Po ashtu, dukuria e lëvizjes së theksit në disa emra me origjinë sllave, siç është vënë në spikamë nga L. Mulaku për të folmen e Shalës së Bajgorës⁶, vlen edhe për të folmen tonë: **steni:c, vlla:ç, tori:sht, si:t, koli:b**, etj.

Zanoret gojore

23. Dallimet midis të folmeve të gjuhës shqipe dhe dialekteve të saj vërehen qartë në sasinë e fonemave të zanoreve që ka një e folme ose grupe të folmesh në krahasim me një të folme tjetër ose të grupeve të folmeve të tjera. Kështu qëndron çështja edhe e dallimeve që kanë dialektet e gjuhës shqipe midis tyre. “*Çdo e folme e marrë në vetvete si një sistem i veçantë, si një mikrosistem i gjuhës dialektore, ka sistemin e vet fonematik, por, duke i parë ato si variante të një gjuhe dhe duke i krahasuar me njëra-tjetrën, shihet se ato përnda sasia e fonemave zanore grupohen dhe formojnë disa areale me modele të ndryshme. Nga kjo*

⁵ Gjovalin Shkurtaj, *E folmja e Kelmendit*, Dialektologjia shqiptare III, Tiranë, 1975, f. 39.

⁶ Latif Mulaku, *E folmja e Shalës së Bajgorës*, Prishtinë, 2005, f. 33.

pikëpamje vërehet se në disa areale dallimet janë shumë të vogla, kurse në disa të tjera ato janë të mëdha dhe të rëndësishme, janë dallime relevante”⁷

Gjatësia e zanoreve

24. Kur është fjala për gjatësinë e zanoreve përgjithësisht në gjuhën shqipe mund të thuhet që shqipja e vjetër duhet t’i ketë pasur në sistemin e saj fonetik zanoret e gjata. Dialekti verior (gegërishtja) dëshmon edhe sot që i ka ruajtur mirë zanoret e gjata që nga periudha shkrimore e shqipes, dhe këto i ka ruajtur gjithashtu edhe toskërishtja jugore, ndërkaq toskërishtja veriore ka vetëm zanore gojore. Kështu edhe në të folmen e Petreshticës sikurse dhe në të gjitha të folmet e gegërishtes dallohen qartë zanoret e gjata nga vokalet e shkurtra. Për sa i përket fenomenit fonetik të dallimit të zanoreve të gjata prej atyre të shkurtrave e folmja jonë nuk dallon prej të folmeve të tjera të gegërishtes. Zanoret e gjatësisë së mesme sipas mendimit tim nuk meritojnë të trajtohen, sepse ato nuk paraqesin ndryshime as brendapërbrenda të folmeve të gegërishtes, e as në mbarë gjuhën shqipe përgjithësisht, sepse zanoret e gjata të trajtave të pashquara të fjalëve, ato kur njësitë leksikore shquhen, vokalet bëhen të mesme.

Disa fjalë të cilat dikur në të dyja dialektet e gjuhës shqipe në trajtën e pashquar shqiptoheshin me zanore të gjatë, si **de:t**, **gu:r**, **ka:lë**, **ba:r**⁸, në të folmen e Petreshticës dhe përgjithësisht në të folmet e gegërishtes veriore, verilindore e veriperëndimore, duke u përdorur vetëm në trajtën e shquar, zanorja e tyre e ka humbur gjatësinë e dikurshme dhe është kthyer në zanore të gjatësisë së mesme: shkela mi: në **gúri**, kam në **káli**, mas shivit që ka ra:, ka da:l shumë **bári**, sivjet du: me shku: **n déti**, etj. Siç mund të vërehet në të folmen tonë këta emra nuk e kanë fare trajtën e pashquar të tyre, kështu që për rrjedhojë të saj u mungon edhe gjatësia e dikurshme e zanores së temës.

⁷ Jorgji Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, Tiranë, 1975, f. 61.

⁸ Këto fjalë shkrimtarët e vjetër i kanë shënuar me zanore të dyfishta për të dëshmuar gjatësinë e tyre.

Zanorja a

25. Vokalin **a** të gjatë e ndeshim në të folmen e Petreshticës si dhe në të folmet e gegërishtes verilindore⁹ në fjalët: **vlla:**, **pla:k**, **ka:** (<kau, në këtë të folme **kavi**); **a:r**, **da:rdh**, **a:rr**, **fa:r**, **sha:l**, **za:ll**, **ha:ll**, **i ga:t** (< nga: **i gjatë**), **i tha:t**, **i gja:ll**, **i rra:ll**, **me la:**, **me tha:**, **me ra:**, **udhta:r**, **vneshta:r**, **katuna:r**, **sefa:**, **hava:**, **kala:**, **bela:**, etj. Në shumicën e këtyre fjalëve e veçanërisht në leksemat foljore e mbiemërore zgjatja e zanores **a** të theksuar është rrjedhojë e rënies së vokalit fundor të tyre¹⁰.

Është me shumë interes dialektor të theksojmë që një numër fjalësh me prejardhje orientale, **si: bela:**, **hata:**, **kala:**, **rixha:**, **mera:**, **behrida:** (edhe **byhrida:**) etj., në analogji me fjalët **sefa:**, **hava:**, etj., në të folmen e Petreshticës, **a**-në fundore të tyre, të karakterit të gjatë, nuk e kthejnë në *é* hundore të përparme: *belé*, *haté*, *kalé*, *rixhé*, *rizé*, *meré*, *behridé*, etj., siç e kthejnë një pjesë e madhe e të folmeve të Drenicës, mbarë e folmja e Shalës së Bajgorës, e folmja e Vuçitërnës me rrethina, të folmet e Llapit, të Gollakut etj., por e ruajnë të pandryshuar, pra **a:** të gjatë. Sipas vëzhgimeve të mia fenomeni fonetik i ruajtjes së **a**-së së këtyre fjalëve, përveç në Petreshticë, shtrihet edhe në disa fshatra përreth tij, të cilat i përkasin trevës së Drenicës dhe pastaj vazhdon në të folmet e fshatrave të Grykës së Carralevës, në fshatrat e Shtimes me rrethina dhe në të folmet e Lipjanit me rrethina. Këtë tipar fonetik të ruajtjes së **a**-së fundore të gjatë në emrat e burimit oriental shkruesi i këtyre radhëve e kishte theksuar edhe në studimin e sipërtheksuar të tij “ *Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare në Zvicër*”, f. 35. I mbetet për detyrë ndonjë dialektologu tjetër që të hetojë shtrirjen e mëtejshëm të

⁹ Shih për këtë fenomen fonetik edhe studimet dialektologjike të këtyre autorëve: L. Mulaku, *E folmja e Shalës së Bajgorës*, Prishtinë 2005, f. 31; Hasan Kelmendi, *E folmja e lokalitetit të Turiçevcit, vështrim mbi fonetikën*, GJA, SShF, VI-1976, Prishtinë, 1978, f. 125; Shaqir Berani, *Tiparet fonetike të së folmes së lokalitetit të Klinës*, GJA, SShF, nr. VIII- 1979, f. 164; Ragip Mulaku, *E folmja shqipe e rrethinave të Vuçitërnës*, GJA, SShF, nr. XI, 1981, f. 135 etj.

¹⁰ Shih për këtë fenomen edhe :L. Mulaku, *E folmja e Shalës së Bajgorës*, f. 31.

këtij fenomeni gjuhësor edhe në të folme të tjera të Kosovës, sidomos në të folmen e Ferizajt me rrethina, që do të vazhdonte pastaj nga juglindja dhe të lidhej me të folmet e Karadakut të Gjilanit¹¹, po se po, por ndoshta edhe me të folmet e Kaçanikut dhe me të folmet e shqiptarëve të Maqedonisë.

Zanoren **a** të gjatë e hasim në të folmen e Petreshticës edhe në trajtat e shumësit të emrave: **gra:**, **tha:s**, **rra:th** (këta dy emrat e fundit historikisht dikur kanë qenë forma të njëjësit **thasi**, **rrathi**, dhe pastaj janë shndërruar në forma të shumësit, kurse trajtat e numrit shumë të dikurshëm **thes**, **rreth** janë kthyer më vonë në njëjës).

Zanoren **a** gojore¹² e ndeshim në mjaft shumë fjalë, si: **katun**, **darsum**, **drapën**, **xharpën**, **krahën**, **kali**, **shati**, **bari**, **mashkull**, **frashën**, **i falun**, **baraz**, **hatull**, **katër**, **hatër**, **bagël**, **bashçe**, **marre**, **çare**, **çadër**, **sabër**; në foljet e vetës së parë njëjës të kohës së tashme të dëftores: **laj**, **thaj**, **shpërlaj**, **shaj**, **kaj** (<qaj), **maj** (<mbaj), etj.

Shënim. – Emrat **kali**, **shati**, **bari** dhe ndonjë tjetër në të folmen e Petreshticës përdoren vetëm në trajtën e shquar. Këta në shkrimet e vjetra të shqipes, në të folmet e toskërishtes si dhe në gjuhën standarde të shqipes përdoren në dy trajtat: në të pashquarën: **kalë**, **bar**, **shat** dhe në të shquarën: **kali**, **bari**, **shati**. Në shkrimet e vjetra zanorja e gjatë e tyre është shënuar e dyfishuar: **kaalë**, **baar**, etj.

Zanoren e shkurtër **a** e hasim në fjalët: **plāk** (ã-ja e shkurtër e këtij emri krijon opozicion fonologjik me zanoren **a:** të gjatë të emrit **pla:k**), **dësh**, **është**, **rrështë**, **lāk**, **bärk**, **xhāk**, **kräh**, **fäll**, **pāk**, **shkã** (shka po thue?) etj.

¹¹ Shih; M. Halimi, *E folmja e Karadakut*, Prishtinë, 2008, f. 107.

¹² Zanoret gojore mund t'i quajmë edhe zanore të theksuara, mirëpo nuk duam t'i përziejmë me zanoret që dalin kur fjalët me zanore të shkurtra dhe ato me zanore të gjata i përdorim në trajtën e shquar, të cilat gjithsesi bëhen zanore të mesme.

Kthimi i zanores **a** në **i** nëpërmjet **ë-së**, sikurse në shumë të folmet të gegërishtes veriore, edhe në të folmen e Petreshticës vërehet në fjalët **livroj** (<lëvroj<lavroj), **xhimoj** (<gjëmoj<gjamoj), **shiloj** (<shëloj<shaloj), **livdoj** (<lëvdoj<lavdoj).

Zanorja **a** ruhet e pandryshuar në emrat **zjarm** dhe **saj-a**, e cila në shumë të folme të gegërishtes veriore është kthyer në **e** të prapme me një nuancë hundorësie: **zjèrm**¹³, **sèj**. Në analogji me këto edhe fjala **lajthi** zanores **a** e ka kthyer në **e**: **lejthi**. Siç theksuam dhe më sipër, në këtë të folme nuk kemi kthimin e zanores **a** në **ê** në emrat **zjarr** dhe **saj**, sikundër kemi në disa folje të tjera të gegërishtes.

Shënim. – Në të folmen e Petreshticës dhe të fshatrave të Shtimes emri **ditë,-a** me nyjën e përparme joshquese **ñj** (<një): **ñj dīt** (<një ditë) përdoret në trajtën e shquar, pra me mbaresën –**a**: **ñj dīta**: bre po nalet **ñj dīta**, bre po nalet **ñj dīta**, ai nuk u nalke, po bājke d zeza edhe ma shumë! Ky emër në raste të tilla në shumicën dërrmuese të të folmeve të Kosovës përdoret në trajtën e pashquar **ñj dīt; ñj dīt** **pej dītsh** etj.

Zanorja e

26. Me zanoren e të gjatë kemi emrat: **e:r**, **dhe:**, **le:h**¹⁴, **fe:**, **be:**, **de:g**, **fle:t**, **de:r**, **pe:t**, **pe:l**, **bre:shk**, **mshtje:rr**, **shke:k**, **ne:r**, **ke:p** (<qepë), **dre:k**, **the:rr**, etj.

Me zanoren e të gjatë na dalin dhe foljet në paskajore: **me ble:**, **me pre:** (bukën, mishin etj.), **me le:**, **me spre:h** (thikën, briskun etj.), etj.

Në përdorimin e paskajores së disa foljeve zanorja **e** nuk e ka shkallën e gjatësisë së fjalëve të tjera siç i pamë në shembujt që dhamë më sipër, sepse, siç do të

¹³ Shih: L.Mulaku, *vep. cit.* f. 34.

¹⁴ Fjalët **le:h-a** “emër”, ku mbillen qepët, specat, domatet etj., dhe **le:h** “folje” (qeni) janë homonime.

shohim dhe më vonë kur të bëjmë fjalë për veçoritë e paskajores së foljeve, disa folje na dalin në paskajore me temë të zgjeruar me **-ën/-un** (më shumë dëgjohet si **-ën: me lëshën, me krëshën, me hjékën, me dékën, me pjékën, me gjétën, me térën, me djégën me prékën, me përshëshën,** etj.

Zanoren e më të gjatë kanë mbiemrat: **e re:, i le:t, i nxe:t, i shkret** për aq sa kemi mundur ta përcaktojmë me veshë, në krahasim me mbiemrat: **i pje:kun, i dje:gun, i rre:shkun, i kre:hun, i qe: thun, i spre:hun, i te:run,** etj.

Shënim. Folja në paskajore **me spre:h,** e cila përdoret në këtë trajtë në të folmen e Petreshticës me rrethina, në shumicën e të folmeve të tjera të gegërishtes veriore përdoret në formën **me mre:h.**

Zanoren ë të shkurtër e hasim në fjalët: **djëp, plëp, thëp, grëp, xhëp, çëp, çël, çëls, djël dhe djëm; shës, prës, nxhës, vës, i këç dhe këç, djë, nëjhër pardjë, vjët, sivjët** etj. Në këtë pikë e folmja jonë nuk dallon nga të folmet e tjera të gegërishtes veriore.

Shënim. Zanorja e e emrit **qengj** në këtë të folme kthehet në **i: kënxh** (i u:rt si **kënxh; kënxhi** bu:t i thi:th dy nãna, etj.). Nuk është pa interes të theksohet që i vetmi shkrimtar i vjetër shqiptar, Buzuku në veprën e tij “Meshari” e ka shënuar këtë emër në trajtën **qengj-i** : hinje **qengji** i tinë Zot (Shih Kolë Ashta, *Leksiku historik i gjuhës shqipe, I*, f. 425, ndërkaq të gjithë autorët e tjerë të vjetër zanoren e të temës e kanë kthyer **i: qingji**. Trajta **kënxh-i**, përveç në të folmen e Petreshticës sot përdoret edhe në të folmet e arealit të gegërishtes veriore. Arsyet përse këto të folme e ndryshuan trajtën e këtij emri nga **qengj-i** në **kënxh-i**, nuk i dimë saktësisht, por kjo ndoshta ka të bëjë me vetë psikologjinë e folësve të këtij krahu të shqipes.

Zanorja e bie së shqiptuara në diatezën pësore-vetvetore të foljeve të kohës së tashme, sikurse në të folmet e tjera të gegërishtes veriore, si p.sh.: **lahna** (<lahem); **lahum** (<lahemi), **lahni** (<laheni); **msohna** (<mësohem), **msohum** (<mësohemi), **msohni** (<mësoheni), etj. Në kohën e pakryer të diatezës pësore foljet marrin përpara pjesëzën **u**: **u lajshna** për: lahesha), **u lajshmi** për: laheshim, **u lajshi** për: laheshi, **u lajshin** për: laheshin¹⁵, etj.

Sikundër në të folmet e gegërishtes, edhe në të folmen e këtij fshati zanoren e në funksion të mbaresës kanë dhe mbiemrat e gjinisë femërore për t'u dalluar nga mashkullorët: **e zi:me**, **e bleme**, **e thyme**, **e shkurtume**, **e lame**, **e lyme**; **e terne**, **e fshine**, **e blune**, **e martune**, etj.

Shënim. Folja **shtremnoj** (<*shtrembënoj*, *shtrembëroj*) në të folmen e këtij fshati, si dhe në shumë të folme të gegërishtes veriore zanoren e të temës e kthen në **a**: **shtramoj** (mos e **shtramo** telin, murin, etj.!, po m **shtramon** kah po flas, etj). Megjithëkëtë, zanorja e ruhet kur fjala në shqyrtim përdoret si mbiemër: **i shtrëmt**, rri **shtrëmt** e fol drejt, etj.

Zanorja gojore e haset në të folmen tonë në fjalët: **vetull/vetlla**, **petull/petlla**, **sjetëll/sjetlla**, **setër/setra**, **letër/letra**, **mjegull/mjeglla**, **hekër/hekri**, **mjekër/mjekrra**, **dhelpën/dhelpna**, **lepër/lepri**, **thekën/thekna**, **breshën/breshni**, **delme/delmja**, **shelnje/shelnja**, **sekull/seklla**, **deti**, **ngjeti**; te foljet në vetën e parë njëjës të së tashmes së dëftores : **çethi**, **krehi**, **ngjeshi**, **çeli**, **ngjehi**, **veshi**, **teri**, **dredhi**, **sprehi**, etj.

Zanorja i

27. Zanoren **i** të gjatë e hasim në emrat: **shpi:**, **ri:g**, **ri:z**, **li**: “lia e ujit”, **bli**:

¹⁵ Shih për këtë fenomen fonetik dhe L. Mulaku, *vep. cit.*, f. 36.

(<bliri), **çi:k, thi:k, si:ll, kmi:sh, lejthi:, gurabi:, mërzi:, tepsi:, jahni:,** etj.; në emrat e prejardhur me prapashtesa: **burrni:, miqësi:, hajni, jarani:, dredhi:,** etj.; në mbiemrat: **i zi:, i ri:, i mi:r, i shli:r, i pi:t** “i dehur”, **i ɳri:t, i mërddhi:t,** etj.

Me **ɳ** të shkurtër po shënojmë këto fjalë që i kemi vjelë në ligjërimin e banorëve të këtij fshati: **līs, fīs, plīs, mīk, nīp, gīsht, bīsht, brīsk, trīm, tīm, i lig, i prīsht, i krīst,** etj., të cilat përdoren kështu edhe në të folmet e tjera të gegërishtes. Me **ɳ** të shkurtër përdoren në këtë të folme edhe shumë fjalë me burim oriental në trajtën e tyre të pashquar, si: **ībrig, īlaç, īftar, īkrar, ītībar, ībret, īgball, īmam, īnsān** e shumë të tjera si këto.

Shënim. – Zanozja **i** është shndërruar në **y** në fjalët **krÿp** (<kripë), **rrÿp** (<rrip), **rripoj** (mishin), **xhylpān** (<gjilpanë/gjilpër), **shyptar** (<shqiptar), flas **shÿp** (<shqip), etj.

Një **ɳ** të shkurtër kanë dhe emrat e gjinisë mashkullore në këtë të folme, kur përdoren në trajtën e pashquar, si ata të burimit të shqipes, ashtu edhe ata me prejardhje orientale: **Agīm, Fitīm, Festīm, Lulzīm, Gxīm, Burīm, Blerīm; Īdriz, Īsmet, Ībush, Çerīm, Hasīm, Bislīm, Muslī, Shefkī, Sadrī, Sherīf**¹⁶, etj.

Siç e ka vënë re edhe L. Mulaku për të folmen e Shalës së Bajgorës që “në ndonjë formë foljore nuk shqiptohet **i**-ja e patheksuar **çitne..., rrxone** lisiin!, **falnu** diçka...!, **epnu** u:j kuale!, etj.” (vep. cit, f. 40), ky konstatim i tij vlen edhe për të folmen e Petreshticës dhe për të folmet e tjera të gegërishtes veriore, pra në vend të: **qitnie!, rrxonie!, falniu!, epniu!** etj. përdoren trajtat e foljeve pa **i**: **çitne!, rrxone!, falnu!, epnu!**.

Zanozja **i** me sa kam mundur të vërej në disa fjalë zbërthehet në **ie**: **shtier, shpirt, mier, tierç.**

¹⁶ Për zanoren **i** të shkurtër (të patheksuar) të emrave orientale, shih dhe M. Halimi, vep. cit., f. 123.

Ky tingull nuk zbërthehet në **ie kie** në shumësin e emrit **ka-u**, në këtë të folme **kavi**, siç ndodh në shumë të folme të gegërishtes verilindore, sepse në këtë të folme si duket ka rënë zanorja **e** e togut **ie**, prandaj na del me **i: ki: kãm dÿ ki:**; po vi:n **ki:t**, etj.

Zanorja **i** zbërthehet në **ie** në emrin **hierr-a** “lëng me ngjyrë të kaltër që del pasi të shtrydhet djathi”.

Zanoren gojore **i** e hasim në fjalët: **livore, livroj (<lavroj), zhbiroj, libër, kime (<qime), kitërr, biber, hise**, etj.

Zanorja o

28. Me zanoren **o** të gjatë në të folmen e Petreshticës kemi hasur emrat: **mo:ll, shko:ll, to:k, do:r, lo:p, ro:g, rro:g, co:p, so:rr, zo:rr, sho:k** “brez leshi me ngjyra që mbështjellin burrat rreth mesit të trupit”, **kro:js, shpo:js**, etj. Me **o** të gjatë kemi dhe disa emra të prejardhur me prapashtesa, si: **lakno:r, kuçullo:r, kamsor:r, punto:r, malso:r**, etj.

Po kështu me zanore të gjatë përdoren në këtë të folme dhe fjalë të tjera, si mbiemrat: **i ho:ll, i fo:rt, i plo:t, i njo:m**; foljet në paskajore, si: **me ko:rr, me fo:l, me përdo:r me shko:ç**, etj.

Me **o** të shkurtër përdoren foljet në vetën e tretë njëjës të kohës së kryer të thjeshtë: **pöll** lopa, e **dõxh** dielli, e **völl** krejt shka hãnjër, ai **võl**, ju **võlt**, ai **põç**, ju **põçt**, por dëgjohen dhe trajtat me zbërthim të zanores së temës në **-ue: puell, duexh, vuell, hueç, pueç** etj.

Një veçori specifike e kësaj së folmeje dhe e të folmeve të pjesës më të madhe të Kosovës është kthimi i **o**-së në zanoren **a** në disa fjalë, si: **ariz** (<oriz), **apãñ** (opingë), **ladroj** (<lodroj), **nashta** (<ndoshta), **katalik** (<katolik), **t-halloj** (<t-holloj), **t-hallu:s** (t-hollues), **vanoj** (<vonoj), **ka vanim** se pshtim nuk ka: , **axhak** (< oxhak), **dallap** (<dollap), **kallan** (< kollan), **Ashlan** (<Oshlane) etj.

Shënim. - Në të folmen e Petreshticës përdoret forma foljore **shakloj** : (unë) e **shakloj** kallamoçin. Forma e foljes **shakloj**, sipas të gjitha gjasave është një formim dialektor brenda kësaj së folmeje, nëpërmjet kthimit të zanores **o** në **a** të fjalës **kokërr**, pra nga **kokrroj** > **akrroj**, pastaj **shakloj** , diku në të folme të gegërishtes **çkokloj**; në Petreshticë parashtesa **shk** është parësore ndaj **çk**-së së disa të folmeve, e cila në foljen përkatëse është thjeshtuar në **sh** : **shakloj**.

Dukuria fonetike e shndërrimit të zanores **o** në **a** nuk i ka përfshirë disa fjalë të huazuara, si: **sokak**, **oborr**, **ortak**, **okolla**, **topall**, **kosoj** , **çoban** , **opet**, **kovaç** , **konak** , etj.

Zanoren **o** gojore e ndeshim në fjalët: **kókërr**, **kódër**, **mótër**, **kóçe**, **i vógël**, **i póshtër**, **sófër**, **kóre**, **bóshçe**, etj.

Zanorja u

29. U-në e gjatë e ruajnë emrat: **ku:ll**, **bu:rr**, **fu:rr**, **fu:sh**, **bu:k**, **bu:z**, **lu:g**, **su:k**, **fu:rk**, **dru:**, **pu:n**, **bu:rr**, **shku:m**, **tu:t**, etj.; mbiemrat: **i bu:t**, **i shku:rt**, **i u:rt** etj.; foljet: **me mu:sh**, **me hu:p**, **me shku:n**, **me tu:n**, **me lu:t**, **me tu:t**, etj.

Shënim. Emrat **grunë/grurë** dhe **gjumë** në të folmen e Petreshticës, të Shtimes e të fshatrave përreth saj si dhe në zonën e Drenicës dhe në fshatrat e shpatit të Çiçavicës, të cilat administrativisht i takojnë komunës së Vuçitërnës, në trajtën e pashquar përdoren me zanoren **a** të shkurtër emrat asnjans të dikushëm: **grün**; kam miell **grün**; është **n xhüm** (< në **gjumë**).

Me zanoren **ü** të shkurtër përdoren në të folmen e Petreshticës dhe fjalët: **pllög**, **plüm** (me shkri: **plüm** te falltorja), **shkrüm** (buka ish bë **shkrüm**; ju kishin bë bu:zt **shkrüm**), **bük** (ma jep do **bük**, unxhu se po ha:m **bük**, **brüm** “miell gruri i

gatuar me ujë”, **t mrëm:** a e ke shti: **t mrëmt** e bukve; **lÿg, pÿs, rrÿsh, shÿl, nÿl**, (ra:sh me krye **nÿl** tepo:sh; ose: u rrxue **kryenÿl**); ndajfoljet: **ÿrt, shkÿrt** (foli **shkÿrt** e shÿp), **bÿt** (nuk u vra se ra: **bÿt**), **trÿp**, ndajfolje :i ra: **shkÿrt e trÿp** punës, dhe **trÿp (-i)** emër (i njeriut, i drurit) - fjalë homonimike me kuptime të ndryshme.

Shënim.- Me zanoren e shkurtër **u** përdoret në të folmen e Petreshticës edhe përemri pronor në trajtat rasore të numrit shumë të **të tÿ:** djemt (dhe djelt) **e tÿ;** i (e) djemve (djemve) **tÿ;** djemve (djemve) **tÿ;** djemt (djelt) **e tÿ;** pej djemve (djemve) **tÿ.**

Shënim 1. - Zanorja e patheksuar **u** bie së bashku me bashkëtingëlloren **b** të togut **mb** në fjalën **mbuloj: mloj , mlou** me jargan se mus po nerth; shplo shpi:n e **mlo** hajatin!; si ndajfolje: rri **mluet (<mbuluet/mbuluar)**, etj.

Shënim 2. – Zanorja **u** e patheksuar e rrokjes së dytë rrutulloj (<rrotulloj), bie krejtësisht në të folmen e Petreshticës: **e rrutlloj, e rrutllova** sãnën n livadh.

Zanorja e patheksuar **u**, e cila në disa fjalë dëgjohe më shumë si –ë, bie në trajtën e shquar të fjalëve: **petëll – petlla, sekëll – seklla, vetëll – vetlla** (po m kruhet **vetlla**), **hatull - hatlla, sjetëll – sjetlla, kumull – kumlla, shpatull – shpatlla, lepër – lepri, ndrikull – nriklla, flutur- flutra, hekër-hekri, pluhun – pluhni**, etj. Rënia e zanores së patheksuar **u** në shembujt e sjellë këtu është veçori fonetike jo vetëm për të folmen që e kemi objekt studimi, po edhe për të folmet e gegërishtes¹⁷. Për ndryshim nga të folmet e këtij krahu të gegërishtes verilindore, në arealin e gegërishtes veriperëndimore zanorja **u** e patheksuar ruhet në emrat e

¹⁷ Shih: J. Gjinari, *Vëzhgime mbi të folmen e Bregut të Bunës*, DSH, I, Tiranë, 1971, f. 340; Mehmet Çeliku, *Të folmet e Kavajës*, DSH, II, Tiranë, 1974, f. 144; B. Beci, *E fomja e Luznisë së Dibrës*, DSH, II, f. 234; Xhabir Topalli, *Disa vërejtje për të folmen e krahinës së Pukës*, DSH, II, f. 293; Xheladin Gosturani, *E folmja e Hasit*, DSH, III, Tiranë 1975, f. 221; L. Mulaku, *vep. cit.*, f. 42; R. Mulaku, *Hulumtime dialektologjike dhe onomastike, Prishtinë, 2005, f. 29;*

Shënim. Shumësi i shquar i emrit **sy**: në këtë të folme na del me zanore të shkurtër **sÿt**: po m dhâmin **sÿt** kur po t shoh.

Zanoren gojore **y** e kemi hasur në fjalët: **fryj, shtyj, pshtyj, mytet (<mbytet), ty, xhyma (<gjysma),** etj.

Zanorja ë

31. Ky tingull karakteristik i gjuhës shqipe sipas masës së ruajtjes, përkatësisht rënien së tij përveç që dallon dy dialektet e gjuhës sonë, toskërishten, ku ruhet mirë, dhe gegërishten, ku në mjaft shumë raste ka rënë së përdoruri, ai paraqet dallime edhe brendapërbrenda të folmeve të gegërishtes, disa nga të cilat e ruajnë në një masë të konsiderueshme, kurse disa të tjera e kanë reduktuar më fort përdorimin e tij.

E folmja e Petreshticës për sa i përket kësaj zanoreje, ajo nuk dallon shumë nga të folmet e gegërishtes verilindore. Në vijim do të përpiqemi të japim një pasqyrë të gjendjes së përdorimit të kësaj zanoreje në të folmen tonë. Veçoria kryesore e zanores **ë** në folmen e Petreshticës është kryesisht mostheksimi ose gjysmëtheksimi i saj. Kjo ka të bëjë edhe me të folmet e gegërishtes verilindore.

Zanorja **ë** në pozicionin fundor të fjalëve në këtë të folme ka rënë krejtësisht së përdoruri, kështu që rënia e saj ka shkaktuar zgjatjen e zanores që ndodhet përpara saj, si: **dja:l, fja:l, sha:l, na:t, fa:r, la:r, ça:f, rra:s, drra:s, da:rdh, shka:ll, be:s, pe:l, de:r, the:rr, dri:t, bi:r, çik, to:k, do:r, bo:r, u:dh, gu:sh, fu:sh, pu:l, gju:m, shku:m, gry:k, py:k, çy:k, i ba:rdh, i ga:t, i tha:t, e ze:z, e shkret, e bu:t, me ma:rr, me da:l, me ma:t, me ha:p, me shka:p, me da:th, me ke:p, me the:rr, me he:rr, me te:r, me dre:dh, me li:dh, me ko:rr, me mu:sh, me ly:p,** etj.

Kjo zanore ka rënë në rrokjen e parë të këtyre emrave e mbiemrave: **vlla:** (<vëlla), **lku:r** (<lëkurë), **pllëm** (<pëllumb), **prall** (<përrallë), **kmi:sh** (<këmishë), **gxim**

(<gëzim), **shpi:** (<shtëpi), **i smu:t** (<i sëmuni); në rrokjen e parë të foljeve: **knoj** (<këndoj), **lshoj** (<lëshoj), **kput** (<këput), **rrxoj** (<rrëzoi), **gxohna** (<gëzohem); në mes të fjalës: **dalldy:sh**, (<dallëndyshe); në rrokjen e parë të ndajfoljeve: **knej** (<kënde), **ktũ** (<këtu), **kshtũ** (<kështu), etj.

Zanorja ë ruhet para konsonanteve të lëngëta **l, r, rr:** **gogël, tamël, i vogël, motër, zemër, votër, kodër, vjehërr, katër, hatër, motër, zemër, sofër, votër, gërshâ:n, ânërr, dimën, krahën, vogël (i,e), derën (mshile), natën, ditën, dorën, jetën, tjetër, kërkoj, kërkim (nuk e na:l kërkimin); kapërcej, shtërhoj, mërzi:, mërzitna, përziej, përmi:, përpara, përfuni, përte (<përtej), përpje:t, përgjigjet, etj.**

Zanorja ë ruhet edhe në rasën kallëzore të emrave: pa:sh në **dhëpën, gjarpën, fëmën;** vrava **kâmën, dorën;** e lidha **lopën;** preva ose qirova **mollën;** livrova **arën, nëjta me motrën,** etj.

Zanorja ë hapet në e në fjalët: **ledi:n** (<lëndinë), si dhe gjatë përdorimit të disa fjalëve në rasat gjinore, dhanore e rrjedhore: **fushes, udhes, gushes, petes, peles,** etj.

Kjo gjysmëzanore kthehet në u në fjalët: **kumo:n** (<këmbo:n), **darsum** (<darsëm).

Zanorja e patheksuar ë në një numër mjaft të madh të fjalëve kthehet në **i:** **livore** (<lëvore) , **gishtëj** (<gështenjë), **çiro:js** (<qërrojsë), **i çiruem** (<i qëruem < i qëruar), **Shinxherxh** (<Shën Gjergj / Shmitër e Shinxherxh; Shinxherxhit nxehet moti); **thënjill** (<thëngjill), **filçi** (<fëlqi), **çnis** (<qëndis), **qilloj** (<qëlloj), **çiroj** (<qëroj), **livroj** (<lëvroj<lavroj), **shiloj** (<shëloj <shaloj), **xhimoj** (<gjëmoj < gjamë), **gishtëj** (<gështenjë).

Shënim. – Gjysmëzanorja ë kthehet në i në fjalën **lëngo**, e cila në këtë të folme dëgjohet: **liñoj; liñim; “i ka ra: liñimi”.**

Hundorësia e zanoreve

32. Një ndër fenomenet fonetike që i dallon dy dialektet e gjuhës sonë është dhe nazalizimi i zanoreve, i cili në një rën anë e ka gegërishtja, kurse në anën tjetër i mungon dialektit të jugut. Të folmet e dialektit të gegërishtes i karakterizon prandaj hundorëzimi i zanoreve, të cilave (zanore hundore) të folmet e toskërishtes i përgjigjen me zanoren **ë** ose me zanore gojore. Së këndejmi mund të theksojmë që të gjithë dialektologët, të cilët kanë studiuar të folmet e dialektit të veriut, kanë vënë re hundorëzimin e zanoreve, kështu që domosdo në studimet e tyre për të folme të caktuara të gegërishtes, kanë pasqyruar fenomenin fonetik të hundorësisë. Duke mos e parë të arsyeshme të ndalemi në shtjellimet që kanë bërë ata për të folmet e veçanta e të caktuara që kanë marrë të studiojnë, po theksojmë që e folmja e Petreshticës bën pjesë në grupin e të folmeve që kanë shkallë të lartë hundorëzimi të zanoreve. Zanoret hundore në të folmen tonë dhe në të tjerat e gegërishtes veriore kushtëzohet nga prania e konsonanteve nazale **m, n, nj**.

Në ligjërimin e këtij fshati me hundorësi mjaft të lartë shqiptohet zanorja **a** në fjalët: **kâ:m** (emër) - **kâm** (folje) **dhânërr, nânërr, krâne, e xhumá**, e **hâne, gërdhâ:j, lâ:m, tãmël, zâ (-ni), râ:n, i râ:n, njâni, rrâja, xhâ-ja** (a i ke lshue **xhân** me kullo:t; erdhën **xhâja**; çysh **u bâ si xhâja**), **me dhân, me thân, me lân, me bâ:., shkâm, dhâm, thâm,** etj.

Zanoren hundore **e** e gjejmë në fjalët: **pêm, rrêm çên, lén, vén, sên, një-ja** (s **kâm një**), **rrên, mên** (e **kâm** ner **mên** e nuk e harroj), **sên, shêj, pé, fré, ré, skêj, mréna, pés, émën, fémën, e êjte,** etj.

Gjithashtu me hundorësi të lartë dëgjohen dhe zanoret e foljeve: **m rrêjte**, kishe pas **rrê:.**

Nuanca hundorësie kanë dhe zanoret **i, u** dhe **y** në fjalët: **mullî, fî, flî; hû:mëz, hû:n, krûne, shkû:m, smû:t; çÿ:Ë, frÿ:m, brÿ:m** etj. Me hundorësi kemi dhe fjalët: **mâgu**, **i mânt, i hânt, t hântit** etj.

Zanore hundore të shkallës së lartë hasim dhe në shumësin e emrave: **dhên, mên,**

çén.

Me hundorësi të shkallës së lartë shqiptohen dhe zanoret e përemrave dëftorë në rasën kallëzore: **atá, ktá**, (arën) **táne**, dhe në emërzimin e përemrave: ta mora **tánën, tëmën** e mora e **tánën** ta lash. Me zanore hundore është dhe togfjalëshin **vėnı jém.**

Diftongjet dhe togjet e zanoreve

33. Diftongjet ose togjet e zanoreve në këtë të folme në më shumë raste janë janë monoftonguar se sa që ruhen. Mbështetur në këtë fakt mund të thuhet se ato kanë prirje të monoftongohen kështu që në një të ardhme dhe mund të monoftongohen plotësisht. Megjikëtë, ka mundësi që ndryshimet shoqërore që janë bërë këto vitetet e fundit, pas luftës së fundit në Kosovë, ndërtimi i infrastrukturës rrugore, zhvillimi i hovshëm i arsimit, mjetet e informacionit, shtypi ditor, televizioni, përhapja e standardit gjuhësor të shqipes etj., të ndikojnë në ruajtjen e togjeve zanore.

Togu **–ue** dëgjohe **u** në fjalët: **gru:** / **gruja**, mirëpo: kjo **grue** është e ve:j ; **kru:** (po shkoj **n kru:** me ma:rr u:j); **thu:** (<thue), **ftu:** (<ftue), **prru:** (ra:sh **n prru**) , **patku:**, **mu:j** (<muej): shkoj edhe kë **mu:j/** po vjen **muji** tjetër; ti **thuj** dishka atij, a **kërku:t** boll/ na **kërku:m** boll; **lu:j!** po **lu:jm** me shäh; **trull** (<truall), **bu:ll** (<buall); un po **shkru:j**, ai po **shkru:n**; aj **du:l**; na **dulum**, ata **dulën**, etj. Nga shembujt që sollëm më sipër mund të përfundojmë që togu zanor **–ue** në rrokje të hapur ndonjëherë mun të dëgjohe se ruhet, pra mund të realizohet i plotë, ndërsa në rrokje të mbyllur ai pothuajse në të gjitha fjalët që përdoret është thjeshtuar në **–u**.

Shënim. – Te disa fjalë është përdorur togu zanor **–ue**, **si: laknuer tërthuer, kungulluer**, të cilat sot kanë përfunduar në trajtat: **laknu:r, tërthu:r, kuqullu:r**, kurse në disa të tjera të ngjashme ai është mbledhur në **–o: kallnor, puntor, qershor**.

Togun **ie** e kemi hasur të ruajtur në fjalët **diell, miell, nieri**, mirëpo, në trajtën e shquar: **dilli, milli, çilli** (toka e **çilli** me u bashkue se ajo që ka marue (<përfundue) s kthehet mâ:); **me nxierr, me viedh, me verr, me piek, me hiek**, etj.

Shënim . - Konstatimi ynë i mëparshëm, qoftë në lidhje me ruajtjen eventuale të togut zanor **-ue** dhe qoftë me thjeshtimin e tij të përgjithshëm në rrokje të mbyllur të fjalëve, vlen edhe për togjet e zanoreve **-ie, -ye**.

Togun **ye** e hasim të monoftonguar në emrat: **fy:ll** (<fyell), **kry:** po m dhëm **kry:t** (<kryet); **dy:r** (<dyer), etj.

Me diftongun e mirëfilltë **-je** përdoren foljet: **vjedh, mjell, hjek, pjek, djeg, mjel, vjel, sjell**, etj.

Po kështu diftongun **-je** e hasim dhe në emrat: **bjëshk, sjétull, pjépën, mjéshtër, vjésht**, etj.

Togu zanor ae

34. Togu zanor **ae** ruhet në këtë të folme në vetën e dytë njëjës të foljeve supletive në të kryerën e thjeshtë të dëftores, si: ti: **pae, lae, rae, thae, dhae**. Ky fenomen fonetik ngjitet pastaj në të folmen e Kamaranit e të Balincës dhe pastaj zbret në juglindje nëpër grykën e Carralevës në fshatrat e tjera të Shtimës, të Lipjanit dhe vazhdon në të folmet e Ferizajt me rrethina, në të folmet e Kaçanikut, të Karadakut të Gjilanit¹⁹, dhe dredhon pastaj në të folmet e Maqedonisë, ku përfshihen Dibra,

¹⁹ Shih për shtrirjen e këtij fenomeni fonetik dhe M. Halimi, *E folmja e Karadakut* dhe literatura e cituar aty, f. 134.

Luma, Mati, Mirdita e deri dhe Malësia e Tiranës. Këtë tog zanor e hasim dhe në shkrimet e vjetra të shqipes. Kështu, te Buzuku: ti përse më **pae**, besove (2, 253); ti **thae** keq për një gruo o vajzë (2, 63); Kushdo **të hae** këtë bukë (2, 277); te Bogdani: Hina ndë shtëpijt tande... e as më **dhae** një shenj (II, 61); ti mue më **lae** kështu? (II, 122); **pae**, plagët' e mia (II, 136);

Togu zanor oe

35. Ky togzanor përdoret në të folmen e këtij fshati në foljet në mënyrën urdhërore, si: **voe** (<vezë), **veneroe**, **vnoe** (<vnoje), **vanoe** (<vonoje), **çoe** (<çoje), **paloe** (<paloje), **shliroe** (<çliroje), **xhbiroe** (<zhbiroje), **maroe** (<mbaroje), **harroe** (<harroje), **shkatrroe** (<shkatërroje) , **shkurtoe** (<shkurtoje), **shkakardhoe** (<shkokërdhoje), etj.

KONSONANTIZMI

36. Për sa i përket konsonantizmit në përgjithësi, siç kemi përmendur edhe në fillim të pjesës së Fonetikës, kjo e folme përkon me të folmet e gegërishtes verilindore²⁰, sipas të cilave kemi 27 fonema bashkëtingëllore. Në grupin e këtyre të folmeve të gegërishtes, pra, bashkëtingëlloret mesgjuhore **q, gj** janë kthyer në paragjuhore **ç,xh**.

Në këtë të folme si dhe në ato të gegërishtes verilindore kemi dhe shkrirjen e grupit konsonantik **ng** në **ñ**, një tingull karakteristik që realizohet në fjalët **bûñ, cûñ, dâñ, lûñ, Fâñ, shllûñ, me hâñër**, etj.

Po kështu bashkëtingëllorja një përgjithësisht në fund të fjalëve është thjeshtuar në **-j**: **rrâj, t rij, ftoj, thoj, prroj** etj., kurse ruhet në numërorin **njâ**, në përemrin e pacaktuar: **njâni, njâna, asnjâni, asnjâna, kurrnjâ, kurrnjâna**, etj.

Gjithashtu kemi vënë re që togjet e bashkëtingëlloreve në këtë të folme, si dhe në të folmet e gegërishtes në përgjithësi janë asimiluar në konsonant tjetër, ose janë thjeshtuar në njërin konsonant. Për të gjitha këto fenomene konsonantike do të shohim gjatë shtjellimit të tyre veç e veç.

Bashkëtingëllorja h

²⁰ Bëjnë përjashtim të folmet e Luginës së Preshevës, ku realizohen që të 29 fonemat konsonantike të gjuhës shqipe.

37. Ndër bashkëtingëlloret që meritojnë të shqyrtohen hollësisht në studimet dialektologjike është **h**-ja, e cila në disa të folme të shqipes ka pësuar ndryshime më të mëdha, në disa të tjera është dobësuar së shqiptuari, kurse në disa të folme ruhet më mirë. Për sa i përket konsonantit **h** e folmja e Petreshticës bën pjesë në grupin e të folmeve të shqipes që në rastet më të shumta e ka ruajtur mirë së shqiptuari. Kjo bashkëtingëllore ruhet mirë së shqiptuari në të gjitha pozicionet që ka në fjalë, pra në fillim, në mes dhe në fund të fjalës. Në fillim të fjalës është krejtësisht e natyrshme që **h**-ja shqiptohet më mirë se në pozicionet e tjera, e sidomos në krahasim me rastet kur ndodhet në fund të fjalës.

Në fillim të fjalës kemi këto raste të ruajtjes së bashkëtingëllores grykore **h**: **hána, havája, hût-i, hû:n, hekër, hîthî, hûmëz, nî hër** boll â me j thân ati: që merr vësh, **hekër, hî-ni, hû-ni, i hu:j** (<i huej / i huaj), **hama:r, hesa:p, hatër; harroj, me hâjër**, etj.

Në mes të fjalës: **vjehrra, vjehrri, prèhën** (unxhu n **prèhën tém**), **pluhni, sahat, zahmet, nihma** e Zotit; në përbërje të foljeve: **kthehna, nxehna, nxehet, nxehmi, nxehni, krihna, krihesh, krihet, krihmi, krihni, krihen; i sprèht**, etj.

Në fund të fjalës: **âh-i, pleh-i, teh-i, krah-i, shoh, nxhoh, nxeh, krih, xhinah, sabah** etj. Kjo bashkëtingëllore dëgjohet edhe në fund të emrave personalë të burimit oriental, si: **Sallah, Fetah, Salih, Be:h, Fe:h dhe Fehmi**, etj.

Në këtë të folme, ashtu si dhe në ato të gegërishtes verilindore, nuk ekziston dukuria e kthimit të **h**-së në **f** me përjashtim të dy-tri rasteve. Kështu, p.sh. kemi ruajtjen e **h**-së në fjalët: **njoh, shoh, pleh, teh, ñre:h, lèh**, (ti mos **lèh** aty!, mirëpo: çeni **le:h**), **kreh, i krehun**, por në vetat foljore: **krihna, krihesh, krihet; i prèht** dhe **i sprèht, nihma** etj. Ashtu si dhe në disa të folme të gegërishtes verilindore edhe në të folmen tonë kemi me **f** në vend të **h**-së fjalët: **ftoft** (sivjet pranvera â kê:n e **ftoft**; çiky thmi: **â fto:f** etj.) dhe **i msheft**.

Shënim. Foljen **njoh** e kemi dëgjuar të jetë përdorur në këtë të folme me këto

forma; me **f** në rastet: **me njo:ft; ku me njo:ft** çë s e kâm pa: kÿrr; dhe me **h: po t njoh; a njîhnî** ju ner veti?, etj. Po kështu, herë me **h** e herë me **f** përdoret dhe folje **shoh: shihe** ti nî hër!, dhe **shife**.

Bashkëtingëlloret q, gj, ç, xh

38. Siç e thamë edhe më parë kur filluam t'i shqyrtojmë bashkëtingëlloret e kësaj së folmeje, po ritheksojmë që në të folmet e gegërishtes veriore dhe në të folmen tonë, e cila bën pjesë në këtë grup të folmesh, ndryshimet më të mëdha kanë pësuar këto çifte bashkëtingëlloresh, madje deri në shkallën e thjeshtimit të tyre në një çift të vetëm, pra grupi i palataleve **q, gj** është shkrirë në grupin e afrikateve **ç,xh**.

Në shkrimet e vjetra të gjuhës shqipe, duke filluar nga vepra e parë, “Meshari” i Gjon Buzukut (1555), dhe duke zbritur shkallë-shkallë në shekujt e mëvonshëm nëpërmjet veprave të Pjetër Budit, Frang Bardhit, Pjetër Bogdanit, Kuvendit të Arbënit e deri te Gjon Nikollë Kazazi këto dy çifte bashkëtingëlloresh na shfaqen të dallueshme qartë midis tyre. Me këtë rast nuk e shohim të arsyeshme të sjellim shembuj nga ato shkrime të shek. XVI-XVIII për të dëshmuar dallimin e tyre, sepse një gjë e tillë dihet nga të gjithë gjuhëtarët që i kanë pasur në dorë veprat e këtyre shkrimtarëve. Mirëpo këto i thamë për të dëshmuar që trazimi i këtyre bashkëtingëlloreve në të folmet e gegërishtes veriore, dhe sidomos në ato që i përkasin grupit të të folmeve të gegërishtes verilindore, ku bën pjesë dhe e folmja e Petreshticës, ka nisur gjithsesi pas shekullit XVIII. Ndryshimi i shqiptimit të këtyre grupeve bashkëtingëlloresh në këto të folme të shqipes ka tërhequr vëmendjen e të gjithë studiuesve dhe dialektologëve shqiptarë e të huaj që janë marrë me studimin e të folmeve të gegërishtes. Me gjithë përpjekjet e tyre për të

përcaktuar saktësisht kohën kur këto dy palë çifte bashkëtingolloresh²¹ janë shkrire në afrikatet **ç,xh**, ato edhe sot mbeten të pasqaruara mirë. Pa u ndalur në hetimin dhe në shtjellimin e kësaj problematike gjuhësore, unë mund të them që sot në të folmen e Petreshticës hasim vetëm në shqiptimin e afrikateve **ç, xh** dhe kanë dalë nga sistemi i ligjërimit palatalet **q, gj**.

Me bashkëtingëlloren **xh** kemi vërejtur se shqiptohen fjalët: **xhāk** (<**gj**ak,-ku), **xhárpën** (<**gj**arpër/**gj**arpër), **xhilpā:n** (<**gj**ipanë/**gj**ilpërë), **i xha:ll** (< **i gj**allë), **i xhā:n** (<**i gj**anë/**i gj**ërë), **xhásht** (<**gj**ashtë), (un) **xhāj** (< **gj**ej), **xhimoj** (<**gj**ëmoj), **xhujë!** (<**gj**ueje/**gj**uaje); **xhūm** (<**gj**umë), **xhuetar** (<**gj**ahtar), **xhúmǎ!** (<**gj**uejma/**gj**uajma); **xhym** buke, e dava **përxhymst**; **xhith**, **dixhet**, **axhak**, **ho:xh**, **xhām-i**, **xhami:-a** etj.

Me **ç** kemi shënuar këto fjalë: **miç**, **pleç**, e **kuçe**, e **keçe**, **çafa**, **viçi**, **çekiç**, **çeni**, **façe**, **çetha**, **knaçna**, e **shoçja**, **i shoçi**, etj.

Shënim. – Vlen të theksoj që bashkëtingëllorja palatale **q** në të folmen e Petreshticës është kthyer në **k**, sikurse në të folmet e tjera të gegërishtes verilindore²², në fjalët, **ke:p**, ~**a** (< **qepë**,~**a**), **me kepën** (< me qepë, qep), **kërr,-i** (<**qer**re,-**ja**), **me keshën** (< me qeshun/qeshur, qesh), **kinxh** (<**qengj**), **kime** (<**qime**), **kelb** (<**qelb**), **qelbna** (**qelbem**), **i kelpt** (<**i qelbun/i qelbur**), **me shky:m** (zjarrin) (<shqim, shuaj, fik), **keramikë,-a** (<**qeramikë,-a**) etj.

Shënim 1. - Në të folmen tonë kemi jotizimin e **gj** e të **q**-së në **j** në fjalët: **zajt**, **zajt** (<**zogj/zogjtë**), **shoqishojnë**, (<**shoqi shoqin**) (bu:k) e **kallamojt** (< **kallamboqtë**).

Shënim 2. - Fenomenin fonetik të kthimit të palataleve **q, gj** në **j** e hasim shpesh në shkrimet e vjetra të shqipes, po sidomos në veprën “Çeta e profetëve” e P.

²¹ Nuk duhen ngatërruar këto me grupet e bashkëtingëlloreve *kl, gl*, siç del nga persiatjet e M. Halimit, për të folmen e Karadakut, f. 168, sepse këto janë krejtësisht të tjera.

²² Shih dhe L. Mulaku, *E folmja e Shalës së Bajgorës*, f. 59.

Bogdanit (1685), siç mund të dëshmojmë me këta shembuj: **plejt = pleqtë; të lijtë = të ligjtë; Mijt e kashunë = miqtë e dashunë; anëmijt e tij = anmiqtë e tij; të kejtë = të keqtë; ndojnë, hojnë, pojnë për: ndoqën, poqën, hoqën, etj.**²³

Bashkëtingëllorja nj

39. Kjo bashkëtingëllore në të folmen e Petreshticës nuk paraqet ndonjë dallim specifik nga të folmet e tjera të gegërishtes verilindore e as nga të folmet e tjera në fqinjësi me ligjërimin e këtij fshati. Nj-ja fundore në shumësin e emrave na del e thjeshtuar në -j, si p.sh.: **thoj (<thonj), ftoj (<ftonj), kroj (<kronj); prroj (<përrenj/përrenj), hûj (<hunj), gûj (<gjunj <glunj), pëj (<penj), frëj (<frenj), mullî (<mullinj), ullî (<ullinj), druj (<drunj), etj.** Po kështu nj është thjeshtuar në -j në fjalët: **e zoja (<e zonja), t rij (<të rinj), t zij (<të zinj), t mdhaj (<të mëdhenj), barij (<barinj)** fem. **baresha**; te foljet në të tashmen dhe në të pakryerën e dëftores: **punoj (<punonj), punojshna, punojshe, punojshum nga: punonje, punonje, punonim, punonit ,punonin** te autorët e vjetër veriorë dhe te P. Bogdani.

Po kështu kjo bashkëtingëllore është reduktuar në -j në emrat etnikë e fisnorë, si: **shaljan, sopjan, thaçjan, gashjan** nga: **shaljan, sopnjan, thaçnjan, gashnjan.**

Në sistemin e numërimit vetëm numri i parë dëgjohej **njâ**²⁴, kurse të tjerët që kanë pasur dikur bashkëtingëlloren **nj** janë thjeshtuar në -j: **nimdhe:t, dymdhe:t, tremdhe:t, nizet, tridhe:t, pezdhe:t, gjazhdhe:t, etj.**

Bashkëtingëlloren **nj** e hasim në këtë folme dhe në emrin **njerka** (u bájke zullum thive t kti burrit); në foljen **njoh** (**çatâ** pe **njoh** se e kam pa: diku); te përemrat e pacaktuar: **njani, njana, asnjani, asnjana, kurnnjana, etj.**

²³ Ky fenomen fonetik i karakterizon: *Të folmen e Çamërisë; të Plavës e Gucisë* etj. Për këtë shih: Qemal Haxhihasani, *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë*, DSh, I, Tiranë 1971, f. 149; Mehmet Ahmetaj, vep. cit., f. 86.

²⁴ Kur përdoret si përemër i pacaktuar para një emri del në trajtën **nî : nî fja:l, nî bu:k, nî mäl, nî mo:ll** etj.

Bashkëtingëlloret th, dh

40. Këto dy bashkëtingëllore në këtë të folme, sikundër edhe në të folmet e tjera të gegërishtes verilindore ruhen pothuajse gjithherë mirë dhe nuk këmbehen me njëra-tjetrën. Pra thuhet: **thana, thika, thēmra, thām, thot, tha:sh, me thā:n, thès, ku:rth; dhi:, dhāmi, dhāmalla, me dhā:n, m dhēm**, etj. Duhet të thuhet që në pak fjalë th-ja këmbehet me f-në, si në rastet: nga i thellë kemi **ufull** nga **uthull, i fe:ll, kthjellt > kfjellt**. Në këtë të folme nuk kemi vërejtur ndonjë rast që bashkëtingëllorja **dh** të jetë këmbyer me ndonjë konsonant tjetër.

Bashkëtingëlloret th, f Në këtë të folme vërehen disa fjalë në të cilat kemi këmbimin e këtyre dy bashkëtingëlloreve. Kështu, p.sh. thuhet **thmî** për **fëmijë**; **the:rr-a** në vend të **ferrë-a**, **me therrën** në vend **me therrë**. Mirëpo më shumë raste ndeshim kur fjalët shqiptohen me **f** në vend me **th**, si: **flâ:z**²⁵ për thëllëzë, **ufull** për uthull, **i fellë** për i thellë, **u kfjell** moti, **po kfillet**; sod është **kfjellt**, di:t e **kfjellt**, për: i kthjelltë, **kfiellet, kfjellt**.

Bashkëtingëlloret z,x

41. Këto bashkëtingëllore në raste të rralla këmbehen me njëra-tjetrën ose thënë më saktësisht **x**-ja përdoret në vend të **z**-së. Kështu, p. sh. në vend të fjalës **gëzim** në këtë të folme përdoret trajta **gxim**: sod kena **gxim**, jena **gxue** ç i na ka fa:l Zoti nî dja:l. **Gxim** përdoret edhe si emër njeriu. U **rrxue** (<**rrëzue**) djali u sakatue n nî guri! **Kallxoj** (<**kallëz**) ma mi:r ti se me nie pej dikuj tjetër.; **rrxu:ll**: I ka da:l nî **rrxu:ll** n sy: e pe vret; **xekërr-i**: Löp i hājër **xekrri**. Ndonjëherë edhe vetë barinjte e cytin zekthin që t' i pickojë bagëtitë duke përsëritur fjalën **xekërr-**

²⁵ Emri i këtij shpendi në shumicën e të folmeve të Kosovës përdoret në trajtën **flānx**. Me këtë kemi dhe emërtime personash të gjinisë femërore **Fllanxa...**

xekër! Kështu

Edhe emri i shpendit **thëllëzë** përdoret në këtë të folme me kthimin e **z-s** në **x:** **flā:z**. Po shtojmë edhe dy – tri fjalë në të cilat bashkëtingëllorja **z** kthehet në **x:** e kish **xba:rdh** (<zbardhë) bora; me i **xgi:dh** (< zgjidhë) llopt e me i çit: jasht me pi: u:j; Mus e **xgat** (<zgjat) shumë kit pu:n, po kpute ma:.

Bashkëtingëlloret I, II

42. Në të folmen e Petreshticës ruhen mirë këto dy konsonante, ashtu siç ruhen në mbarë të folmet gegërishtes verilindore. Kështu kemi fjalët: **lis, livadh, lām, lu:l, pu:l, brrÿl, bylbyl, si dhe me II: pllām, llām, çakall, çaka:ll, bakall, hamall** etj. Po përmendim që nuk ekziston dukuria e këmbimit të bashkëtingëllores **II** me **dh**, siç ndodh në disa të folme të Malësisë së Madhe dhe në të folmen e shqiptarëve të fshatrave të Podgoricës e të Tuzit.

Bashkëtingëlloret dridhëse r, rr

43. Në të folmen e Petreshticës, sikurse në mbarë gegërishten verilindore ruhen mirë këta dy tinguj dhe nuk ndodh që të këmbehen me njëri-tjetrin. Kështu kemi fjalët me **r**, të cilat dallohen prej atyre që përmbajnë **rr**-në:

a:r : a:rr; la:r, fa:r, ve:r, de:r, do:r, kore, nÿ her, me te:r.

Në një fjalë, që nuk është veçori vetëm e këtij fshati, po edhe e të folmeve të tjera të Kosovës, në vend të **r**-së përdoret **rr**-ja: e ka **the:rr me thi:k, e therri** në vend të **e theri**.

GRUPET E BASHKËTINGËLLOREVE

44. Një ndër dallimet karakteristike të dy dialekteve të gjuhës sonë është sot e dy shekujt e fundit problemi i togjeve të bashkëtingëlloreve. Dihet historikisht që gjuha shqipe që nga shkrimet e para të saj që nisin në shekullin XVI në të dy dialektet e saj i ka ruajtur më mirë togjet e bashkëtingëlloreve. Më vonë, gjatë zhvillimit të gjuhës sonë ato kanë filluar të pësojnë ndryshime e thjeshtime ndër dialekte e ndër të folme të ndryshme diku më shumë e diku më pak.

Grupet kl, gl

45. Togjet e vjetra konsonantike **kl, gl** sot për sot paraqesin dallime të mëdha në gjuhën shqipe dhe në dialektet e saj. Dihet historikisht që të folmet e toskërishtes jugore, përfshirë këtu të folmet e Çamërisë, toskërishten lindore të anës së Korçës,

të folmet e fshatrave shqiptare të Greqisë e të Ukrainës dhe pjesërisht arbëreshët e Italisë e kanë ruajtur gjendjen e vjetër të tyre: **klaj, klenë, klumësht, klishë, gluha, gluni, i glatë**, etj. Ndërkaq, në gjendjen e hershme të tyre këto togje ruhen edhe në “Mesharin” e Gjon Buzukut (1555). Gjendjen e vjetër të tyre edhe pas pesë-gjashtë shekujsh e ruajnë të folmet e Çamërisë dhe ato të kolonive shqiptare në Greqi dhe, siç thamë, pjesërisht edhe të folmet e diasporës së Italisë, të cilat në kohën kur u shkulën nga trangu etnik i morën ashtu me vete dhe i ruajtën të pandryshuara deri në ditët e sotme.

Për sa i përket toskërishtes veriore, gegërishtes jugore dhe të folmeve të Shqipërisë së Mesme këto grupe të vjetra konsonantike **kl** ka dhënë **q**: **klaj >qaj, klenë > qenë, klumësht >qumësht** etj., dhe **gl** ka dhënë **gj**: **gluha >gjuha gluni > gjuni, i glatë > i gjatë** etj. Me reduktimin e grupit **gl** në **gj** dhe **kl** në **q** i hasim këto grupe konsonantike edhe te Budi: mbë të dyy **gjunjët** (Pasq., f. 22); petëka të zeza e të **gjata** (Pasq., f. 364); t i përkasë majenë e **gjuhësë** (Paq., f. 369), etj.

Të folmet e gegërishtes veriperëndimore këto grupe i ruajnë në një gjendje të ndërmjetme: **kl**: **kj**: **klaj**: **kjaj**, me **klenë > me kje:n, klumësht > kjumësht; gjuha > gjuha, gluni > gjuni, i glatë > i gjat**:t etj. Me këtë pamje na dalin dhe te Bogdani, në veprën e tij “Çeta e profetëve” (1685), sipas së cilave mund të supozojmë që në të folmet e gegërishtes veriore në atë kohë kishim përgjithësisht atë gjendje të këtyre grupeve të vjetra bashkëtingëlloresh. Edhe sot në të folmet e Rugovës, të Malësisë së Madhe, të Kelmendit, të Hotit etj. ruhen grupet në fazën **kj, gj**: **kjaj, kjen, gjuni, i gjat**:t. (Shih Gjovalin Shkurtaj, **E folmja e Kemendit** DSH 1975, Menduh Begolli, **Disa veçori fonetike për të folmen e Rugovës**, L. Mulaku -M. Bardhi, **E folmja e Peshterit**, etj.

Ndërkaq, e folmja e Petreshticës së bashku me të folmet e gegërishtes verilindore këto grupe të vjetra bashkëtingëlloresh i ka thjeshtuar **kl**-në në **k**: **klaj > kaj, me klenë > me kâ:n, klumësht > kumsht**; dhe **gl**-në në **g**: **gjuha: guha; gluni > guni, i glatë : i ga:t, ndigloj : ngoj**. Gjurmë të togjeve të vjetra konsonantike **kl, gl** në të folmen tonë nuk kam hasur, por të gjitha fjalët që dikur do t’i kenë pasur ato sot na

dalin me velaret e thjeshta **k, g: kaj, me kajtën, koft mir!, me kánun, kumësht, ki:sh; gu:h, guni, i ga:t,** etj.

Studiuesit që janë marrë me të folmet e gegërishtes verilindore në të cilat e grupet e vjetra konsonantike **kl, gl** i kanë gjetur të reduktuara në velaret **k, g** kanë shfaqur mendimet e tyre për mënyrën se si kanë evoluar nga gjendja lashtë e tyre në format më të thjeshta që kanë sot. Një palë studiuesish pa ndonjë argument bindës mbron pikëpamjen që grupet e vjetra **kl, gl** kanë kaluar në gjendjen e thjeshtë **k, g** në të folmet e gegërishtes verilindore drejtpërdrejt, do të thotë pa ndonjë fazë ndërmjetësuese. Ndërkaq, pala tjetër, si: Waclaw Cimohowski²⁶, Idriz Ajeti²⁷, Agnia Desnickaja²⁸, Latif Mulaku, duke pasur parasysh që në disa të folme anësore të gegërishtes veriore ende kemi gjurmë të një faze të ndërmjetme të tyre (k_i,g_i) ndoshta kanë më shumë të drejtë që evoluimin e tyre e shohin nëpërmjet një faze të ndërmjetme, e jo të drejtpërdrejtë.

Toğu bashkëtingëllor lk

46. Grupi i lashtë konsonantik **lk**, i cili ruhet mirë te shkrimtarët e vjetër: te Buzuku, te Budi dhe te Bogdani në një numër të kufizuar fjalësh të gjuhës sonë, si p.sh.: **bulk-u** te Buzuku: “u hinje se të vinjënë ditë që të afëronetë **bulku** me korrësit (2, 299) (Shih: Prof. dr. Kolë Ashta, *Leksiku historik i gjuhës shqipe I*, f. 263); “aj në patë **ulknë** se vjen, le dhentë e ikën; e **ulku** i grabitën e i përda” (Meshari i Gjon Buzukut, 2, Prishtinë, 1987, f. 253); te Budi: e çart gjithë **bulqitë** (D, 77); te Bogdani: “ duel **bulku** me mbjellë “ (II II, IV, 3) (Shih Prof. Dr. Kolë Ashta, *Leksiku historik i gjuhës shqipe IV*, Shkodër, 2002, f. 131); në të folmen e Petreshticës dhe përgjithësisht në gegërishten verilindore është asimiluar në **k**, nga **ulk** kemi trajtën **ük**. Në të folmet e Kosovës dhe bashkë me këto edhe në të folmen e këtij fshati, nga trajta e hershme e emrit të kafshës së egër mishngrënëse

²⁶ Waclaw Cimohowski, *Le dialecte de Dushmani*, Poznan, 1951, f. 23.

²⁷ Idriz Ajeti, *Pamje historike e ligjërimet shqip të Gjakovës në fillim të shekullit XIX*, Prishtinë 1960, f. 43.

²⁸ Latif Mulaku, *E folmja e Shalës së Bajgorës*, Prishtinë, 2005, f. 70.

ulk kemi dhe emra njerëzish dhe mbiemra **Ujkan-i** - e një faze të ndërmjetme , dhe **U:k-a**, faza e fundit e evoluimit të saj. Mirëpo, është me interes të vëmë këtu në pah faktin që ka mendime që mbiemri i shkrimtarit më të vjetër të një vepre të shkruar në gjuhën shqipe **Buzuku**, pjesa e dytë e tij të konsiderohet si kompozitë dhe të lidhet me emrin e kafshës së egër mishngrënëse **Buz-** dhe **Ûk**. Unë nuk pajtohem me një mendim të tillë për faktin që derisa edhe sot kemi në gegërishten fazën e ndërmjetme evolutive të emrit të kësaj kafshe **Ujkan-ni** si emër personi dhe si mbiemër, nuk ka mundësi të ketë evoluar kaq herët në shekullin XVI faza e hershme **ulk** në **uk**.

Grupet e bashkëtingëlloreve dj, tj

47. E folmja e fshatit Petreshticë si dhe ajo e fshatrave të Shtimës e të arealit të Lipjanit, ndonëse me ndonjë veçori dialektore përkon me të folmen e Karadakut të Gjilanit²⁹, në realizimin e togjeve të këtyre bashkëtingëlloreve nuk vërehet fenomeni fonetik i asimilimit të tyre, d.m.th., nuk përkon me të folmen e Kardakut të Gjilanit, sepse ato ruhen mirë si në pjesën më të madhe të të folmeve të gegërishtes dhe përgjithësisht të shqipes: **dje, djepi, djathi, djali, atje, tjetër**, e jo **xhe, xhepi, xhathi, xhali, açe, çetër**.

Grupet e bashkëtingëlloreve mb, nd, ng, ngj

48. Në fillim të shtjellimit të këtyre togjeve të bashkëtingëlloreve po theksojmë që ato sot paraqesin dallime dialektore për faktin që toskërishtja i ka ruajtur të plota, pra të pathjeshtuara, kurse të folmet e gegërishtes, sidomos ato të pjesës veriore, gjatë zhvillimit historik të tyre i kanë ndryshuar, përkatësisht i kanë asimiluar në

²⁹ M. Halimi, *Vep. cit.*, f. 183.

konsonante të thjeshta.

Grupi bashkëtingëllor mb

49. Në të folmen e Petreshticës ky grup bashkëtingëllor është thjeshtuar në **m** në të gjitha pozicionet e fjalës. Për të dëshmuar këtë që thashë, po sjell shembuj nga ligjërimi i kësaj së folmeje.

Toğu mb në fillim të fjalës: **maroj** (<mbaroj), **e mloj** shpi:n (< e mbuloj shtëpinë), **me mytën** (< me mbytë), **me mushën** (<me mbushë), **me ma:thën** (<me mbathë), **mrêna** (<brenda), **mesa** (<mbesa), **mas** (<mbas), **met** n balt (<mbeti në baltë); **maj** kerrin (<mbaj qerren);

Toğu mb: m në mes dhe në fund të fjalës: **kâma** (<kamba), **dhâmi** (<dhambi), **krÿm** (<krimb), **pllÿm** (<pëllumb); **i âmël** (< i ambël), **e trêmi** zogin (< e trembi zogun);); **rrê:m** (<rremb); **kumull** (<kumbull), **krym** (<krymb), ra: n **fun** d bunarit (ra në fund të bunarit), **m dhimet** (< më dhimbet); **m dhêm** (< më dhemb) **shtrêmt** (< shtrembët); **mret** (<mbret), **me mle:dh** (< me mbledhë), **me mu:shën** kallamoçin (<me mbushë kallamboçin), **me mlue** shpi:n (<me mbulue shtëpinë) etj. Edhe te numërorët toğu **mb** është thjeshtuar në **m: nimdhe:t** (<njëmbëdhjetë), **dymdhe:t** (<dymbëdhjetë), **tremdhe:t** (<trembëdhjetë) etj. Në shkrime të vjetra ky grup bashkëtingëllor përgjithësisht ruhet i plotë. Këtë e dëshmojnë veprat e autorëve të vjetër shqiptarë të cilët, me përjashtime të rralla, e kanë shënuar të plotë.

Është me shumë rëndësi të vëmë në dukje që në foljen **humb** në këtë të folme ruhet grupi bashkëtingëllor **mb** i plotë, si dhe në fjalën e prejardhur prej saj me prapashtesën – **s : humbs**. Prej subjektit nga i cili kemi vjelë pjesën më të madhe të lëndës gjuhësore për këtë të folme dëgjuam format foljore: **un humba, ti humbe, aj humbi; na humbëm, ju humbt, ata humbën**. Po ashtu, ky subjekt tregoi që kur kanë luajtur në të kaluarën lojën me filxhana, tha që grupi që ka

fituar lojës është quajtur **fitu:s**, kurse tjetri që e ka humbur lojën është quajtur **humbs**.

Shënim.- Po theksoj që në të folmet e tjera të Kosovës dhe më gjerë, edhe në fjalën **humb** togu konsonantik **mb** është shkruar në **p**: **hupa, hupe, hupi, hupum, hupt, hupën** dhe formimi **hups**.

Togu mb është asimiluar në **p** në fjalët: **pshtjell** (<mbështjell), **me u pshtetën** (< me u mbështetë); **prâm** (<mbramë), **me hu:pën** (< me humbë); nieri **i hupt** (<njeri i humbun). Edhe në të folmen e Rugovës dhe të Malësisë së Madhe (të Hotit, të Grudës, të Shkrelit, të Kelmendit etj.) togu **mb** në disa fjalë është thjeshtuar në **m**: **mesa, mren, musha**³⁰ etj., dhe mb:**p**: **m dhê:p dhâpi** (<më dhemb dhambi); **me projt, mren**.

Grupi bashkëtingëllor nd

50. Edhe ky tog bashkëtingëllor në të folmen e Petreshticës si dhe në të folmet e tjera të gegërishtes verilindore ka pësuar po ato ndryshime që i ka pësuar togu bashkëtingëllor **mb**, që pamë më sipër.

Në fillin të fjalës **nd** e gjejmë të thjeshtuar në **n** në fjalët: **nera** “ t u rrit **nera**” (<nderi), **me nê:jt** (< me ndejtë), **njej** (<ndiej), **nreçi** (<ndreq), **nrysh** (<ndryshe), **njek** (< ndjek).

Në mes dhe në fund të fjalës **nd** është reduktuar në **n** në fjalët: **huna** (<hunda), **me tu:n** (< me tundë), ra: n **fun** d bunarit (ra në fund të bunarit) **fun-i** i bukës, **me shku:n** (< me shkundë), â unxh krye **vënit** (< vendit), **mênja** (<mendja), ta ka ma:rr briskin **tân** (<tand), **i ra:n** (< i randë/i rëndë), **dhânërr** (<dhëndër), **ânërr** dhe **nânërr** (<andër), **krâne** (<krande), **krune** (<krunde), **me dhê:n** (< me dhend /gdhend), **katun** (<katund), **me j shku:n** (<shkund) mollat; aj nuk **lkunet** (<lëkundet) veni; t’u baft **shnet!** (<shëndet), **i shno:sh** si molla(< i shëndoshë),

³⁰ B. Beci, *E folmja e Shkrelit*, DSH, I, 283.

niçin (<njëqind), **dyçin** (<dyqind), **treçin** (<treqind) e kështu me radhë.

Nd >d: u da: (< u nda) përxhymst³¹.

Nd ka dhënë **t** në fjalën mbiemërore **i smu:t** (< i sëmundë), dhe në atë foljore jam **smu:t** (< jam sëmundë).

Nd ka dhënë **dh: me dhe:z** (<me ndezë).

Togu ng

51. Edhe ky tog bashkëtingëllor ka pësuar ndryshime në të folmen e Petreshticës si dhe në të folmet e tjera të gegërishtes verilindore. Mirëpo togu bashkëtingëllor **ng** në këtë të folme dhe në disa të folme të gegërishtes është reduktuar në një tingull karakteristik, të cilin po e pasqyrojmë me grafemën **ŋ**. Pra fjalët që në gjuhën shqipe kanë togun bashkëtingëllor **ng** në ligjërimin e banorëve të Petreshticës artikulohe kështu: mus u **ŋucnĭ** (<ngucni), thmija çaty **ŋucen** çaty pajtohen e nuk bân me ma:rr idhnĭm për ta, u çue e e muer **ŋrÿk** (<ngryk < në grykë); p m **peŋon** shum ajo pu:n; t ftohtit e madh e kish **ŋrĭ** e kish ba: kaçan; **shtërŋoe** pak ma shum e mus e lësho pej dore; shlironu pak se çaty jini **ŋÿsht**; **kÿŋull**, e çojke n shpi:n nĭ **dãŋ** dru:, **kãŋ** (<kangë/këngë), **apãŋ** (<apangë<opingë), **rrãŋ** ja la çë u vanue kaç shum; **lãŋ** “ngjyjeje n lãŋ”, me **hãŋër**, **thiŋill**, **shllÿŋ**, **mallÿ:ŋ** “ si i kish ra me guri n krye ju kish çue **mallÿ:ŋ**, etj.

Shënim. – Në të folmen e këtij fshati përdoret fjala **mëŋez-i**, me të cilën emërtohet koha gjatë verës, kur barinjtë i kthejnë bagëtinë në shtëpi për t’i mjelë e për të pushuar ata vetë për disa orë për shkak të vapës. Në disa të folme të Kosovës këtë kohë e emërtojnë me fjalën **mejjez-i**, si p.sh., në Shalë të Bajgorës, në fshatrat e Vuçitërnës, të Llapit, të Gollakut etj.

Grupi ngj

³¹ Është interesant që edhe te Buzuku këtë fjalë e hasim me **d**: “muorë tepetëkatë e tii e **i danë** n katër pjesësh (2, 225); e u dëftuon gluhë **të dame** (2, 265).

52. Ky tog bashkëtingëllor ruhet mirë pothuajse në të gjitha fjalët në të folmen e Petreshticës, prandaj sipas realizimit të tij nuk dallon nga të folmet e tjera të gegërishtes verilindore³², mirëpo vlen të themi që bashkëtingëllorja palatale **gj** shqiptohet si **xh**. Kjo veçori fonetike pa dyshim që i karakterizon edhe të folmet e tjera të gegërishtes verilindore. Së këndejmi, sikundër në të folmet e tjera të këtij areali dialektologjik edhe në të folmen e Petreshticës kemi këto fjalë në të cilat ruhet togu konsonantik **ngj: shinxherxh** (< Shën Gjergji), **kinxh** (<qengi)³³, **nxhvej**, **nxhesh**, **nxhiti** ki:t n kerr, **nxhall**, **nxhinoj**, **i nxho:m** etj.

Pajtohem me konstatimin e L. Mulakut³⁴ që mënyra e realizimit të grupit bashkëtingëllor mund të merret edhe si një ndër veçoritë që i dallon të folmet e gegërishtes verilindore nga ato të asaj veriperëndimor. Derisa në të folmet e arealit dialektor, ku bën pjesë dhe e folmja e Petreshticës ruhet i pandryshuar togu bashkëtingëllor **nxh**, si në shembujt që sollëm më sipër, në të folmet e krahut tjetër të të folmeve të gegërishtes të ashtuquajtura grupe perëndimor grupi bashkëtingëllor në fjalë kthehet në **nj: njeshet, me e njy, i njesim, njala**³⁵ etj., **thenjill, jau njiti, Shnjon, Shnjergjit, me njesh** etj.³⁶; **njâl**(< ngjalë), **i njelm** (< **i ngjelm**)³⁷ **njeshi brëzin, nja:l, ja njiti për krahit**³⁸ etj. Vlen të theksohet që edhe brendapërbrenda krahut të gegërishtes veriperëndimore, togu bashkëtingëllor, përveç që është kthyer në **nj**, ka reflektuar dhe forma të tjera, si **ngj: gj; ngj :q**³⁹.

³² Për grupin e bashkëtingëlloreve në fjalë shih, për krahasim, dhe këto të folme: L. Mulaku, *vep., cit.*, f. 73,74; R. Mulaku, *vep., cit.*, f. 42; M. Halimi, *vep., cit.*, f. 191; Xh Gosturani, *vep., cit.*, f. 224; Imri Badallaj *E folmja e Hasit*, Prishtinë, 2001, f. 99.

³³ *Qengj* e ka edhe "Meshari" i Gjon Buzukut (1555) "E të venë qengjatë mbë të djathët tii (Meshari i Gjon Buzukut, 2, Prishtinë, 1987, f. 123.

³⁴ L. Mulaku, *vep., cit.*, f. 73.

³⁵ Jorgji Gjinar, *vep., cit.*, f. 344.

³⁶ Bahri Beci, *E folmja e Shkrelit DSH, I*, f. 284.

³⁷ Gjovalin Shkurtaç, *E folmja e Hotit, DSH, II*, f. 369.

³⁸ Mehmet Ahmetaj, *vep., cit.*, f. 102.

³⁹ Gj. Shkurtaç, *Vep., cit.*, f. 369; M. Ahmetaj, *vep., cit.*, f. 102.

Grupi bashkëtingëllor fsh

53. Në të folmen e Petreshticës ky grup bashkëtingëllor ruhet në fjalët: **rrafsh-i** : u rrxue n tah t **rrafshit**; **rrafshite** aborrin pak ma mi:r; po i bien teshat **rrafsh** taman! ; **fshi:s**, **me fshi:**, **ko:fsh**, **kafshoj** “ruju se po t **kafshon** çeni!, **rrnofsh**; në mënyrën dëshirore të foljeve: **kofsh** shnosh, sa **kofsh rrnofsh!**, **bafsh** ma mi:r, **u lafsh** n xhak! **pafsha** shnosh!, **ta pafsha hajrin!**, mir **vofsh!**, **vofsh** si je ni:s! n **rafsha** çatje zor ç i dal mâ: , **t’u thafshin** duert po ku i pate sy:t ç i t pshtoj thmija!; mus **pifsh** ma:, etj.

Shënim. – Në këtë të folme nuk ruhet i plotë në fjalët: **koshore,-ja** (e bukës) nga **kafshore** dhe **mnash-i** (< **mëndafsh**), **kmi:sh** e **mnasht**, etj.

Grupi tsh

54. Grupi bashkëtingëllor **tsh** është shkrire në ç në fjalët: **i moçëm** (<i motshëm), **i meçëm** (< i mendshëm > ment/t +shëm)⁴⁰, **viç** (<vitsh), **në vjeç** (<një vjetsh), sa **vjeç** je?; **përpeç** < për petsh)⁴¹.

Grupi shk

55. Në shqyrtimin e grupit bashkëtingëllor **shk** duhet të kihet kujdes që të mos ngatërrohet me parashtesën **sh-** që shërben për formimin e fjalëve. Nisur nga ky qëndrim, në të folmen e Petreshticës, e cila në këtë pikë fonetike përkon me të folmet e zonës së Shtimës, të Lipjanit, Ferizajt, Kaçanikut dhe të Karadakut të Gjilanit, kemi vërejtur këto fjalë me togun shk: **shkoç**, **shka** (<çka)⁴² ; te emri

⁴⁰ Shih për këtë çështje fonetike dhe L. Mulaku, *vep. cit.*, f. 74/75.

⁴¹ Shih: M. Halimi, *vep. cit.*, f. 197/198.

⁴² Prof. Çabej duke iu sjellë fjalës përemërore **çka: shka** e shpjegon si” një nga fjalët e dala në ngërthim të fjalisë, një përemër i përfutur në sandhi prej fjalisë pyetëse **ç’ka?** Me fjalë të tjera unë mendoj që këtu

shku:l-a, shk-ja është pjesë përbërëse e fjalës, sikundër që është dhe te fjalët **shkabë, shkurre, shkel, shkal,** dhe ajo e tëra lidhet me kuptimin e emrit që ka të bëjë me jashtëqitjen e fëmijës ose të të rriturit që ka diarre, purthë, heqje barku. Së këndejmi, në fjalët që kemi vjelë nga kjo e folme, si: **shkarkoj, shkrep, shkrij, shkep, shkoç** si dhe në ato që ka sjellë M. Halimi për të folmen e Karadakut, si: **shkatërroj, shkyej**⁴³, **shkrij,** e ndonjë tjetër, po të vështrohet nga pikëpamje etimologjike e tyre, do të konstatojmë që kemi të bëjmë jo me togun **shk-** po me parashtesën **sh-**. Mirëpo, meqenëse në ballë të këtyre fjalëve kemi **shk-**, si dhe në disa fjalë të tjera, si: **shkrrojej, shkepi, shkërdhej, shkrehu, shkruaj** e ndonjë tjetër si këto, edhe ne në punimin tonë po e klasifikojmë në grupin e togjeve të bashkëtingëlloreve.

Grupi ts

56. Në të folmen e Petreshticës në një numër fare të vogël fjalësh grupi konsonantik **ts** ka dhënë **c**, përkatësisht **x**. Ja disa shembuj: **tuts >tux,** butësinë **> buci:n** “tokë e lagësht, që mban ujë pothuajse tërë vitin” ; kjo fjalë gjendet edhe në mikrotoponimi **Bucina;** mot + s + an+ik)⁴⁴ **> mocanik; ata jan mo:c; balcak** (< baltë +s + ak) “vend me baltë, si dhe thuhet për perimet që zbuten tepër dhe bëhen si baltë”.

kemi të bëjmë me trajtën e shkurtër të përemrit **ç** dhe të foljes **ka,** pra **ka, është, ekziston diçka brenda.** Marrë parasysh këtë që thamë, në këtë fjalë vërtet nuk kemi të bëjmë me togun bashkëtingëllor **shk,** po fjala është për parashtesën **sh-**.

⁴³ Këtë fjalë Çabej na e jep me *shkyej* dhe e lidh me lat. *clades* “prishje, shkatërrim” (Shih: Dr. Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore III,* Prishtinë, 1976, f. 179.

⁴⁴ Shih dhe L. Mulaku, *vep. cit,* f. 75.

DUKURITË FONETIKE

57. Ndryshimet ose ndërrimet në gjuhën shqipe vihen re që nga periudha e shkrimeve të para të gjuhës sonë, të cilat pastaj në periudhat e mëvonshme të zhvillimit që ka pësuar gjuha jonë me dialektet dhe me të folmet që e përbëjnë, qoftë brenda shqipes, qoftë nën ndikimin e faktorëve të tjerë, sidomos të vetë psikikës së folësve që kërkojnë mënyra për të lehtësuar shqiptimin e fjalëve që përdorin në komunikimin e përditshëm mes vete. Në këtë mënyrë folësit e gegërishtes veriore kanë shkurtuar fjalët në fund të tyre, duke bjerë zanoren fundore dhe për pasojë të kësaj kanë zgjatur zanoren e rrokjes fundore: **ba:shk,**

rra:s, kre;sht, mo:ll, shko:ll, i ho:ll, do:r, pu:n, u:dh, u:r, bi:m, etj. nga: **bashkë, rrasë, kreshtë, mollë, i hollë, dorë, punë, udhë, urë, bimë,** etj. Folësit e këtij areali gjuhësor kanë shkurtuar, bashkë me zanoren fundore që kanë bjerrë, edhe grupe tingujsh, si: **shllû:ŋ** (<shtëllungë) , **shmá:ŋ** (<shtëmang), **shpi:** (<shtëpi), **drra:s** (<dërrasë); **buci:n** (<butësinë), etj.

Disa emra në trajtën e shquar e kanë bjellë zanoren e trajtës së pashquar, si: **kuŋllí** (<kungulli) **nriklǎ** (<ndrikulla), etj.

Shurdhimi

58. Fenomeni fonetik i shurdhimit të tingujve në këtë të folme ka përfshirë bashkëtingëlloret e zëshme **b, v** kur këto ndodhen para konsonanteve të shurdhëta **t, c**, si p.sh. **t elpta**: bu:k **t elpta** < të elbta; **t tharpta**: molla **t tharta** < të tharbta; **t kalpta** : pë:m **t kalpta** < të kalbta, **t kelpta**; **d vrukta** : bu:k **d vrukta**; **i krymt** < i krimbët, **i tharpt** < i tharbët, **i kalpt** < i kalbët, **i vrukt** < i vrugët etj.

Në fillim të fjalës **zinxhir-i** është shurdhuar **z**-ja në **s**: **sinxhir**, si dhe në fillim të fjalës **zurna** në këtë të folme kemi **surrla**. Po kështu, në fund të fjalëve **borxh** dhe **harxh** bashkëtingëllorja e zëshme **xh** në të folmen e Petreshticës është shurdhuar në **ç**: **borç, borçi** nuk prët dīt t mira, po laje kur munesh; â rra:s n **borç** deri n fyt; bleva **harç** për shpī; i paske qi:t pak **harç** laknorit; mus **i harçit** tâna páret, etj.

Asimilimi

59. Në të folmen tonë fenomeni fonetik i asimilimit ka përfshirë një numër të vogël fjalësh; disa të burimit të gjuhës sonë dhe disa të tjera të huazuara nga gjuhët e huaja. Që të mos i përsërisim rastet kur fjalët kanë pësuar ndryshime të grupeve të tingujve, për të cilat kemi bërë fjalë edhe më parë, këtu po kufizohemi vetëm në disa raste të tjera, ku vërehet që fjalët kanë pësuar ndryshimin e një zanoreje ose të

një bashkëtingëlloreje. Fenomenin e asimilimit e shohim në fjalën **përpjedz** (< **përpjetz**): menxi dola n krye t asaj **përpjedze**; **rrutlloj** (<rrrotulloj): **u rrutllue** dy-tri her; **e rrutllova** tetelinën për me u te:r ma mi:r; **vanohna** (<vonohem), **çeteli** <turq. çiteli, **marak** “boll **marak** jam bâ çë u vanue aj dja:l “ <turq. merak; **bylyzyk** <turq. bylezik; **kojshi**: <turq. komşu; **dallap** <turq. dollap, **rraktar** (<rrogtar), **rraktaroj** (<rrogtaroj), **tredhtue** <tradhtue, etj.

Sonorizimi

60. Në këtë të folme kemi dhe raste kur një bashkëtingëllore e shurdhët ose e pazëshme shqiptohet si e zëshme kur ndodhet para një bashkëtingëlloreje tjetër të zëshme, si p.sh. **t(ë) > d** para **b-së**: **d buta** < t buta < të buta, **d bëjt** (< të bajtunit) , **d blemit** (< të blemit), **d bardha** < t bardha < të bardha; leë **d bardhin** e merre **d zivin!**; **fyza** hin n dru:gz; **pezhgvja** (<peskve) etj.

t(ë) > d para **g-së**: **d grime/ (lakna) d grime** (< t grime < të grime), **d grimcueme** < t grimcueme < të grimcueme; **d gryta** (< të gryta <të grunjta), **d grithafta** (<të grithavta), **d gatu:me/d gatu:ne** (<të gatueme), **d gungavt** (kumpira < patate) **të gungavt, me gunga**;

t(ë) > d para **v-së** : **d veshkta** < t veshkta < të veshkta, **d vrukta** < t vrugta < të vrugta, **d vogla** < t vogla < të vogla;

s > z para **d-së**: **z don** < s don <nuk do; **z des** < s des < nuk vdes; **z dredhet** (< nuk dredhet < s dredhet); **z duhet** < nuk duhet, **z dihet** < nuk dihet; **z dahet** < nuk dahet; **z dathna** < s dathem < nuk dathem; (këto dardha) **z dugen** < s dugen < nuk dugen “nuk zbuten” ; **z deshti** me hënë (< s deshti < nuk deshi; **z dixhet** < s digjet < nuk digjet; **z doket** < s duket < nuk duket; **z dorzohet** < s dorëzohet < nuk dorëzohet; **z dryshket** < s ndryshket < nuk ndryshket; etj.

s > z para **v-së: z vjen** < s vjen < nuk vjen, **z vonohet** (< s vonohet), **z vjetroh**et kaç shpejt ; **z vriten** (< s vriten < nuk vriten); **z vyen** < s vyen, nuk vyen; **z vjell** ma: < s vjell < nuk vjell; **z vjedh** < s vjedh < nuk vjedh etj.

Zëshmimin e një bashkëtingëlloreje të shurdhët e hasim dhe në këto fjalë: **pezhgve** < peshkve, **kringëz** “lloj druri”; **xhbiroj** < shbiroj; **gxim** < gëzim, **u gxofsh!** (< u gëzofsh); **u gxofsh!** **U gxofshum!** **U gxofshi!** **U gxofshin!** dhe **Gxim** “emër vetiak” nga **Gëzim**, e me shkurtesë edhe **Xim**.

Shënim. **t(ë)** artikullohet **d** në këtë të folme kur ndodhet para konsonanteve të zëshme **b** e **dh** në shprehjet e urimit ose të mallkimit, si: **d bā:ft** mi:r! **d bā:ft** Zoti rahat!, ose Zoti mus **d bā:ft** rahat! Zoti **d dha:sht** bereqet!

Opozicioni fonologjik i zanoreve

61. Disa zanore të disa fjalëve me gjatësinë, përkatësisht shkurtësinë e tyre bëjnë dallime kuptimore. Kështu, zanorja **-ÿ** e shkurtër te numërorët **dÿ** për gjininë mashkullore: **dÿ burra**, **dÿ vet**; **dÿ ftoj** etj. ndaj zanores **y: dy:** të gjatë të emrave femërorë: **dy: gra:**, **dy: veta**, **dy: molla** etj., bëjnë dhe dallimin e kuptimit të emrave, sepse ata u përkasin dy gjinive të ndryshme: mashkullore e femërore. Gjithashtu **ă**-ja e shkurtër e emrit **plăk**, dhe **a:** -ja e gjatë e emrit tjetër **pla:k** krijojnë kundërvënje kuptimore të fjalëve të gjinive të ndryshme: mashkullore e femërore. Po kështu në emrat **măz-i** “i vogli i pelës” dhe **ma:z-a** “yndyra që nxjerrim nga qumështi” zanorja e gjatësive të ndryshme të tyre (njëra e shkurtër, kurse tjetra e gjatë) kanë dhënë fjalë me kuptime të ndryshme. Po japin edhe disa raste të tjera, në të cilat mund të shihet që gjatësia e ndryshme e zanoreve të

fjalëve krijon kuptime të ndryshme, si: **shpăt-i** dhe **shpa:t-a**; **băshk** (ndj. < së bashku, tok) dhe **ba:shk-a**, em. tubë leshi; **shtrōj** (fol.) dhe **shtro:j** (em.); **mlōj** “mbuloj diçka” (fol.) dhe **mlo:j** <**mbulojë** (em.), etj.

Edhe hundorësia e zanores ndaj zanores gojore shkakton opozicion fonologjik të fjalëve, si: **ăsh** “veta e tretë e foljes **jam**” dhe **ăsh-i** (em.); **kă:m-a** (em), dhe **kă**m (fol.), etj.

Disimilimi

62. Fenomeni i disimilimit në këtë të folme i ka përfshirë pothuajse ato fjalë që i ka përfshirë edhe në të folme të tjera të gegërishtes veriore dhe verilindore, si parafjalën **nër/ner** : fletoren ta la:sh **ner** tavuli:n; kerrin e shtina **ner** dyer t aborrit (<ndënë), **nermj**et (<ndërmjet): u hina **nermejt** se ke:n tu njarru:; **shicer** (<sheqer). Në këtë të folme kanë pësuar fenomenin e disimilimit edhe disa fjalë të huaja, me të cilat nuk po e ngarkojmë punimin tonë.

Afereza

63. Rënia e tingujve ose e rrokjeve në fillim të fjalëve vërehet në një numër të vogël fjalësh, qofshin të brumit të shqipes, qofshin të huazuara, si: **drÿshk**⁴⁵, **drÿshket** hekri; **me dekën** (< me vdekë), **me dhē:n** (< me gdhendë), **me ve:t** (<me pëvetë) **ktu** <këtu, **kshtu** <kështu; **ngōj** (<dëgjoj) etj.

Sinkopa

⁴⁵ Këtë emër Buzuku e ka shënuar me trajtën *ndryshk*, ashtu e ka shënuar më vonë edhe P. Bogdani, kurse P. Budi dhe F. Bardhi e kanë shënuar me trajtën *dryshk*, pra ashtu si e gjejmë edhe në librin e parë shqip, në “Mesharin”. Për këto trajta të kësaj fjale, shih: Dr. Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore I*, 1976, f. 372, 373. Po shtoj që edhe e folmja e Kërçovës e përdor apelativin *dryshk-u*, si dhe foljen *dryshket*. Emri *nrÿshk* dhe foljen *nrÿshket* në shumicën e të folmeve të Kosovës e hasim të përdoret me trajtat *nrÿshk*, *nrÿshket*, forma këto që kanë dalë nga thjeshtimi i togut bashkëtingëllor *nd > n*.

64. Fenomeni i rënies së një tingulli ose i disa tingujve në mes të fjalës në të folmen tonë vërehet në këso rastesh: **shllū:ŋ** (<shtëllungë), **jām n shpī** (<jam në shtëpī), **p e maroj nī shpi:** (<po e mbaroj një shtëpi); **mshel** (<mbërshel), dora e **shmajt** (<e shtëmajtë), **i smu:t** (<i sëmundë) i ra:sh trup e **t-thur:** (<tërthor); **pej** ktuhit e **dej** atje i ka: **pezdhet** metra (<prej këtu e deri atje i ka pesëdhjetë metra); **gjazhdhe:t, shtadhe:t, tedhe:t, nādhe:t** (<gjashtëdhjetë, shtatëdhjetë, tetëdhjetë, nandëdhjetë), etj.

Apokopa

65. Dukuria fonetike e apokopës, përkatësisht e shkurtimit të fjalëve nga pjesa fundore e tyre është mjaft e shfaqur në këtë të folme. Fenomenin fonetik të apokopës e hasim në pjesëzën **me** në ndërtimet: po hi: **m u la:** (<**me u la**), du: **m u** martu: (<me u martue), ju z doni **m u lo:dh** (<**me u lo:dh**) etj. Apokopën e hasim dhe në fjalët: **mazamakeç** (<mos Zot ma keq); etj. Apokopën e vërejmë dhe në trajtat e emrave: i tha:sh **babs, nāns**; i çita me hājër **lops,** etj. Po kështu këtë fenomen e hasim në rënien e zanores së temës dhe të asaj fundore në emrat e gjinisë femërore: **kmi:sh** (<këmishë), **fu:sh** (<fushë) **prra:ll** (<përrallë), **lu:l** (<lule), etj. Në disa fjalë kemi rënien e tingujve në fillim dhe në mes të fjalës, si: **i shno: sh** (<i shëndoshë), **shnet!** (<shëndet!); **knej** (<këndej), **këtyne** (<ktyne); **kshtu** (<kështu) etj. Emrat në numrin shumës e bjerrin **-nj -në** fundore, si: **t ri** (<të rinj), **kushëri /jem kushëri/** (<kushërinj), **gji** (<gjinj), **mī** (<minj), **shē:j** (<shenjë), etj. Rënie tingujsh në fund të fjalës kemi dhe në formën foljore: kishe pās **rrē:** (< rrejtë).

Epenteza

66. Në këtë të folme kemi shtimin e tingujve në disa fjalë që kanë humbur trajtën pashquar të tyre, si: **deti** (po shkoj **n deti**); **guri** (mora **nī guri** n do:r); **ýllī** po

doket **nǐ ýllǐ**); **nǐ kútǐ** (<ku:t) găt. Po ashtu shtim tingujsh kemi në këtë të folme dhe në paskajoren e foljeve: **me thanën** (<me thanë), une kam **mrriën**; kur erdha pej **ushtrijes**; **hinëm** (<hy:m) aty etj.; **i ka thérën**; **i ka bajtën**; **me pasën**, **me dalën**, **me dhānën**, **u përzitën** (< u përzien), **u zitën** (<u zien) etj. Këto trajta të foljeve në pjesën dërrmuese të të folmeve të gegërishtes përdoren kështu: (na) **hy:m/him**; **i ka therrë**, **i ka ba:jt**, **me pasë**, **me dalë**, **me dhanë**. Shtim tingujsh kemi dhe në foljet në kohën e pakryer në veten e parë njëjës: **shkojshna punojshna**, **prishna**, **blejshna**, **milshna**; **u kthejshna**, **u lodhsha**; **i thojshna** etj., si dhe në veta e foljeve: **shkyjna**, **lyjna**, **blejna**. Edhe në foljen **ec** shtohet një tingull, **-h-** ja në fillim: **me he:c**, **heci**, **he:c**, **he:c**, **he:cmi**, **hècni he:cin**; **do t hëci**. Shtim tingujsh kemi dhe në përdorimin e përemrave dëftorë, si: **atina**, **ktina**, **asajna**, **sajna**. Tingujt shtohen edhe gjatë përdorimit të ndajfoljeve të vendit që përdoren të emëruara: **pej ktuhit**; **pej atjehit**; te përdorimi i përemrave: **kjohja**, **ajohja**, **çikjohja**, **çajohja** s ã pri:t çì na xhān; çì në ã bān **çitāhen** na s e kena di:t; çì ja u bān **çatāhen** nuk e ka di:t kush etj. Dukurinë e shtimit të tingujve në këtë të folme e hasim dhe në përdorimin e disa emrave të gjinisë femërore në rasën kallëzore, si: ja çiti **kutijen** përpara!; e lshova **shpijen!**, etj.

Shënim. – Shtimin e një tingulli e kemi edhe në fjalën **hua**, e cila në këtë të folme përdoret me formën **huva**. Në këtë fjalë bashkëtingëllorja **v** midis dy zanoreve **hu-v-a** ka hyrë mendoj për bukurtingëllim, sikurse kemi dhe rastet e tjera, si: **va-u** > **vavi**, **shkavi**, **dhevi**, **shivi**, etj., nga **shkau**, **dheu**, **shiu**.

Shënim 1.- Shtim tingulli në këtë të folme nuk kemi në fillim të fjalës **ānër** >**nānër**, siç ngjet në disa të folme të tjera të Kosovës: **nānërr**; pa:sh **nānërr** diçka. Në këtë të folme, thuhet pra: pa:sh **ānërr** dishka! Mirëpo, në të folmen tonë shtimin e një zanoreje në ballë të fjalës e kemi hasur në fjalën rrszak > **errzak**. Emrat **kulm**, **helm**, **film** gjatë përdorimit në të folmen e Petreshticës na dalin me shtim të një foneme të patheksuar (hipa mi: **kulǔm** t shpi:s), **helǔm** (kǎ pi: **helǔm**), **filǔm** (e pa:sh nǐ **filǔm** t mi:r), pra me shtimin e zanores **ǔ** të patheksuar.

Trajtat e mirëfillta të këtyre fjalëve janë: **kulm-i, helm-i, film-i**, e jo *kulum, helum filum*. Për të përligjur këtë që theksuam, thuhet edhe: *kulmi* i shpi:s, e *kulmoi* shpi:n, *kulmar*; kështu edhe *helmim, helmoj; filmoj*, etj.

Vihet re shtimi i tingujve edhe në disa emra të përvetshëm, si: **Dylber** (<ylber), **Hakif** (< turq. Akif), **Hajdin** (< turq. Ajdin). Një **n** i shtohet në këtë të folme fjalës me prejardhje orientale **kapixhik**, e cila këtu përdoret në trajtën **kapinxhik**.

Aglutinacioni

67. Edhe fenomeni i përngjitjes së fjalëve në të folmen e Petreshticës nuk dallon nga të folmet e tjera të gegërishtes veriore e verilindore të gegërishtes, sepse mund të thuhet që i ka përfshirë të njëjtat fjalë. Përngjitje kanë pësuar në këtë të folme fjalët: **teknena**: pej çatyhit e **teknena**; **çatje** (<qe atje); **çaty** (< qe aty) ; **çanej** (<qe andej) i ra:n; **çitū** (qe ktu) ra:, **çishtu** (<qe kështu); **çashtu** (<qe ashtu) grahi se tybe s ta ka çit:t; **anej** (<andej), **knej** (<këndej); **çikaç** (<qe kaq); **mazamakeç** (<mos zot ma keq); **mozallah** (<mos allah); **tamlariz** (< tambël e oriz); **tāmël** (< të āmbël); **tly:n** (< të lyen); **tlanat** (< të lana,t), **tlinat** (< të lintat); **kokërrvogla** “dardha të ëmbla që kur të piqen zverdhen dhe zbuten”.

Metateza

68. Me metatezë ose me ndërrim e vendit të tingujve në këtë të folme përdoren fjalët: **lshyj** (<shlyej), **shtërnoj** (<shtrënoej): **shtërnoja** frëjt!; **pshtoj** (<shpëtoj), mir ç i paska **pshtue!** **pshtim** (<shpëtim). Metatezë të tingujve kemi vërejtur dhe në përdorimin e disa formave të foljeve, si: **po marrmi** (<marrim), na **po lypmi** (< lypim) **dalmi** (<dalim), **nxjerrmi** (< nxjerrim), **desmi** (<vdësim); **mehlem** (<melhem), **trubulloj** (<turbulloj), u:j **i trubull** (< i turbull); **lpënër** (<pendël), **me ldi:r** (< me dëlirë). Metatezë ka pësuar dhe folja **shlye**, e cila në këtë të folme dëgjohet dhe përdoret në trajtën **lshye**.

Shënim. – Konstatimi i N. Pajazitit që trajta e fjalës **tfilloj** gjoja ka pësuar metatezë nga **ftilloj**⁴⁶, është krejtësisht i gabueshëm, sepse kemi të bëjmë me të kundërtën e trajtave, që do të thotë se nga **tfilloj**, e cila është fjala parësore (sikundër që janë edhe **t-holloj**, **tlyen** etj.) , kemi trajtën me metatezë **ftilloj** në toskërishten. Së këndejmi, në të folmen tonë e as në të folmet e tjera të gegërishtes, të cilat kanë në përdorim trajtën **tfilloj**, nuk kemi të bëjmë me kurrfarë metateze, sepse baza e kësaj fjale është **fill-i**; **t**-ja e përparme e saj është parashtesë⁴⁷ nyjore, ndërkaq trajta **tfilloj** (me metatezë) e toskërishtes e ka humbur rrënjën dhe temën rrënjore të saj.

II. MORFOLOGJIA

⁴⁶ Dr. N. Pajaziti, *E folmja e Anadrinit*, Prishtinë, 2008, f. 147.

⁴⁷ Shih: Dr. Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore III*, Prishtinë, 1976, f. 182.

VEÇORI TË PËRGJITHSHME MORFOLOGJIKE

69. E folmja e Petreshticës e cila gjeografikisht shtrihet në skajin më juglindor të Drenicës, tiparet e saj morfologjike aq sa afrohen me të folmet e Drenicës po aq edhe me arealin e të folmeve të Shtimes dhe të rrethinave të Lipjanit e më gjerë. Folësit e këtij fshati në të kaluarën duke i takuar herë komunës së Kamaranit, herë të Drenasit e herë të Shtimes dhe duke pasur kontakte ekonomike tregtare e administrative me këto tri lokalitete, në pikëpamje dialektore përthyhen veçori të përbashkëta me këto vise, po edhe vërehen disa tipare të vogla dalluese. Kjo e folme e Petreshticës, marrë përgjithësisht, ka të gjitha veçoritë dialektore – morfologjike që kanë të folmet e nëndialektit të gegërishtes. Prandaj, gjatë shtjellimit të elementeve dialektore nga fusha e morfologjisë gjuhësore, do t'i vëmë në pah elementet e përbashkëta që i ka (dhe janë natyrisht më të shumta) me të folmet e gegërishtes verilindore, po në anën tjetër do t'i përveçojmë edhe ato pak elemente dalluese që e shquajnë këtë të folme nga grupi i madh i të folmeve të arealit të të folmeve të gegërishtes verilindore. Është me rëndësi të theksojmë që nga i njëjti subjekt që na ka ofruar material dialektor për këtë të folme herë-herë kemi dëgjuar dy trajta morfologjike, pra në një rrethanë të caktuar përdor një formë, ta zëmë emrin **katun**, në rastin emrin **fshat**; përdor pastaj krahas **djel**, edhe **djem**, veçori këto që kanë të bëjnë me varietetet gjuhësore ose me larminë gjuhësore, fushë kjo që i përket sociolinguistikës⁴⁸. Në larminë gjuhësore që mund të vihet re te i njëjti subjekt kanë ndikuar faktorët shoqërorë, ekonomikë,

⁴⁸ Shih për këtë çështje: Gj. Shkurtaj, *Sociolinguistika*, Tiranë, 2003.

kulturorë, politikë etj., ku hyjnë ndikimi i mjeteve të informacionit, lëvizja dhe kontakti shumë më i shpeshtë i folësve me folës të trevave përreth që i ka mundësuar rrjeti i komunikacionit, lidhja e fshatit me qendrat e qyteteve të afërta e të largëta me rrugë të asfaltuara, përhapja dhe masivizimi i arsimimit të popullatës, përhapja e mjeteve të informacionit, nëpërmjet televizionit, shtypit të përditshëm, etj. Në këto vitet e fundit të zhvillimit të gjithanshëm ekonomik të fshatrave, të infrastrukturës rrugore të tyre, vështirë është që njeriu të gjejë një subjekt të një fshati që e ka ruajtur krejtësisht e të pandryshuar të folmen tipike dialektore të dikurshme të tij. Me gjithë përpjekjet që bën subjekti për të përdorur të folmen arkaike, që e kanë folur brez pas brezi të parët e tij, ai herë-herë përdor, siç thamë, edhe varietete gjuhësore, përthyerje të strukturës gjuhësore-dialektore. Prandaj e folmja e Petreshticës, vështruar nga pikëpamja e tipareve dialektore pak a shumë të përziera sa me elemente dialektore të të folmeve të arealit të Drenicës, e atë edhe me disa veçori dialektore të të folmeve të krahut tjetër që shtrihet në anën e Shtimes, të Lipjanit, të Ferizajt, të Kaçanikut e më gjerë, dhe deri diku e ndikuar nga përhapja e gjuhës letrare, mund të konsiderohet si një pikë dialektore që përthyen varietete gjuhësore të anëve të ndryshme të Kosovës, si dhe prirje për të ndryshuar të folmen në përputhje me standardin gjuhësor. Në këto elemente të veçanta e deri diku të ndryshme dialektore të Kosovës, mund të kenë ndikuar edhe martesat e banorëve të këtij fshati me një rreth më të gjerë të Kosovës. Gjatë shtjellimit të veçorive morfologjike të folësve të këtij fshati do të vëmë në pah elementet dialektore që përkrijnë me njërin areal të të folmeve të gegërishtes, si dhe ato që përkrijnë me arealin tjetër të këtij grupi të folmesh.

EMRI

Gjinia

70. Karakteristikë e gjuhës shqipe përgjithësisht është sistemi trigjinish i emrave. Tri gjinitë e emrave në shqipen dëshmohen që në veprat e para të gjuhës shqipe të autorëve të vjetër shqiptarë, pra që nga shekujt XVI-XVII. Për sa u përket emrave të gjinisë asnjane, të cilët meritojnë trajtim të veçantë jo vetëm në të folmen e Petreshticës, po edhe në secilën të folme të gjuhës sonë veç e veç, ata në veprat tona të vjetra janë më të shumtë për nga numri. Kanë qenë të shumtë sidomos emrat asnjane që kanë emërtuar kryesisht lëndë, si: **djathtë, ujëtë, drithëtë, grunëtë, brumëtë, leshtë, mjaltë, vojtë**, pastaj **ballëtë, kryet, djalëtë, burrëtë** etj., të cilët sot ruhen më mirë në dialektin e toskërishtes. Ndërkaq, në të folmen e Petreshticës si dhe përgjithësisht në dialektin e gegërishtes këta emra si asnjane na dalin pothuajse vetëm kur shoqëron me fjalë përcaktuese: **kta djathë, kta miell, kta brumë, kta vjam, kta mish, kta tly:n, kta mja:lt, kta miell**, etj.

Kur e kemi fjalën për gjininë e emrave në të folmen e Petreshticës mund të thuhet se ende ruhen të tria gjinitë: mashkullore, femërore dhe asnjane. Nga gjithë ajo shumësi emrash të dikurshëm të mirëfilltë të gjinisë asnjane, që ka pasur gjuha shqipe dhe në këtë kuadër edhe e folmja e këtij fshati, të cilët emërtonin lëndë, si **ujëtë, djathtëtë, brumëtë, dyllëtë, mishtë, vajtë/vojtë, mjaltëtë, mielltë, elbtë,**

ballëtë etj. , e ruajnë gjininë asnjane të tyre vetëm emrat **u:jt** dhe **kryet**. Në formë të ngurosur ruhet gjinia e dikurshme asnjane edhe e emrit që ka nocionin e miellit në shprehjen: E paske përzie si **miell** e magjupës⁴⁹. Për ndryshe, ky emër mund të thuhet lirisht që në këtë të folme dhe në të folmet e tjera të gegërishtes verilindore, i përdorur pa fjalët përcaktuese, ka kaluar në gjininë mashkullore **miell-milli**. Mirëpo, ky emër si dhe emrat e tjerë asnjane, si: **grunë, drithë, mish, djathë, ujë**, kur shoqërohen me fjalë përcaktuese, herë dalin të gjinisë asnjane: **kta miell, kta drith, kta mish, kta djath, kta u:j ã ma t ftoft se ata**, po herë-herë të gjinisë mashkullore: **ky miell, ky drith, ky mish, ky djath, ky u:j**. Emri **krye,t** e ka ruajtur gjininë asnjane **kryet**: po m dhëm **kryet!** mus e ço **kryet** përpjet se d vret po:sht! Ça e ke unxh **kryet** e s po kç:yr çysh duhet! etj. Mirëpo është interesant të vëmë në pah që në këtë të folme emri **krye** në rasën rrjedhore përdoret kështu: hiçmu **krehes**; m ra: **krehes**. Në të folmet e Shalës së Bajgorës, të rrethinave të Vuçitërnës, të Llapit e të Gollakut në këso rastesh ky emër përdoret kështu: hiçmu **kre:s**, m ra: **kre:s** me grushta, po edhe hiçmu **kreje**.

Shënim. - Dalin të gjinisë gramatikore femërore emrat **mjalta, smolla, nera** (<nderi) t u rritt **nera!** ;, **ũja**: m ka ka:p **ũja**, por: **jam untue** dhe **jam ũ:nt**; **shneta**: mi:r ish **pej shnete!**; etja.

Shënim. - Në të folmen e Petreshticës thuhet: **jãm e.sht; jãm e.shtu:** . Ndërkaq, në të folmen e një pjese të Drenicës, në Shalë të Bajgorës, në fshatrat e Vuçitërnës, të Llapit e të Gollakut thuhet: **jãm ëçt; jãm ëçtue**.

Shënim 1. – Të gjinisë gramatikore mashkullore përdoren emrat: **dy:lli, djepi, kumshti, brumi, kerri, çilli**.

Përdoren në këtë të folme dhe mbiemra të substantivuar (të emëruar) me kuptimin e emrave si të burimit mbiemëror po ashtu edhe të burimit prejfoljor, si:

⁴⁹ Shih për këtë edhe R. Mulaku, *vep. cit.*, f. 50.

t shtremtit, t nrejt, t nreçtit, t hãntit, t nxhyemit, t krymtit, t prishtit, t pjektit, t kalbtit, t tharptit, t xhelptit, t pjektit, d djegtit, t nxitit, t ftoftit, t ardhnit, t shkuemit, t shtruemit, t gjãnit, t ñu:shtit, t gatit, t largtit, d blemnit dhe d blemt, t lemit, t lamit, t fshimit, d bãjt, etj.

Për të dëshmuar që vërtet mbiemrat e emëruar përdoren në të folmen që po e studiojmë, po sjellim edhe këta shembuj në kontekst: Zullumi kputet pej *s shtrashit*; pëni kputet pej *s hollit*; bima thahet pej *s thatit*.

Mbiemrat e emëruar të tipit: **t kuqt** (e voes), **d zi:t** (e thonit), **d ba:rdht** (e voes), **d ba:rdh** d zhi:vs), të cilët përdoren në të folmen e Petreshticës, duhet të themi që nuk janë veçori vetëm e saj e as e një grupi të folmesh të akcilit dialekt, po janë të zakonshëm për mbarë gjuhën shqipe.

Emrat e tjerë të mirëfilltë asnjans, që emërtojnë kryesisht lëndë, siç i përmendëm më parë: **drith, tlyen, miell, brumë, grunë, mish, mjaltë, djathë, ballë, bark, dyllë, djalë** etj., në këtë të folme dhe në të folmet e tjera të gegërishtes veriore⁵⁰, shumica kanë kaluar në gjininë mashkullore: **drithi, tly:ni, mielli, brumi, gruni** (në trajtën e pashquar **grũn**), **mishi, djathi, balli, barku, dylli, djali** kurse emri **mjaltë** përdoret në gjininë femërore: **mjalta**.

Një veçori tjetër që vlen të theksojmë sa i përket gjinisë së emrave në të folmen e Petreshticës si dhe në të folmet e arealit të gegërishtes është ndërrimi i gjinisë së disa emrave nga njëjësi i tyre në shumës. Të tillë janë grupi i emrave mashkulorë (në njëjës) **mal-i, livadh-i, katun-i, vorr-i, faj-i, gabim-i, temel-i (<themeli)** e ndonjë tjetër, të cilët në numrin shumës marrin mbaresën –e dhe kalojnë në gjininë femërore: **male, livadhe, katune, vorre, faje, gabime, teme**le. Për përkatësinë femërore të gjinisë së tyre gramatikore në shumës dëshmojnë përcaktorët: **kto male t nalta, kto livadhe, ky katun** është i joni (dhe i yni), po **ato katune** nuk jan

⁵⁰ Shih për këtë dhe Dr. Idriz Ajeti, *Zhvillimi historik i së folmes geqe të Arbëneshëve të Zarës*, te vepra e tij “Studime gjuhësore në fushë të shqipes, II, Prishtinë, 1985, f. 93; L. Mulaku, *E folmja e Shalës së Bajgorës*, Prishtinë, 2005, f. 92

tonat, **kto vorre janë t moçme, gabime t mdhaja, kto teme le jân t forta**, etj.

Në analogji me këta emra që nga numri njëjës kalojnë në shumës në gjininë tjetër janë krijuar më vonë në shqipen dhe shumë emra të tjerë. Që të mos e ngarkojmë studimin tonë me të gjithë emrat e tillë, po i përmendim vetëm këta: **shkrim-i : shkrime, hartim-i : hartime, punim-i : punime, studim-i : studime, përkushtim-i : përkushtime, shqetësim-i: shqetësime, kujtim-i: kujtime, mësim-i : mësim, etj.**

Shënim. – Në të folmen e Petreshticës dallohet emri i gjinisë femërore **mushk/è, ~ja**, nga mashkullori **mëshk-u: kam në mëshk e në mushkè; erdhën mushku e mushkja!**

Shënim 1. – Me emrin **këshk-i** quhet i vogli i buallicës, kurse me emrin **ki:gz-a** quhet e vogla e buallicës. Në të folmet e tjera të Kosovës, në bazë të studimeve dialektologjike, dëshmohet që kemi këto dallime gjinie të kësaj kafshe **këshk-u** ose **kishk-i** “mashkulli” dhe **kishki:-ja** “femra”.

Emrat personalë të burimit oriental, të gjinisë mashkullore natyrore, si **Bedrī, Bahrī, Fehmī, Kadrī** etj., siç po shihet mbarojnë me **ī** të shkurtër, kurse emrat adekuatë të gjinisë femërore natyrore: **Nuri:, Bedri:, Bahri:, Fehmi:, Kadri:** sosin me zanore të gjatë. Ndërkaq, gjatë përdorimit të tyre nëpër rase nuk dallohen qartë emrat femërorë prej atyre mashkullorë: e pa:sh **Bedrijen, Bahrijen, Fehmijen, Kadrijen, Alijen;** erdha prej **Bedrijes, Bahrijes, Fehmijes, Kadrijes, Alijes.**

Në rasën thirrore këta emra dallohen qartë në gjinitë e tyre gramatikore: **O Bedrī!** por **Oj Bedrije! O Kadrī!** por **Oj Kadrije! O Alī!,** por **Oj Alije!,** etj.

Këta emra në të dy gjinitë në të folmen e Shalës së Bajgorës, të fshatrave të rrethinave të Vuçiternës, të Llapit e të Gollakut kur përdoren nëpër rase nuk kanë dallime, por përdoren njësoj: **i Bedrisë, Fehmisë, Kadrisë, Shukrisë;** e pa:sh **Bedrinë, Bahrinë, Kadrinë, Shukrinë.** M tha diçka **Bedria, Bahria, Fehmia,**

Shukria etj. qoftë person i gjinisë mashkullore, qoftë i gjinisë femërore. Në këto të folme emrat e tillë edhe në rasën thirrore përdoren në gjini të ndryshme vetëm duke e shkurtuar zanoren fundore në gjininë mashkullore, kurse duke e zgjatur në atë femërore: **O Kadri! Oj Kadri:!** **O Bedri! Oj Bedri:!** **O Fahri! Oj Fahri:!** etj.

Shquarsia

71. Vënia e një emri të pashquar përballë emrit përkatës të shquar na mundëson që të dallojmë ata jo vetëm formalisht, po edhe kuptimisht. Emrat në trajtën e pashquar dallohen prej atyre që përdoren në trajtën e shquar si me anën e mbaresave morfologjike, ashtu edhe nëpërmjet funksioneve sintaksore të tyre⁵¹.

Emrat e gjinisë mashkullore, të cilët në trajtën e pashquar mbarojnë në bashkëtingëlloret **g, k**, si: **zög, brëg, lüg, pllüg, bürg, shtög; pläk, gjäk, oxhäk, pëshk, läk, brïsk, mïk, bärk, häk** në trajtën e shquar marrin mbarsën **-i: zogi, bregi, lugi, pllugi, burgi, shtogi; plaki, gjaki, axhaki peshki, laki, briski, miki, barki, haki**. Emrat e këtij grupi edhe gjatë lakimit nëpër rasi marrin këto mbarsa rasiore: **-it** në rasi gjinore-dhanore dhe rrjedhore **zog-it**, kah erdha i ra:sh **lug-it**; dhe **-in** në rasën kallëzore: **zog-in**, e trëma **zog-in**; e kapërceva **lug-in**; i fola **plak-it**; e nerova **plakin**; e pa:sh **mikin**; u lshue **pej burgit**; ja ka vnue **lakin** në fyt; ja dha:sh **hakin** etj. Me këtë tipar të këtyre emrave, E folmja e Petreshticës largohet nga E folmja e Shalës së Bajgorës⁵², nga të folmet e fshatrat të rrethinave të Vuçitërnës që shtrihen në anën e djathtë të lumit Sitnicë, pastaj nga të folmet e Llapit e të Gollakut, ndërsa afrohet me të folmet e Rrafshit të Dukagjinit, të

⁵¹ Shih: *Fonetika dhe Gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe II*, Tiranë, 1976, f. 90; L. Mulaku, *vep. cit.*, f. 94.

⁵² Shih L. Mulaku, *vep. cit.*, f. 95; R. Mulaku, *vep. cit.*, f. 48.

Shtimës, të Lipjanit, të Ferizajt, të Kaçanikut, të Karadakut të Gjilanit⁵³, të Kumanovës, të Preshevës e të Bujanovcit⁵⁴.

Shënim. – Në veprat e shkrimtarëve të vjetër shqiptarë emrat me temë në **-k, -g** i hasim rregullisht me mbaresën **-u** në trajtën e shquar: **plak: plaku, mik : miku; anëmik : anëmiku, gjak : gjaku, zog : zogu, lug : lugu, burg : burgu**, kurse emrat që sosin **me h**, edhe atje i gjejmë me **-i: plehi, krahi**.

Emrat mashkullorë që në trajtën e pashquar sosin me bashkëtingëlloren **-h**, si: **pleh, teh, krah, ah**, si dhe disa emra personalë me prejardhje turke-arabe: **Sedullah, Sallah, Nebih, Salih, Fetah** etj. në këtë të folme si dhe në të gjithë gegërishten veriore pa përjashtim marrin mbaresën **-i: plehi, tehi, krahi, ahi, Sedullahi, Sallahi, Nebihi, Salih, Fetahi**.

Është interesant të vihet në pah trajta e shquar e emrave të gjinisë mashkullore, të cilët në trajtën e pashquar mbarojnë me zanore të gjatë, si: **ka: vlla:, shka:, shi:, thi:, dhe:** etj., e cila përkon më shumë me të folmen e Karadakut të Gjilanit⁵⁵: **kavi, vllavi, shkavi, shivi, thive, dhevi**, mirëpo nga po ai subjekt që i përdor këto trajta, përdor dhe trajtat: **dheu, shiu, thiu, shkau**, si duket nën ndikimin e gjuhës letrare.

Shënim. – Po theksoj që edhe në fshatin Banullë të Lipjanit përdoren trajtat e shquara: **kavi, dhevi, shkavi**. Më mbetet, prandaj, detyrë që në të ardhmen e afërt të shoh shtrirjen e këtij fenomeni morfologjik në fshatrat e tjera të Lipjanit, të Shtimes, të Ferizajt, të Kaçanikut dhe të vërtetoj nëse përdoren edhe atje të dyja trajtat apo vetëm njëra.

⁵³ Shih: Me Halimi, *vep. cit.*, f. 232 dhe literaturën e cituar aty.

⁵⁴ Shih: I Ajeti, *Rreth disa veçorive të të folmeve të shqiptarëve të rrethit të Preshevës dhe të Bujanovcit*, te “Studime gjuhësore I” (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 71.

⁵⁵ Shih: M. Halimi, *vep. cit.*, f. 232.

Grupi i emrave mashkullorë të fondit autokton të shqipes: **njeri:, veri:, qiri:** sikurse në të folmet e Kosovës përgjithësisht, edhe në të folmen e këtij fshati përdoren vetëm në trajtën e pashquar: **níeri, véri, qíri:** po vjen **nǐ níeri,** dheza **nǐ çíri;** po frÿn **véri.** Po theksojmë që shkrimtarët e vjetër (sidomos Buzuku në “Mesharin” e tij (1555) i kanë dalluar mirë trajtat e pashquara dhe të shquarat: **nierii-u, qirii-u,** etj.

Ndoshta nuk është e tepërt të përmendim me këtë rast edhe një dorë emrash të gjinisë mashkullore që në trajtën e pashquar mbarojnë me zanore të gjatë, si: **sy:, hu:, dru:, frë:, pë:, hî:, fî:,** të cilët në trajtën e shquar të tyre dalin me **–ni: syni, huni, druni, frëni, pëni, hîni, fîni.** Ky grup emrash përdoret kështu në mbarë të folmet e gegërishtes veriore.

Shënim. – Emri **gji,~në / gji,~ri** në të folmen e Petreshticës në trajtën e shquar përdoret kështu: **xhi,~u:** po i dhëm **xhiu.** Për dallim nga kjo e folme, në shumicën dërrmuese të të folmeve të gjuhës sonë trajtën e shquar të këtij emri e kemi me **–n ose –r,** përkatësisht me **–ni/–ri: gjíni/gjíri.**

Emrat **de:t, gu:r, ka:l, ba:r, ýll, hÿt, ku:t,** etj., në të folmen e Petreshticës sikurse në shumicën e të folmeve të Kosovës nuk përdoren fare në trajtën e pashquar, në të cilën i shënuam më sipër, por vetëm në të shquarën: **déti :** edhe do dít, e po shkoj **n déti; gúri :** u tuta pej çenit dhe e kapa **nǐ gúri** për me trëm; **káli :** hipa **n káli; bári :** e mora do **bári** me ja çit kalit; **nǐ ýlli, nǐ húti, nǐ kúti** i ga:t, etj. Edhe për sa u përket këtyre emrave duhet të theksoj që shkrimtarët e vjetër shqiptarë i kanë dalluar mirë trajtat e tyre të pashquara nga trajtat e shquara.

Një grup emrash të gjinisë mashkullore, të cilët në trajtën e pashquar sosin me togzanorin **–ue,** si, p.sh.: **krue, thue, prrue, ftue,** në trajtën e shquar, duke e mbledhur togzanorin **–ue** në **o** nxjerrin dhe **n–në** e vjetër të tyre dhe dalin kështu: **kroni, thoni, prroni, ftoni** etj. Në analogji⁵⁶ me këtë grup emrash kemi dhe : **laque – laqoni, patkua – patkoni, nye – neni,** e ndonjë tjetër.

⁵⁶ Për analogjinë e këtyre emrave, shih: L. Mulaku, *vep. cit.*, f. 94.

Shumësi i emrave

72. Sa i përket shumësit të emrave e folmja jonë nuk paraqet dallime të veçanta nga të folmet e tjera të gegërishtes veriore. Megjithatë, po të vështrohet hollësisht mund të hetohen ndryshime të vogla të cilat, aq sa janë, do të përpiqemi t'i vëmë në pah.

Shumësin me prapashtesën –e e formojnë disa emra abstraktë mashkullorë, si: **gabim-e, pushim-e, menim-e, llaf-llafe, fis-e, idhnim-e, gxim-e,** etj.

Me prapashtesën –e e formojnë shumësin edhe disa emra konkretë mashkullorë, si: **katun-e, shtet-e, vën-e (dhe vën-a) temel-e, mal-e, livadh-e, oborr-e, vorr-e,** etj.

Disa emra mashkullorë, tema e të cilëve sos në bashkëtingëlloret –k, -g, -l, -ll, sikurse në të folmet e tjera të gjuhës shqipe, shumësin e bëjnë me palatalizimin e këtyre bashkëtingëlloreve fundore, si: **mik- miç, uk – uq, pllug – plluxh, zog – zoxh dhe zoj, peshk – peshçi, kuçull – kuçuj,** etj.

Disa emra e bëjnë shumësin me palatalizimin e bashkëtingëlloreve **k, g** dhe marrin një zanore fundore, si p.sh., : **lug - luxhe, breg – brexhe, xhak – xhaçe, shtek – shteçe, brisk – brisçi, axhak – axhaçe,** etj.

Një numër i madh emrash mashkullorë në këtë të folme e formon shumësin me prapashtesën –a, e cila është karakteristike për të gjitha të folmet e gegërishtes: **hut-a, msu:s-a (dhe msojsa), t-hallu:s- t-hallus-a, thelb-a, plis-a, xhep-a, rryp-a, brryl-a, krryl-a, grryes-a, pllum-a, xhygym-a, nip-a, traktor-a, maçorr-a, matorr-a, shofer-a, nxãns-a, tavan-a, tupan-a, hajvan-a, raft-a, dollap-a, fene:r-a, ballist-a, grep-a, kaçep-a, çyp-a, krahën-a, plep-a, lis-a, kapetan-a, komandant-a, grusht-a, çoban-a** e shumë të tjerë me të cilët nuk duam ta ngarkojmë këtë studim.

Shënim. – Emri **knues** > **knu:s**, shumësin e bën me formën **knojs**. Emri **ka.llī** (i

grurit) e formon shumësin në trajtën **kajzi**.

Disa emra mashkullorë e formojnë shumësin me metafonizim dhe me palatalizim: **tarak- tereç, varg – verxh, prag – prexh, plak- pleç**, etj.

Shumësi i emrave me metafonizim, që është i mbarë shqipes, ka përfshirë një numër të vogël emrash mashkullorë, si: **dja:l – djel** (dhe **djem**), **dash –desh**, **mzat- mzet, kunat- kunet, sjap- sjep**⁵⁷. Në analogji me mashkullorët kemi dhe emrat e gjinisë femërore **na:t** dhe **â:n**, të cilët shumësin, gjithashtu, e bëjnë me metafoini: **net, ã:n**.

Disa emra mashkullorë, që sosin me zanore të gjatë hundore, si **pë:, frë:, drū: , hū:, gū:** shumësin e bëjnë me **-j: pëj, frëj, druj, huj, guj**. Sa kam mundur ta dalloj me veshë, në trajtat e shumësit të emrave: **druj, huj, guj**, zanorja **u** denazalizohet.

Shënim. - Emri **tra:**, i cili gjithashtu mbaron me zanore të gjatë, në shumës pëson metafoini dhe merr dhe prapashtesën e shumësit **-j: trej**.

Një grup emrash mashkullorë, të cilët kanë në temën e tyre togzanorin **-ue**, si : **kapru:ll, tru:ll** shumësin e bëjnë duke e mbledhur togzanorin **-ue** (që e kanë pasur dikur) në **o** dhe duke e palatalizuar **ll**-në në **j: kaproj, troje**.

Shënim . – Emri **buall >bu:ll** në trajtën e shumësit togzanorin **-ue** e thjeshton në **-u** dhe merr prapashtesën **-j: bu:j**. Po kështu emrat **kru:** (<kruë), **thu:** (<thue), **draņu:** (<drangue), **kapru:ll** (<kapruell) dalin në shumës duke e mbledhur togzanorin **ue** që e kanë pasur dikur dhe duke marrë prapashtesën **-j: kroj, thoj, draņoj, kaproj**. Me **-j** e formon shumësin emri **drapën – drapnoj**, kurse emri **xharpën** në shumës del me **-ĩ: xharpnĩ**.

Shënim 1. - Emri **duej** del edhe në shumës me të njëjtën trajtë: **duej**, sikurse në shumicën e të folmeve të gjuhës shqipe.

Një grup emrash mashkullorë shumësin e bëjnë me **-ie: zjarm – zjarmie, elb –**

⁵⁷ Këtë emër me këtë trajtë e gjejmë edhe te Buzuku (shih: Prof.dr. Kolë Ashta, *Leksiku historik i gjuhës shqipe I*, f. 440, ndërkaq në shumë të folme të tjera të Kosovës përdoret trajta **cap: cjep** : po shkon **capi** te kasapi.

elbie, shpat- shpatie, grūn – grunie, grazhd- grazhdie.

Shënim 2. – Emri **ka-u**, në këtë të folme **kavi**, shumësin e bën duke e thjeshtuar togzanorin **ie** në **i** të gjatë: kam **dÿ ki:**, po vi:n **ki:t**; i lidha **ki:t** etj. Ndërkaq emri **sy-ni** në këtë të folme në numrin shumës del me **y** të shkurtër: **sÿt**: po m dhāmin **sÿt**.

Disa emra numrin shumës e bëjnë me **-ën**: **mret – mretën, vlla:- vllazën, dreç- dreçën, prift – piftën.**

Shënim 3. – Emri **kulaç** e bën shumësin vetëm me metafoji: **kulaç –kuleç.**

Shumësi i emrave femërorë

Shumësi i emrave femërorë është më i thjeshtë dhe nuk ka shumë mënyra të fomimit siç kanë mashkullorët. Emrat e gjinisë femërore meqenëse shumica dërrmuese e tyre përgjithësisht në gjuhën shqipe e formojnë shumësin me prapashtesën **-a**, edhe në këtë të folme e formojnë në atë mënyrë, si: **mo:ll – molla, da:rdh – dardha, pu:l – pula, fu:sh-a**, pastaj **fēmën - fēmna, motër – motra, kodër – kodra, sofër – sofra, thupër – thupra**, etj.

Shënim. – Emrat **di:t** dhe **lo:p** shumësin e bëjnë duke e shkurtuar zanoren e temës: **dÿt**, përkatësisht **löp**.

Emrat **petull, vetull, ndrikull, hatull, shpatull, sjetull** etj., që në këtë të folme zanorja e patheksuar **u** dëgjohet më shumë si **ë**: **petëll, vetëll, sjetëll**, pra në analogji me **mjekërr** etj., shumësin e formojnë me prapashtesën **-a**, duke e humbur krejtësisht zanoren e patheksuar të temës: **petlla, vetlla, nriklla, hatlla, shpatlla, sjetlla**, etj.

Emrat **qersh**i (në këtë të folme **çurrshi**), **lejthi:**, **shpi:**, **tepsi:**, **kusi:**, etj. shumësin e formojnë me prapashtesën **-a** dhe me **j** bukurtingëlluese: **çurrshija, lejthija, shpija, tepsia, kusija.**

Shënim. – Emri **lule** në këtë të folme dhe përgjithësisht në gegërishten verilindore përdoret në trajtën **lu:l**, shumësin e bën me prapashtesën **-a**: **lula**: Kam **nÿ lu:l**, por kam shumë **lula**.

Lakimi

73. Një numër emrash gjatë përdorimit nëpër rasi në të folmen e Petreshticës paraqesin dallime të dukshme prej të folmeve të tjera të Kosovës, si të pjesës më të madhe të Drenicës, të Shalës së Bajgorës, të rrethinave të Vuçitërnës, të Llapit, të Gollakut. Të tillë janë emrat **ka, shka, dhe, thi, va-u**, si dhe emrat vetjakë me burim oriental, si **Bedri, Ali, Kadri** etj., për të cilët do të shohim në vijim të shtjellimit të tyre nëpër rasi.

Emrat **mend, dhentë, qentë** në rasën emërore të shquar shumë e bjerrin **n-në: mē:t, dhē:t, çē:t**.

Emrat në rasat gjinore-dhanore. - Në këto dy rasi emrat në shumësin e pashquar herë-herë e ruajnë **n-në: dhën, mën, çën** dhe dalin në trajtat: (i,e) **dhëne, çene**, po herë-herë e humbin: **dhē:, çē:; çëve** (më e shpeshtë) **çēne** (më e rrallë): a u çite me hãnjër **çëve? U tut pej çëve! E kan lã:n mē:t, runa zo mē:t!** Përdoret dhe trajta rasore e shkurtuar e këtij emri kur ky shoqërohet me njëjën e pashquar **do: M u kan tu:rr do çē; kuale: grahu kuale!** Dëgjohen dhe format rasore: **tãmël dhive, tãmël dhëne, lësh dhëne, xhe:ll çëve, zoxhve (dhe zojve), miçve, vllaznive, pleqve** etj; po: ju çova bũk **çobane**.

Në numrin njëjës emrat që sosin në bashkëtingëlloret **k, g, h** në këto rasi përdoren kështu: (i, e) **mikit, gjakit, zogit, bujit, lugit, pllugit, tehit, krahit** etj.

Edhe **rrjedhorja** e këtyre emrave del me këtë trajtë: **pej dhëne, çene, kuale**. Ndonjëherë dëgjohen dhe trajtat rasore në togfjalësh: **mish viçi, mish kinxhi, mish lope, mish pule**, të cilat kanë kuptimin *mish i viçit* po edhe *mish prej viçit*;

mish i pulës, po edhe *mish prej pulës*; *u:j kroni*, *u:j bunari*: *ujë i kronit* po edhe *ujë prej kronit*.

Rasa kallëzore: dhë:t, çë:t, kualt. Trajtat e njëjësit të këtyre emrave nuk po i shënojmë , sepse nuk paraqesin dallime prej të folmeve të tjera të gegërishtes verilindore.

Emrat e mësipërm të numrit njëjës, tema e të cilëve mbaron në **k, g, h**, në kallëzore dalin me trajtat: **mikin, gjakin, zogin, bujin, lugin, pllugin, tehin, krahin.**

Emrat që dalin me temë në zanore të gjatë, si **ka:, vlla:, shka:, dhe:, thi:, shi:, va:**, në këtë rasë kanë trajtat: **kavin, vllavin, shkavin, dhevin, thivin, shivin, vavin.** Mund të dëgjohen dhe trajtat: **kaun, vllaun, shkaun, dheun, thiun shiu,** po më rrallë, të cilat si duket kanë hyrë nëpërmjet gjuhës standarde. Po kështu mbiemri i substantivuar **i ziu**, në këtë të folme **i zivi**, del në këtë formë, pra e lidha **të zivin (kavin)**, e jo të bardhin. Në këtë pikë dialektore kjo e folme përkon me të fomet e fshatrave të tjera të Shtimes, të Lipjanit dhe të Karadakut të Gjilanit⁵⁸.

Paradigmat e lakimit të disa emrave

E pashq.		E shquar		E pashq.		E shquar	
Numri njëjës				Numri shumës			
E.	mik	miki		miç	miçt		
Gj. (i, e)	miki	mikit		miçve	miçve		
Dh.	miki	mikit		miçve	miçve		
K.	mik	mikin		miç	miçt		
Rrj.	miki	mikit		miçve	miçve		

⁵⁸ M. Halimi, *vep. cit.*, f. 244.

zog	zogi	zøj	zajt
zogi	zogit	zøjve	zajtve
zogi	zogit	zøjve	zajtve
zog	zogin	zøj	zajt
zogi	zogit	zøjve	zajtve

krah	krahi	krih	kriht
krahi	krahit	krihve	krihve
krahi	krahit	krihve	krihve
krah	krahin	krih	kriht
krahi	krahit	krihve	krihve

ka:	kavi	ki	ki:t
kavi	kavit	kive	kive
kavi	kavit	kive	kive
kavi	kavin	ki:t	ki:t
kavi	kavit	kive	kive

va: ⁵⁹	vavi
vavi	vavit
vavi	vavit
vavi	vavin
vavi	vavit

sy:	syni	sÿ	sÿt
syni	synit	sÿve	sÿve

⁵⁹ **Va,u** m. Vend i cekët në lumë, ku mund të kalohet më lehtë.

syni	synit	sÿve	sÿve
sy:	synin	sÿt	sÿt
syni	synit	sÿve	sÿve

kru:	kroni	kroj	krojt
kroni	kronit	krojve	krojve
kroni	kronit	krojve	krojve
kru:	kronin	kroj	krojt
kroni	kronit	krojve	krojve

bu:ll	bulli	bu:j	bu:jt
bu:lli	bullit	bujve	bujve
bu:lli	bullit	bujve	bujve
bu:ll	bullin	bu:j	bu:jt
bulli	bullit	bujve	bujve

lo:p	lopa	löp	löpt
lope	lopës	löpve	löpve
lope	lopës	löpve	löpve
lo:p	lopën	löp	löpt
lope	lopës	löpve	löpve

Alija⁶⁰	Fehmija	Fahrija	Bedrija
---------------------------	----------------	----------------	----------------

⁶⁰ Në këtë të folme dhe në të folmen e fshatrave të Shtimes e të Lipjanit vetëm rása emërore e pashquar dhe rása thirrrore dallohen në gjini: *Alÿ , Alije, Fehmÿ, Fehmije, Fahrÿ, Fahrije , Kadrÿ, Kadrije*, dhe *o Alÿ, oj Alije, o Fehmÿ, oj Fehmije, o Kadrÿ, oj Kadrije*. Për ndryshe emrat vetiakë me burim oriental në trajtën e

Alijes	Fehmijes	Fahrijes	Bedrijes
Alijes	Fehmijes	Fahrijes	Bedrijes
Alijen	Fehmijen	Fahrijen	Bedrijen
Alijes	Fehmijes	Fahrijes	Bedrijes

Për sa u përket emrave të gjinisë femërore meritojnë të vihen në pah disa sish të përgjithshëm që sosin në zanoren **-i** të gjatë: **shpi:**, (<shtëpi), **liri:**, **raki:**, **kuti:**, pastaj emrat e shteteve: **Gjermani:**, **Turki:**, **Shypni:** **Suedi:**, **Austri:**, etj., të cilët në rasat gjinore, dhanore, kallëzore e në rasën rrjedhore marrin mbaresën **-je**: i(e) shpijes : buk: **e shpijes**; e marova **shpijen**, dola pej **shpijes**; Ministria e **Shëndetsijes**; mysafirrit ja çiti **kutijen** e duhānit përparash; u ktheva **pej Gjermanijes, Shypnijes, Austrijes, Suedijes**, etj. Një dukuri e tillë morfologjike nuk është e përhapur në pjesën më të madhe të Drenicës, as në të folmen e fshatrave të Vuçitërnës, të Shalës së Bajgorës, të Llapit e as të Gollakut.

Shënim. - Trajtat rasore me **-je** të këtyre emrave dëgjohen dhe në të folmen e Malishevës dhe të fshatrave të saj.

Nyjat e përparme

74. Siç dihet emrat janë të pajisur me dy palë nyjash: me nyja të përparme dhe me nyja të prapme. Në ligjërimin e ngadalshëm të folësve të këtij fshati mund të dëgjohen se përdoren të dy palë nyjat. Kjo më së miri shihet kur flasin për mikrotoponimet togfjalëshore, si: **Bregi i Na:lt**, **Lugi i Madh**, **Kroni i Ftoft**, etj. mirëpo gjatë ligjërimimit ekspresiv mund të mos dëgjohet nyja e përparme e

shquar të tyre, qofshin femërorë, qofshin mashkullorë kanë paradigmen e lakimit sipas pasqyrës së mësimërme.

Emrat e këtillë në të folmen e pjesës më të madhe të Drenicës, të Shalës së Bajgorës, të rrethinave të Vuçitërnës, të Llapit, të Gollakut etj. në rasën gjin-dhan. e rrjedh. dalin me trajtën: (i,e) *Fahri:s, Kadri:s, Bedri:s, Shefki:s;* kall. *Fahri:n, Kari:n, Bedri:n, Shefki:n.*

gjymtyrës së dytë përcaktuese, si: **Bregi Na:lt, Lugi Madh, Kroni Ftoft; miki shpi:s, zogi malit, zogi thivit, i biri çenit**, ish ardh **miki Hasanit!**.

Në togje fjalësh –emër – mbiemër, sidomos kur janë në kontakt nyja e prapme –i e emrit me nyjën e përparme –i të mbiemrit, nyja e mbiemrit nuk dëgjohe të shqiptuari, si: **djali madh, te Guri Madh, te Kodra Madhe, zogi vogël, plaki smu:t, kavi larëm, mzati Hasanit** etj. Në analogji me këta, nuk përdoret as nyja e përparme –e e mbiemrit: **dera madhe, nusja madhe, dora djatht, koha mi:r, koha keçe, gruja jeme; gruja vllavit, udha ma:r!, dera vogël, (hipa) maje mali**, etj.

Emrat e farefisnisë që përdoren për të emërtuar të birin, të bijën, të vëllain, të kunatën, të vjehrrin në raport me të tjerët të afërm përgjithësisht, me ndonjë përjashtim të rrallë, nuk marrin nyjën e përparme, por dalin kështu: **bija, vllavi, motra, biri, vjehrra, vjehrrri, kunata, re:ja, nipi, mesa** etj. Siç thashë, në disa raste, varësisht nga konteksti i bisedës së ligjëruesve të këtij fshati mund të dëgjohe dhe me nyjën e përparme ndonjëri nga këta emra farefisnorë, si: **e bija, i biri**; shkojshin krah për krah **e ãma me d bijen**; ajo gru: është **e ve:j**, etj.

Emrat që përdoren për të treguar se cilit fshat i përkasin banorët përkatës dëgjohe në trajtat: **i carralevsi, i petershticsi, i vërshevcsi, i belinci, i zborcsi, i sedllarcsi**, etj.

Nyjat e prapme

Në të folmen e Petreshticës nyja e prapme ose mbaresa **-u** e rasës emërore të emrave mashkullorë që përfundojnë në temë me bashkëtingëlloret **k, g, h** është shndërruar në **-i**: **plaki, zogi, miki, pllugi, zhegi, lugi, bregi, shteki, briski, laki, haki** etj. Po ashtu edhe mbaresa e prapme **-u** e emrave mashkullorë që sosin në temë me zanore të gjatë, si: **ka:, shka:, dhe:, vlla:, va:, shi:, thi:** ka kaluar në **-i**,

duke marrë ndërmjet temës dhe kësaj mbareseje një –v- bukurtingëlluese: **kavi, shkavi, dhevi, vllavi, vavi, shivi, thive.**

Shënim. – Një -v- antihiatizuese midis dy zanoreve merr në këtë të folme edhe emri **hua:**, >**hūva:** lypja do mi:ll **hūva:**; lypja do **pārë hūva:** Alijes.

Po shtoj që emrat që sosin në temë me **h**, sikurse në mbarë gegërishten edhe në këtë të folme ka herë përdoren me nyjën e prame **-i:** **kráhi, pléhi, téhi, áhi** etj. Emrat e tjerë, qofshin mashkullorë, femërorë ose të gjinisë asnjësore për sa i përket nyjës së prapme nuk kanë si të bëjnë përjashtim në këtë të folme nga të folmet e tjera të gjuhës shqipe, si: **lisi, pēni, mali, lopa, dora, dera, kryet** etj. Edhe emrat e tjerë të dikurshëm të gjinisë asnjësore, si **drithëtë, brumëtë, vojtë, djathtë, grunëtë, miellëtë, ujëtë** etj., sot në këtë të folme marrin nyjën e prapme të gjinisë mashkullore **-i:** **tlyni, drithi, brumi, voji, djathi, gruni, milli, uji.**

Nyjat **joshquese një** dhe **disa/ ca** në të folmen që po e shqyrtoj përdoren në trajtat **nǐ** për njëjësorin e emrave të përgjithshëm dhe dō për numrin shumës, si: po thurret **nǐ nieri** te dy:rt; na ka le: **nǐ dja:l**; e kam **nǐ mal** t mier; i kǐsh **dō lōp** çu kush s i kǐsh!; shko bjeri **dō dru:** ta dhezim zjármin; ama **do u:j!** etj.

MBIEMRI

75. Për sa u përket mbiemrave në përgjithësi ata nuk kanë ndonjë dallim të veçantë nga shumica e të folmeve të gegërishtes verilindore. Në të folmen e Petreshticës

dallohen mbiemrat e numrit njëjës prej atyre të numrit shumës: **i vogël - d voxhël : djali vogël – djel / djem d vogjël ; e madhe - t mdha: ; çik e madhe – çika t mdha: ; dja:li madh – djem t mdhaj; kali vogël - kuaj t mdhaj, etj.**

Për nga formimi dallojmë:

a) mbiemrat e parmë: **plak, trim, i ga:t, i madh, i ri:, i vogël, i gja:ll, i ho:ll, i tra:sh;**

b) mbiemra të prejardhur me parashtesa e me prapashtesa: **i përgjakt, i përloçt, përvluet dhe i përvluem; i përvjelt, i nërkyem, i përxhdredht, i poshtër, i epër, i na:lt, i fe:ll, i nre:jt, i shtre:m, i dredht, etj.;**

c) mbiemra me prapashtesën –an: **shkodran, shaljan, thaçjan çyrran⁶¹, shtraman, dredhan, shurdhan, belban, çyçan;**

ç) me prapashtesën –shëm: **i lyeshëm, i pishëm, i hershëm, i vonshëm, e rrejshme /dyja: e rrejshme/, i kthyeshëm, i ngueshëm, i nershëm, i njëshëm, etj.;**

d) me prapashtesën –t(ë): **i lësht, i pamukt, i mnasht, i drujt, i zhgujt, i bezt, i barabart, i largt, i ɲa:t, i lăgt, i tërt, i tha:t, e dūgt “dardha dugta”; i kălbt, i prīsht, i hāgt, i vōkt, i ftōft, i shtrēmt, i nxe:t, i kulluet, i pjëkt (dhe i piçt), i rrūdht, etj.**

dh) mbiemra prejëmërorë me prapashtesën turke –xhi: **belaxhi, zhurmaxhi, kallajxhi, çerepxhi, furrxhi, kalemxhi, duhanxhi, bashçexhi, dardhaxhi etj.**

Disa mbiemra prejfoljorë e ndërrojnë gjininë në këtë të folme vetëm me nyjën e përparme i për gjininë mashkullore, e për femëroren, si: **i tert – e tert, i lagt – e lagt, i dixht – e dixht, i rrudht – e rrudht, i dekt – e dekt, i tha:t, e tha:t, i prisht – e prisht, i kalpt – e kalpt, i shtremt – e shtremt , i nrejt – e nrejt, etj.**

Disa mbiemra prejfoljorë e dallojnë gjininë e tyre përveç me nyjën e përparme i për gjininë mashkullore, e për atë femëroren, edhe me mbaresën –e që marrin në gjininë femërore, si: **i la:m (edhe i la:n) – e la:me /e lane; i terun – e terne; i**

⁶¹ Te kjo fjalë kemi kthimin e zanores **u: qurr,-i**, dhe **qurran,-i** në vokalin **y: çyrr,-i dhe çyrran-i**.

kullu:m – e kullumne/e kullune; i lidhun – e lidhne, i dekun – e dekne, i falun – e falne, i pjekun – e pjekne; i djegun – e djegne, i ble:m – e bleme; i fshi:m – e fshime, i thy:m (dhe i thy:n) – e thyme/e thyne, i ly:m (dhe i ly:n) – e lyme/e lyne, i çiru:m (dhe i çiru:n) – e çirume/e çirune, i da:m – e dame, i sha:m – e shame, i vra:m- e vrame; i lanun – e lanne, i kanun – e kanne, i dhanun – e dhanne etj. Shembujt e mësipërm të mbiemrave, si: e **lame - e lane, e lyme – e lyne** dëshmojnë në këtë të folme na dalin në dy trajta : me **–m** dhe me **–n**. Qe një shembull në kontekst, ashtu si na e ka dhënë subjekti në ligjërimin tij të lirë: n Rusinofc e kam në çik **t martune**.

Shënim. – Disa shembuj që ka sjellë N Pajaziti për të folmen e Anadrinit, gjoja karakterit për dallimin e gjinisë së mbiemrave, ku ndër të tjera thekson : “Disa mbiemra, për të formuar gjininë femërore, përpos që e ndryshojnë nyjën e përparme nga **i** në **e**, marrin edhe mbaresën e në fund, p.sh.: **i madh – e madhe, i keç – e keçe, i kuç – e kuçe**” mendoj unë që janë të panevojshëm, sepse ashtu përdoren (dhe dallohen) në mbarë gjuhën shqipe, pra në të dyja dialektet e gjuhës sonë.

NUMËRORËT

Numërorët themelorë

76. Karakteristikë e numërorëve themelorë në të folmen e Petreshticës, po edhe e të folmeve të tjera të gegërishtes, është dallimi i gjinive të disa prej tyre. Kështu numërori themelor me kuptimin e **1**-shit kur përdoret para emrit **nǐ** bu:rr, **nǐ** djál, **nǐ** mo:ll, **nǐ** ç:i:k, **i**-ja e tij është e shkurtër. Në raste të tilla mendoj që fjala është për njëjën e përparme të pashquar të emrave. Mirëpo, kur numërohet nga njëshi e tutje thuhet: **nǐǎ**, **dǔ** (për gjininë mashkullore); **dy:** (për gjininë femërore), **trë** (gjinia mashkullore) **tri:** (gjinia femërore), **katër** / **katra** etj. Siç po shihet nga numri **nǐ** e deri në numrin **katër** numërohet në dy mënyra:

a) **nǐ**, **dǔ**, **trë**, **katër**, dhe

b) **nǐǎ**, **dy:**, **tri:**, **katra**

Këta katër numërorë themelorë kanë edhe opozicione fonologjike, sepse dallojnë gjininë mashkullore dhe femërore:

dǔ burra - **dy: gra:**

trë burra - **tri: gra:**

burra ishin **katër**, por gra: ishin **katra**.

Një veçori tjetër që vlen të vihet në pah për sa u përket numërorëve themelorë është kjo: në të folmen e Petreshticës dhe të gegërishtes veriore në përdorimin e

tyre nga **nëntë** (në të folmen tonë: **nǎn**) e tutje vërehet reduktimi i konsonanteve dhe i togjeve të bashkëtingëlloreve të tyre, si: **dhe:t, nimdhe:t, dÿmdhe:t, tremdhe:t, katrumdhe:t..., nÿzet, tridhe:t, katërdhe:t, pezdhe:t, xhazhdhe:t, shtadhe:t, tedhe:t, nǎdhe:t, niçin** etj., për: **dhjetë, njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë, trembëdhjetë, katërbëdhjetë..., njëzet, tridhjetë, pesëdhjetë, gjashtëdhjetë, shtatëdhjetë, tetëdhjetë, nandëdhjetë, njëqind**, etj. Vlen të theksohet që autorët e vjetër shqiptarë në veprat e tyre këta numërorë i kanë shënuar në trajtat e plota, ashtu si përdoren sot në gjuhën letrare. Për numërorët në përgjithësi, shih dhe: Fadil Sulejmani, *E folmja e Malësisë së Sharrit të Tetovës*, Prishtinë, 1989 (disertacion i doktoratës); Imri Badallaj, *vep. cit.*, f.147-151; M. Halimi, *vep. cit.*, f. 255-257.

Numërorët rreshtorë

77. Karakteristikë e numërorëve rreshtorë (në mbarë gjuhën shqipe) është dallimi i gjinive të tyre me nyjet e përparme:

a) me nyjet e përparme **i** për gjininë mashkullore: **i pari, i dyti, i tretë, i katërti, i gjashti** etj.;

b) me nyjën e përparme **e** për gjininë femërore të tyre: **e para, e dyta, e treta, e katërta, e gjashta** etj.

Vlen të thuhet që në përdorimin e këtyre numërorëve që nga dhjetë e tutje në të folmen tonë dhe përgjithësisht në të folmet e gegërishtes veriore vërehet reduktimi i bashkëtingëlloreve e i grupeve të tyre, sikurse tek numërorët themelorë, prandaj

nuk e shoh të nevojshme të sjellë shembuj.

PËREMRI

Përemrat vetorë

78. Karakteristikë e përemrit vetor të numri njëjës janë dy trajtat e tij: **un** dhe **une**; **Une** e pa:sh i pari!, dhe **un** e lash çaty, e nuk di ma shka u bā me ta! Në rasat e tjera, si, p. sh. në dhanore e kallëzore ky përemër përdoret kështu: **mu: m** tha kshtu, e ty: nuk di çysh t ka thā:n. Në rasën rrjedhore kemi trajtën **méje**: mus u largo **pej méje!**.

Veta e dytë njëjës **tj** përdoret kështu: emërore **tj**; dhanore **ty: t** dhash me hājër; me të njëjtën trajtë përdoret edhe në kallëzore: **ty: t** pa:sh n oborr, kurse rrjedhorja ka formën e përemrit të vetës së parë : **pej teje**.

Veta e parë shumës e përemrit vetor është **na** në rasën emërore. Kështu e gjejmë edhe te shkrimtarët tanë të vjetër, prandaj mund të themi që forma me metafoini **ne** e disa të folmeve të shqipes dhe e standardit të gjuhës sonë nuk është e vjetër, por përkundrazi - e re.

Në rasën dhanore kemi trajtën **neve na** : **Neve na** i ka pru: t fala nusja; **Neve na** e la bukën për me hãnjër për dre:k!

Në rasën kallëzore kemi: **ne na** : **Ne na** ka pa: kah shko:jm!, **Ne na** ka këy:r nãna boll, etj.

Në rasën rrjedhore ky përemër përdoret në dy trajta: **nesh** dhe **neve**, ndër të cilat mbizotëron **nesh**, si p.sh.: Mos prit xhã **pej nesh** ! Largou **pej nesh**!

Në vetën e dytë shumës kemi përemrin **jũ**, trajta rasore të të cilit nuk dallojnë prej të folmeve të tjera të gegërishtes: emërore: **jũ**; gjinore-dhanore : (i, e) **juve, ju**; kallëzore: **ju** pa:sh **juve**;; rrjedhore: **jush** dhe **juve**.

Përemri vetvetor

79. Kemi ndeshur këto trajta të përemrit vetvetor: **vet** tha!, Aĩ aq i vogël, **vet** shkon n shko:ll, edhe **vet** i bãn detyrat! Shka i bãn aĩ **vehthes** s i bãn kurrkush! ; **Vehten** pe rre: krehes (<kresë)! **Vehten** e muer n çã:f!; Krejt çatã **vehtja** ja ka bã:;!; Shka ta bãn **vehtja** s ta bãn kurrkush! Aĩ u bã: **vet** i niqinti e tash po flet me **vetvehten**!

Përemrat dëftorë

80. Në të folmen e Petreshticës dëftorët përdoren me këto trajta të rasës emërore: **aj** dhe **çaj** < **qe aj**: **aj** djál, **ajo** dhe **çajo** <**qe ajo**; **ajo** nuse, **kÿ** dhe **çekÿ** <**qe ky**; **kÿ** bu:rr; **kjo** dhe **çekjo** < **qe kjo**: **kjõ** mo:ll , **ata** dhe **çata** < **qe ata**: **ata** djem dhe djel; **ato** dhe **çato** < **qe ato**): **ato** çíka; **kta** dhe **çeta** < **qe ata**: **kta** mzët; **kto** dhe **çeto** < **qe ato**: **kto** lõp.

Edhe në rasat e tjera këta përemra nuk paraqesin dallime dialektore në krahasim me të folmet e tjera të gegërishtes verilindore, po përdoren pothuajse njësoj. Kështu në rasën gjinore-dhanore kur folësi e ka fjalën për sendet që gjenden afër tij, ai përdor trajtat përemërore: (i, e) **kti**: , **ktina** , **çeti**:, **çetina**; **kjõ/ çikjõ**; **ksajnaj**, **çesajnaj**; në rasën kallëzore: **ktã**, **çetã**.

Ndërkaq, për sende që ndodhen larg folësit, përdoren përemrat, fjala vjen për rasën:

emërore: **aj**, **çaj** për gjininë mashkullore, dhe **ajo**, **çajo** për gjininë femërore;
gjinore-dhanore: **ati**: /**atina**, **çati**, **çatina** - për gjininë mashkullore; dhe:
asaj/asajna/ çasaj/ çasajna - për gjininë femërore ; **kallëzore**: **atã**, **çatã**;
rrjedhorja: **pej çati**:, **pej çatina**; **pej çasaj**, **pej çasajna**.

Në rasën kallëzore na kanë dalë këto trajta të dëftorëve kur përdoren të shoqëruar me emra: **çetã** burra, **çektã djem** i pruna n shpi; **çekto gra**: i pa:sh përjasht, **kit lis** e preva; e pa:sh **çat djál**.

Në rastet kur përdoren të pashoqëruar me emra përdoren **ktã**, **atã**, **çatã**, **çetã**.

Në rrjedhore përdoren dhe format përemërore: m këna **ksi/ çesi** djathi; **kso/çeso** mollash; ose **aso/çaso** buke ; dáma nÿ co:p **pej çesaj** buke; ose **pej çasaj** buke. Kur folësi dëshiron të shquajë cilësinë e gjësendeve a të frymorëve, ai gjatë ligjërimit përdor format përemërore të rrjedhores: **ksi** djali nuk ka!; **ksi** çike na vyen me pasën; **çaso** darsme t madhe s mahet mën n katunin to:n; **ksi** xhinsh nuk ke pa;

çasi malli po lypi me gjetën. Dëgjohen dhe trajtat **ksish/ksishne; ksosh/ksoshne; asosh/asoshne; çasosh/çasoshne; asish/asishne**, etj.

Përemrat pronorë

81. Po të merremi me historikun e pronorëve të shqipes do të duhej t'i trajtonim këta në pikëpamje të zhvillimit e të evoluimit të tyre diakronik. Kjo çështje do të na çonte shumë larg, sepse studimet për ta janë aq të shumta e aq të ndryshme, sa do të duhej të bënim një studim të përgjithshëm të tyre, duke iu kthyer arritjeve dhe përfundimeve që kanë nxjerrë albanologët tanë më të mëdhenj në lidhje me përemrat pronorë. Mendoj që detyra ime është që në studimin tim të pasqyrojë format e përemrave pronorë që përdoren sot në të folmen e Petreshticës dhe ata herë-herë t'i krahasoj me trajtat e të folmeve fqinje të këtij fshati dhe me të folmet e gegërishtes verilindore.

Veta e parë njëjës e përemrit pronor të shoqëruar me emrin në të folmen e Petreshticës përdoret: **djali jëm, mali jëm, livadhi jëm**, siç po shihet në gjininë mashkullore njëjës, dhe: **çika jëme, motra jëme, nāna jëme, ara jëme; shpija jëme** – në gjininë femërore. Ndërkaq, kur përemri përdoret i pashoqëruar me emër dhe si i tillë substantivohet, pra merr funksionin e emrit, përdoret në formën: **i jëmi/ e jëmja**; dhanore: **tëmit, tëmës**; kallëzore: **tëmin, tëmën**; rrjedhore: **pej tëmit, pej tëmës**.

Veta e dytë: **djali yt, mali yt, livadhi yt, trupi yt, katuni yt**, dhe : **çika jote, motra jote, nāna jote, ara jote, shpija jote** etj. Kur përdoret i pashoqëruar me emrin na dalin trajtat rasore: **i yti / e jotja; tānit, tānës; tānin, tānes; pej tānit, pej tānës**.

Përdoren dhe përemrat **tuat** (kto sēne jān **tuat**), **t mijat** (ato jān **t mijat**); **t juvt** (kta mzet jan **t juvt**); **t juvet** (kto ara jān **t juvet**); **tonat** (arat jān **tonat**); **ta:nt**: ata djem jān **ta:nt**.

Për të parë më mirë pasqyrën e përemrave pronorë po japim këtu poshtë paradigmen e lakimit të tyre

Veta I njëjës

Prona e pronari njëjës, dhe vetëm përemri

Përemri pronor	jëm	jëme	
Em.	mali jëm / jëmi	ara jëme/	jëmja
Gj. i(e)	malit tëm / tēmit	i(e) arës tēme/	e tēmës
Dh.	malit tēm / tēmit	arës tēme/	tēmës
K.	kalin tēm / tēmin	arën tēme/	tēmën
Rrj.	pej kalit tēm / tēmit	pej arës tēme/	tēmës

Veta II shumës

Prona njëjës, pronari shumës, dhe vetëm përemri

Em.	mali jo:n / i joni	ara jo:n /	e jona
Gj. i(e)	malit to:n / i tonit	i(e) arës to:n /	e tonës
Dh.	malit to:n / tonit	arës to:n /	tonës
K.	malin to:n / tonin	arën to:n /	tonën
Rrj.	pej malit to:n / tonit	pej arës to:n /	tonës

Veta II

Prona e pronari njëjës , dhe vetëm përemri

Em.	mali yt / i yti	ara jote / jotja
Gj. i(e)	malit tån /tānit	i (e) arës tāne / e tånës

Dh.	malit tãn / tãnit	arës tãnë / tãnës
K.	malin tãn / tãnin	arën tãnë / tãnën
Rj.	pej malit tãn / tãnit	pej arës tãnë / tanës

Veta II

Prona njëjës, pronari shumës dhe vetëm përemri

Em.	mali jÿv / i juvi	ara juve / e juvja
Gj.	i(e) malit t jÿv / t juvit	arës t juve / t juves
Dh.	malit t jÿv / t juvit	arës t juve / t juves
K.	malin e jÿv / t juvin	arën e juve / t juven
Rj.	pej malit jÿv / t juvit	pej arës t juve / t juves

Përemri pronor **i jëmi - e mia**, të përdorur pas emrit

Prona njëjës – pronari shumës, si dhe vetëm përemri

Em.	djemt e mÿ / t mÿt	bijat e mia/ t mijat
Gj.	i(e) djemve t mÿ / t mÿve	i(e) bijave t mia/ t mijave
Dh.	djemve t mÿ / t mÿve	bijave t mia/ t mijave
K.	djemt e mÿ / t mÿt	bijat e mia / t mijat
Rj.	pej djemve t mÿ / t mÿve	pej bijave t mia / t mijave

Përemri pronor **e tu – e tua**

Em.	djemt tÿ / tÿt	bijat tua /tuat
Gj.	i(e) djemve tÿ/ tÿve	i(e) bijave tua /tuave
Dh.	djemve tÿ/ tÿve	bijave tua / tuave

K. djemt tũ/ tũt bijat tua / tuat
Rj. pej djemve tũ/ tũve pej bijave tua /tuave

Përemri pronor **ta:n** dhe **tona**, të përdorur pas një emri
Prona e pronari shumës, dhe vetëm përemri

Em. **burrat ta:n /ta:nt gra:t tona / tonat**
Gj. **i(e) burave ta:n /ta:nve i(e) grave tona / tonave**
Dh. **burrave ta:n /ta:nve grave tona /tonave**
K. **burrat ta:n / ta:nt gra:t tona / tonat**
Rrj. **pej burrave ta:n /ta:nve pej grave tona /tonave**

Përemrat pronorë **tuj - tuja**, të përdorur pas një emri

Prona e pronari shumës dhe vetëm përemri

Em. **burrat e juv / t juvt gra:t e juve / t juvet**
Gj. **i(e) burrave t juv / t juvve i(e) grave t juve / t juveve**
Dh. **burrave t juv / t juve grave t juve / t vuveve**
K. **burrat e juv / t juvt gra:t e juve / t juvet**
Rrj. **pej burrave t juv / t juvve pej grave t juve / t juveve**

Lakimi i përemrave të mbiemërzuar, të pashoqëruar me emra

i jëmi e jëmja

Em. **i jëmi e jëmja**
Gj. **i(e) tēmit i(e) tēmës**
Dh. **tēmit tēmës**

K. **tëmin**

tëmën

Rj. **pej tëmit**

pej tëmës

Përdoren dhe këto trajta të përemrave pronorë të shoqëruar me emra: **mali y:n, mali tijna; djemt e djelt e tijna; djali ju:j, vllavi y:n; vllavi ju:j ; djemt e djelt e juj (t jujt); motrat e juja (t jujat);** ai e martoi **çikën e vet/ motrën e vet;** e martova **motrën tëme;** hina **n shpǐ tëm;** ai hini **n shpǐ d vet** etj.

Llojet e përemrave të tjerë, meqenëse nuk paraqesin dallime nga të folmet e tjera , nuk po i shqyrtoj.

FOLJA

82. Sistemi foljor, me kohët, mënyrat, vetat dhe me zgjedhimin e llojeve të foljeve mund të them që meriton shqyrtim të plotë, të thellë e të hollësishëm në mbarë të folmet e gjuhës sonë për të parë dallimet dialektore si dhe dallimet brendapërbrenda secilës të folme të veçantë. Në këtë pikëpamje, edhe për sa i përket të folmes së Petreshticës, përdorimi i foljeve përbën strukturën kryesore të së folmes dhe me larminë që ka si brendapërbrenda këtij fshati, si në krahasim me të folmet e tjera të gegërishtes, këto meritojnë shtjellim të gjithanshëm. Gjatë pasqyrimin të formave të foljeve të të folmes së Petreshticës do të ndiejmë të nevojshme të krahasojmë gjendjen e tyre të sotme me format që kanë ekzistuar në gjuhën tonë në periudhat më të hershme të shkrimeve të shqipes në mënyrë që të konstatojmë edhe evoluimin që kanë pësuar ato shkallë-shkallë derisa kanë arritur në gjendjen e sotme. Me gjithë dallimet e mëdha që kanë pësuar të folmet dhe dialektet e gjuhës në lidhje me sistemin e foljeve, mund të themi që ato megjithatë kanë më shumë trajta të përbashkëta⁶².

Mënyra dëftore

83. Për sa u përket foljeve ndihmëse **kam** dhe **jam** bie në sy përdorimi i formës pësore *jam* në ndërtimet e kohës së kryer të mënyrës dëftore: **jam shkue**, **jam kân**, : pej Shtimes **jam a:rdh** n shpī, dhe jo **kam shkue**, **kam a:rdh**. Kjo formë mbizotëruese edhe në të folmet shqipe të Kosovës e përlij mendimin e shfaqur nga akad. Idriz Ajeti që këtu kemi të bëjmë me ndikimin e gjuhëve sllave të Ballkanit, “në të cilat ndihmëtarja *jam* është e vetmja folje që shtihet në punë në sajimin e kohëve analitike apo perifrastike”.⁶³ Një tjetër formë e këtyre foljeve ndihmëse që vlen të vihet në pah këtu është veta e tretë shumës, e cila del me tri

⁶² Shih : L. Mulaku, *vep. cit.*, f. 111.

⁶³ Dr. I. Ajeti, *Studime gjuhësore në fushë të shqipes, II*, Prishtinë, 1985, f. 279.

pamje: **je:m, jemi** dhe **jena**. Ndërkaq, veta e dytë shumës e këtyre foljeve dallohet me formën: **jini, kini** në krahasim me **jeni, keni**. Veta e tretë njëjës e foljes *jam* në të tashmen e dëftores na del herë me trajtën **āsht**, e herë e cunguar **ā**: a **ā** te ju nxët si te na?

Veta e dytë njëjës e foljes ndihmëse **kam**, sikurse në shumicën e të folmeve të Kosovës, edhe në këtë të folme zanoren e të temës **ke** (ti **ke**) e zbërthen në **ie**: **kie**. Të shtoj që këto trajta që i vura në pah për të folmen e Petreshticës përkojnë me shumicën dërrmuese të të folmeve të gegërishtes veriore e verilindore.

Shënim. – Folja **jap** Petreshticë dhe në fshatrat juglindore të saj në kohën e tashme të dëftores zgjedhohet nëpër veta, duke ruajtur temën në **a**: (unë) **ap**, (ti) **jep**, (ai) **ap**, (na) **apmi**, (ju) **jepni**, (ata) **apin**; **le t na apin**. Ndërkaq, në pjesën më të madhe të Drenicës, në trevën e Shalës së Bajgorës, në fshatrat e Vuçiternës, të Llapit e të Gollakut kjo folje përdoret në format vetore me temë në **e**: **jep, jep, jep, jepum, jepni, jepin**.

Grupi i foljeve konsonantike ose thënë më mirë foljet që në temë sosin në bashkëtingëllore, në vetën e parë njëjës të kohës së tashme të dëftores marrin mbaresën –i: **lypi, korri, lidhi, hapi, kapi, shkoçi, prishi, lagi, preki** etj. Me këtë tipar morfologjik kjo e folme u bashkohet të folmeve të gegërishtes verilindore.

Foljet **pi, di, rri, ha, zë** në vetën e dytë e të tretë njëjës më shpesh përdoren pa mbaresën mbështetëse vetore –n: ti, ai: **pi, di, rri, ha, ze**, dhe më rrallë me të: **pin, din, rrin, han, zen**.

Shënim. - Folja **zen** me format që ka në këtë të folme: **zā, zen, zen, zā:m, zini, zā:n**, shtrihet dhe në të folmet e tjera të fshatrave të Shtimes, të Lipjanit dhe vazhdon më tutje në anën juglindore të Kosovës e më gjerë, kurse në anën tjetër të Drenicës, të Vuçiternës, të Shalës së Bajgorës, të Llapit e të Gollakut kemi trajtën **nxā**: **nxā, nxen, nxen, nxām, nxeni, nxān**.

Disa folje, si **lyej, shkyej, rrej** e ndonjë tjetër në të folmen tonë në vetën e parë njëjës të kohës së tashme të dëftores përdoren pa mbaresa vetore: u:n ose une: **lye**,

shky:, rrë: Ky fenomen morfologjik shtrihet edhe në fshatrat e anës jugore të tij, domethënë të grykës së poshtme të Carralevës dhe mendoj që është një tipar specifik i këtyre fshatrave të Shtimes. Pa mbaresën vetore –j e kemi dëgjuar të përdoret edhe në formën paskajore: Nieri nuk ã mier **me rrë:** . Në të folmet fqinje, si në Shalë të Bajgorës, të fshatrave të Vuçiternës, të Llapit, të Gollakut etj., këto folje përdoren me mbaresën vetore –j: **lyej, çkyej, rrëj.**

Shënim. – Me parashtesën **sh-** në këtë të folme përdoren foljet: **shfryj, shlyj (<shlyej), shpërthej, shprish, shkarkoj, shkruj (<shkruej), shkep, shkoq, shkrij, shkapërderdh, shkokloj,** etj., me të cilën dallon nga pjesa më e madhe e Drenicës, nga të folmet e Vuçiternës, të Shalës së Bajgorës, të Llapit etj., në të cilat përdoret parashtesa **ç:** **fryj, lyej, çpërthej, çprish, çkarkoj** etj., dhe afrohet me të folmet që shtrihen në anën juglindore të Shtimes. Në këtë të folme edhe përemri pyetës **çka** dhe ai i pacaktuar **gjithçka** përdoren me sh: **shka** po thue? Kish pru: **gjithshka** dhe **shkamos!**

Foljet që mbarojnë në temë me bashkëtingëllore, si: **dal, fal, lidh, flas, marr, lyp, vjel, djeg, pjek** e shumë të tjera si këto në vetën e parë shumës të kohës së tashme të dëftores na dalin kështu: (na) **dalmi, falmi, lidhmi, flasm, marrmi, lypmi, mjelmi, djegmi, pjekmi.** Kjo formë nuk na del në shumicën e të folmeve të gegërishtes, po përdoret forma tjetër: **dalum, falum, marrum, lypum, mjelum, djegum, pjekum,** ose: **dalim, marrim, lypim,** etj.

Shënim. - Një formë foljore tjetër, që e dallon këtë të folme nga shumica e të folmeve të Kosovës dhe të gegërishtes verilindore në përgjithësi, është ajo me shtimin e **h-**së përpara foljes **eci:** **heci: heci, he:c, he:c, hecni, hecin.**

Foljet në diatezën pësore-vetvetore

84. Foljet tema e së cilave mbaron në bashkëtingëllore në vetën e parë njëjës në diatezën pësore-vetvetore dalin me mbaresën –na: **lidhna, lagna, terna, kçyrna,**

habitna, falna, përhapna, rrezitna, çethna, dridhna, etj. Ndërkaq, disa folje të tjera marrin mbaresën **-hna**, si: **kthehna, afrohna, gxohna, lyhna, lahna, rruhna, prehna, shkyhna, shkruhna, kruhna,** etj. Këto forma sot janë të përbashkëta për mbarë të folmet e gegërishtes verilindore, mirëpo nuk janë të vjetra. Në veprat e shkrimtarëve të vjetër të shekujve XVI – XVIII këto folje na dalin forma të tjera. Kështu, te Buzuku: **lyhem, gjegjem, sëmuhem, lahem etj.** Te Kazazi, i cili është për dy-tre shekuj më i ri, hasen format: **ruhena, mbahena.** Edhe L. Mulaku në studimin e tij për të folmen e Shalës së Bajgorës thekson që “Nga njerëzit e moshuar përdoret më shumë forma me **-ena/ -hena**: un **s lidhena**, un **msohena, kthehena, lodhena, unxhena**” (f. 114.). Mbështetur në këto të dhëna mund të supozojmë që edhe në të folmen e Petreshticës dikur mund të jenë përdorur nga brezi i njerëzve të moshuar forma të tilla foljore.

Me mjaft rëndësi për studimet dialektologjike në përgjithësi, dhe për të folmen tonë në veçanti janë format foljore që na kanë dalë në diatezën pësore-vetvetore, si: **krihna, vishna, dishna, rrihna, vritna; (unë) krihna, vishna, dishna, rrihna, vritna; (ti) krihesh, vishesh, dishesh, rrihesh, vritesh; (ai) krihet, vishet, dishet, rrihet, vritet : nuk vritet djali! ; (na) krihmi, vishmi, dishmi, rrihmi, vritmi; (ju) krihi, vishi, dishi, rrihi, vriti; (ata) krihen, vishen, dishen, rrihen, vriten : kur vriten vllaznia ner veti s ka gjã ma keç!**

E pakryera në diatezën veprare

85. Vështruar në diakroni që nga shkrimet e vjetra të gjuhës sonë e deri më sot, format e kohës së pakryer kanë pësuar ndryshime të vërejtshme si në të folmen që e kemi marrë objekt të studimit gjuhësor-dialektor, ashtu edhe në të folmet e tjera të gegërishtes në përgjithësi. Dihet që në gjuhën shqipe , në të dy dialektet e saj, që nga koha kur na shfaqet në formën e shkruar, përveç foljeve ndihmëse, të tjerat janë përdorur me mbaresat: **-nje, - nje, -n(te), -njim, -njit, -njin: punonje,**

punonje, punon, punonim, punonit, punonin. Më pastaj, në periudhën më të re të zhvillimit, duke filluar nga shekulli XVIII e këndeje në dialektin e gegërishten zunë të shfaqen format sigmatike të së pakryerës së foljeve: **punojsha, punojshe, punonte, punojshim, punojshi, punojshin.** Këto forma sigmatike të së pakryerës e kanë përfshirë kaherë edhe të folmen e Petreshticës, prandaj sot na dalin foljet me mbaresat: **-jshna, -jshe, -jke; -jshmi, -jshi, -jshin:** (un) **punojshna, bājshna, shkojshna, lajshna, korrsha, pritshta, vijshna, blejshna, këqyrshna, shihshna, milshna;** (ti) **punojshe, bājshje, shkojshe, lajshe, korrshe, pritshe, vishe, blejshe, këqyrshje dhe shifshje, milshje;** (ai) **punojke, bājke, shkojke, lajke, korrshe, pritshe, ardhke, blejke, këqyrke, shifke, milke;** (na) **punojshmi, bājshmi, shkojshmi, korrshtmi etj., (ju) punojshi, bājshi, shkojshi, korrshti;** (ata) **punojshin, bājshin, shkojshin, korrshtin etj.**

Shënim. – Nga pasqyra e mësipërme e vetave të foljeve, bien në sy veta e parë njëjës dhe ajo e numrit shumë **punojshna, punojshmi,** të cilat në shumicën e të folmeve të gegërishtes verilindore e veriperëndimore kanë format: **punojsha, punojshim / punojshëm/**

punojshum. Mbaretë e vetës së parë shumë në të folmen e Petreshticës, siç po vërehet, ka pësuar fenomenin e metatezës, nga **-jshim** në **-jshmi.** Në raste të rralla edhe në të folmet fqinje të Petreshticës, pra të arealit veriperëndimor mund të dëgjohen trajtat e foljeve me prapashtesën **-jshmi: punojshmi, shkojshmi, bājshmi.**

Foljet ndihmëse, ndërkaq, kanë këto forma të së pakryerës: (un) **isha, kisha,** (ti) **ishe, kishje,** (ai) **ish, kish** (na) **ishmi, kishmi** (ju) **ishi, kishi** (ata) **ishin, kishin.**

Foljet në kohën e pakryer në diatezën pësore-vetvetore

Në të pakryerën e diatezës pësore-vetvetore foljet e diatezës veprorë marrin përpara pjesëzën **-u:** **u lajshna, u lajshe, u lajke; u fajshmi, u lajshi, u lajshin;**

u lodhshna, u lodhshe, u lodhke; u lodhshmi; u shtrijshna, u shtrijshe, u shtrijke; u shtrijshmi, u shtrijshi, u shtrijshin; u krihshna, u krihshe, u krihke, u krihshmi, u krihshi, u krihshin; u rrihshna, u rrihshe, u rrihke, u rrihshmi, u rrihshi, u rrihshin; ; u vritshna, u vritshe, u vritke, u vritshmi, u vritshi, u vritshin, etj.

Shënim. Në të folmet e pjesës më të madhe të Drenicës, në Shalë të Bajgorës, në fshtrat e Vuçiternës, në anën e Llapit e të Gollakut trajtat e këtyre foljeve në të pakryerën e diatezës pësore-vetvetore përdoren kështu: **u shtrëjsha, u shtrëjshe, u shtrëjke, u shtrëjshum, u shtrëjshi, u shtrëjshin; u krehsha, u krehshe, u krehke, u krehshim, u krehshi, u krehshin; ardhshna, ardhshe, ardhke, ardhshum, ardhshi, ardhshin; nëjshna, nëjshe, nëjke, nëjshum, nëjshi, nëjshin, etj.**

E kryera e thjeshtë

Foljet ndihmëse **jam** dhe **kam** në kohën e kryer të thjeshtë të dëftores në të folmen e Petreshticës dhe përgjithësisht në të folmet e gegërishtes verilindore përdoren kështu:

(unë) **kesh**, (ti) **ke**; , (ai) **kë**, (na) **këm**, (ju) **kët**, (ata) **kën**;
(unë) **pata**, (ti) **pate**, (ai) **pät**, (na) **pätëm**, (ju) **pätt**, (ata) **pätën**.

86. Interes të veçantë për studimin tonë paraqesin format e foljeve supletive ose të parregullta **lë, shoh, bie** në kohën e kryer të thjeshtë, të cilat në vetën e dytë njëjës na dalin kështu: (ti) **lae, pae, rae; thae, dhae**. Format e këtilla tipike për të folmen e këtij fshati shtrihen dhe në krahun juglindor të tij, duke përfshirë fshatrat e Shtimes, të Lipjanit, të Ferizajt, të Kaçanikut, të Gjilanit dhe më gjerë, por jo të folmet e pjesës tjetër të Drenicës, të Shalës së Bajgorës, të Vuçiternës, të Llapit e të Gollakut, të cilat kanë në përdorim formën tjetër (ti) **lë, pë, rë, thë, dhë**.

Format e vetës së dytë njëjës të këtyre foljeve ashtu si gjenden në të folmen e këtij

fshati kanë rëndësi për faktin që ato na shfaqen me atë pamje edhe në veprat e autorëve të vjetër shqiptarë, Buzukut, Budit, Bogdanit etj., dhe në të folmen tonë mund të jenë relikte të shqipes së vjetër.

Grupi i foljeve me temë në bashkëtingëllore, si: **lag, mshel, çel, lidh, prek, lyp, nis, lodh** etj. në të kryerën e thjeshtë dalin pothuajse si në mbarë shqipen me ndryshimin e vetëm që kanë ato që sosin në konsonantet **k,g**, të cilat në vetën e tretë njëjës marrin mbaresën **i** në vend të **u-së**: **laga, mshela, çela, lidha, preka, lypa, nisa, lodha**; (ti) **lage, mshele, çele, lidhe, preke, lype, nise, lodhe**; (ai) **lagi, msheli, çeli, lidhi, preki, lypi, nisi, lodhi**, (na) **lagëm, mshelëm, çelëm, lidhëm, prekëm, lypëm, nisëm, lodhëm**; (ju) **lagt, mshelt, çelt, lidht, prekt, lypt, nist, lodht**; (ata) **lagën, mshelën, çelën, lidhën, prekën, lypën, nisën, lodhën**, etj.

Kohën e kryer të thjeshtë me zgjerim teme e kanë foljet: **ruej, buj, muj** (<mundem), **mbaj, baj, kaj**, etj., si: (un) **rujta, bujta, mujta, majta, bajta, kajta**, (ti) **rujte, bujte, mujte, gjete, majte, bajte, kajte**; (ai) **rujti, bujti, mujti, majti, bajti, kajti**; (na) **rujtëm, bujtëm, bujtëm, majtëm, bajtëm, kajtëm**; (ju) **rujt, bujt, mujt, gjet, majt, bajt, kajt**; (ata) **rujtën, bujtën, mujtën, majtën, bajtën, kajtën**.

Disa folje, si: **bluej, rruej, kryej, grryej, kruej, shkruej**, etj., vetat e tyre nuk mund të themi që kanë vetëm një formë të vetme, sepse ndonjëherë dalin edhe me një formë tjetër, si: (un) **blujta, rrujta, kryjta, grryjta, krujta, shkrujta**, dhe **blova, rrova** (t rrova m rrove, briski berberit), **shkrova, grreva**; (ai) **blujti** (dhe **bloi**), **kryjti** (dhe **kreu**), **krujti** (dhe **kroi**), **shkrujti** (dhe **shkroi**); (na) **blujtëm** (dhe **blu:m**), **rrujtëm** (dhe **rru:m**), **kryjtëm** (dhe **kry:m**), **grryjtëm** (dhe **grry:m**) etj.

Edhe grupi i foljeve apofonike, si: **mjel, mbjell, pjell, rjep, nxjerr, pjek, djeg, heq**, etj. nuk na del gjithëherë me forma të njëjta vetore në të kryerën e thjeshtë, si p.sh.: **mjela** dhe **mola**, **mjella** dhe **molla**, **rjepa** dhe **ropa**, **nxjerra** dhe **nxora**, **pjeke** dhe **poça**, **djega** dhe **doxha**, **hjeka** dhe **hoça**; (na) **poçëm, hoçëm**,

doxhëm. Pothuajse kështu na dalin këto folje edhe në vetat e tjera të njëjësit dhe të shumësit, prandaj nuk po e teproj me shembuj të tjerë.

Po përmendim edhe dy a tri folje të tjera, si: **pi, fryj, laj**, të cilat kanë nga dy forma vetore në të kryerën e thjeshtë: (unë) **pita** dhe **piva** u:j; **fryva** dhe **fryjta**, **lava** dhe **lajta**; (ti) **pite** dhe **pive**; **lave** dhe **lajte**; (ai) e **piti u:jt**; **fryni**, **fryjti** e **fryu**, **lau**, **lajti**; (ju) **pitët** dhe **pi:t** ; (na) **pitëm**, **lajtëm** dhe **la:m**, **fryjtëm** dhe **fry:m**; (ata) **pitën** dhe **pi:n** etj. Ndërkaq, folja **ziej** na del me këtë pamje: (unë) **zeva** (patatet, vezët), (ti) **zeve**, (ai) **zev**; (na) **zijtëm**, (ju) **zijt** , (ata) **zijten**.

Folja **zë** ka këto veta të së kryerës së thjeshtë: **zuna**, **zune**, **zuni**, **zu:m**, **zu:t**, **zu:n**.

Koha e kryer

87. Kjo kohë e mënyrës dëftore formohet me ndihmën e foljes **kam** në diatezën veprorë, dhe **jam** në diatezën pësore-vetvetore dhe me pjesoren e folës që bart veprimin: **kam punu:**, **kam dhã:n**, **kam thã:n**, **kam shkru:**, etj. , dhe: **jam kãn**, **je kãn**, **ãisht kãn** dhe **ã kãn**; **jena kãn**, **jini kãn**, **jãn kãn**; e kemi **pa:s** në mÿk n Belinc; At-her e **kam pa:s** lopën tëm; **kÿna pa:s** shumë pu:n ktyne hër; ti nuk **kë pa:s** xhã: d xha:ll!, etj. Me këtë pamje na dalin foljet në kohët e përbëra të së shkuarës në gegërishten verilindore, dhe në kuadër të tyre edhe në të folmen e Petreshticës.

Ndërkaq, në të folmet e gegërishtes veriperëndimore, në Malësi të Madhe dhe në Rugovë folja ndihmëse **jam** në kohët e përbëra të së shkuarës na del kështu: **jam kjën**, **je kjën** , **ã kjën** etj., dhe **kiesh kië:n** ; **kiesh shkua**, **kiesh a:rdh**, **kiesh ra:** etj.⁶⁴ .

Shënim. – Veta e parë shumë e foljeve të kësaj kohe na del herë me **kemi: kemi pa:s** e herë me **kÿna: kÿna pa:s**. Në këtë të folme dëgjohen të përdoren format e së kryerës me ndihmëset **kam** dhe **jam: jam a:rdh** dhe **kam a:rdh; jam shku:** dhe

⁶⁴ Shih: Gj. Shkurtaç, *E folmja e Hotit*, DSH, II, Tiranë, 1974, f. 387; Adem Hajdaraj, *E folmja e Rugovës*, Prishtinë, 1996, f. 134; Mehmet Ahmetaj, *E folmja e Anës së Malit*, Prishtinë, 2006, f. 161;

kam shku:

Koha më se e kryer

88. Më se e kryera formohet me foljet ndihmëse **kam**, përkatësisht **jam** në të pakryerën: **kisha/ isha** dhe me pjesoren e foljes që bart veprimin, si p.sh.: (unë) **i kisha thān, kisha dhān**; a ti i **kishe thān** djalit mos shko atje a?; (ai) A ai nuk e **kish lān** djalin me pre: dru: n mal a? ; Hasani **ish a:rdh** pej Shtimes n katun! ; Ai **ish çue** heret, etj.

Koha e kryer e tejshkuar

89. Kjo kohë, si në mbarë shqipen, formohet me foljet ndihmëse në të kryerën e thjeshtë **pata**, përkatësisht **kesh**, dhe me pjesoren e foljes kryesore. P.sh.: **pata punu**: xhith ditën, kur **pate a:rdhën** ti n akshām me nëjt te na!, ai **ke dalën** n māl!; Ai e **pat ma:rr** me zōr se z dojke me i shku: përmas!, etj.

Koha e kryer e dytë

90. Përdoren këto forma të foljeve në kohën e kryer të dytë në të folmen e Petreshticës: **ka pas ndo:dh**; t **kam pas lān** d vogël, e ti **ke pas ka:jt**, se **je kån mërzi:t!**; Mas nī kohe ta **kam pas çu**: nī letër pej asqeri!, etj.

Koha më se e kryer e dytë

91. Gjatë bashkëbisedës dhe përpjekjeve që bën studiuesi për të nxjerrë format foljore të kësaj kohe, ato dalin shumë rrallë. Mënyra më e përshtatshme për t'i nxjerrë nga subjekti format foljore të kësaj kohe është kur kërkohet që ai të na tregojë në bashkëbisedë të lirë ngjarje nga e kaluara e tij jetësore. Në këtë mënyrë,

unë kam arritur të shënoj këto forma foljore në kohën më se të kryer të dytë në të folmen e Petreshticës: **ishna kãn habi:t** tu j këy:r kah prashitshin; Ti **ishe kãn shkue** atje pa e ditën une; Ti **ishe kãn dalën**, e une **kishna pãs me:t** mrëna; **kishna pãs harru:** ; **ishna kãn lo:dh** shumë, e m **kish pãs zã:n** xhumi, ja **kish pãs ma:rr** çikën; Ti **kishe pãs rrë**, e une vo:n e kam ma:rr vesh; Ti i **kishe pãs thanën** dishka Hajdarit për mue, etj.

Koha e ardhme

92. Në të folmen e Petreshticës përdoren tri forma të së ardhmes së foljeve:

- a) Forma me foljen ndihmëse **kam + paskajorja** e foljes kryesore: **kam me mjellën, kam me korrën, kam me punu:** etj.;
- b) Forma me foljen **due** (< **do**) + paskajorja e foljes: **due me dalën** pak jasht; **due me lidhën** duej; **due me he:c** pej shpijes; **due me fo:l** edhe une dishka; **due me ma:rr** avdes etj.;
- c) Forma me **do** + lidhoren e foljes kryesore: **do**

t heci/ do t shkoj/ do t dal pak jasht/ **do ta mjellum** arën me kumpira/ me emër d zotit nesër **do t shkoj** te miki etj.

Ndër këto tri forma të kohës së ardhme mbizotëron ajo e para, do të thotë forma me **kam + paskajorja**: **kam me punu;** **kam me mjellën** , e cila është kryesorja edhe e të folmeve të tjera të arealit të gegërishtes veriore dhe verilindore. Ndërkaq, po theksoj që forma me **do + lidhorja**: **do t heci, do t shkoj** etj. përdoret shumë më rrallë. Forma tjetër: **due + paskajorja**, si p.sh. **due me he:c**; une **due me shkue**; a **doni me a:rdh** edhe ju?; **due me shkue me ma:rr** në kerr dru:, e ti a **do me a:rdh me m nimue?** etj., përdoret mjaft shpesh në këtë të folme.

Mënyra lidhore

Koha e tashme

Foljet në format e lidhore dëgjohen rrallëherë në të folmen e Petreshticës, sikurse që përdoren rrallë edhe në të folmet e tjera të gegërishtes verilindore⁶⁵ dhe veriperëndimore. Po i paraqesim, prandaj, ato pak raste të përdorimit të formave të lidhores ashtu si i kemi regjistruar gjatë bisedave me subjektë të këtij fshati: masi po shkoni n shko:ll, **t msoni** bile sa ma shumë që **t dini** dishka; **t puno:jm** sa është fllad, e kur d zhegitet pusho:jm; Bjeri ksaj udhe, e kur **t shkojsh** te ura, ktheu n dja:tht e udha **t çet** dogri te shpija Alijes; Mus e lësho udhën deri **t mrrish** n Carrale:v; **Ta kapërce:jm** niher çit kodër, e pusho:jm pak; Sa **t kini** me hājër, mier i kini pu:nt, etj.

Përveç këtyre formave të lidhores, i kemi dëgjuar edhe edhe disa forma me pjesëzën **le** përpara që cyt veprimin, dëshirën ose lejimin e veprimit të foljes: Sall **le t jemi** shnosh se bëhet mi:r me emër d Zotit; **le t jet** shnosh se edhe shpi:n e nre:ç; ne t jen shnosh se tana bahen!, **le t del** pak përjasht se flladitet e i kapërcen munimi etj.

Disa forma të lidhores me ngjashmërinë që kanë me format e dëftores së kohës së tashme, munt të jenë përftuar në të folmen e Petreshticës dhe në të folmet e tjera të gegërishtes verilindore nën ndikimin e tyre, si p.sh.: **le d vjen** edhe ky me juve deri atje; **le t shkon** edhe kë me sho:k; **le t punon** edhe aј sa rrin xhith ditën n shpǐ; **le t han** sa t i hahet etj.

Koha e pakryer e lidhores

Edhe format e kësaj kohe përdoren rrallë në të folmen e Petreshticës dhe në të folmen e fshatrave fqinje. Qe disa shembuj të përdorimit të saj: **t shkojshna** edhe un me ta, ishim kthye ma shpejt; **t shkojshin** sa s kë terrue, ma mır se tash çі po shkójn natën; **t ardhshin** shnosh, s ishëm mērzit për tjetër sēn; **t punojshna** me

⁶⁵ Shih: L. Mulaku, *vep. cit.*, f. 123,124; B. Beci, DSH, I, 298; Gj. Shkurtaj, DSH, 55; B. Mehmetaj, E *Folmja e Deçanit me rrethinë*, Prishtinë, 2006, f. 99; L. Mulaku – M. Bardhi, *Mbi të folmen e Peshterit*, GJA, f. 72,74.

vllavin ma mír m kish ra: ; **t flējshin** deri u zditke etj.

Më se e kryera e lidhores

Edhe kjo kohë e lidhores përdoret rrallë në këtë të folme. Megjithatë, nuk mungojnë rastet e përdorimit të saj, si p.sh.: **T ishna shkue** edhe une me tã, nuk ishin vonue kaç shum; **T na kishin dhãn** me hãnjër, ma shum kishim punue; **T i kishna thãn** bile dishka, nuk um **kish me:t** hatri pej tina; **Ta kish kçy:r** sa ã kãn smu:t, nashta kish rrue edhe nej dît, etj.

Mënyra kushtore

Format e kushtores ashtu si përdoren në të folmen e Petreshticës dhe në dialektin e gegërishtes përgjithësisht paraqesin dallime prej të folmeve të toskërishtes. Them kështu për arsye, sepse në të folmen e këtij fshati dhe përgjithësisht në të folmet e tjera të gegërishtes, format e mënyrës kushtore përdoren me foljen ndihmëse në të pakryerën, pra **kisha** dhe **me paskajoren e foljes që bart veprimin**, si p.sh.: **kisha me bajtën ; kisha me dalën; kisha me dhãnën** etj., ndërkaq në toskërishten kjo mënyrë formohet me pjesëzën **do** dhe **me të pakryerën e lidhores: do të bartja, do të dilja, do të bëja, do të shkoja** etj., të cilat forma të toskërishtes përdoren sot në gjuhën tonë të përbashkët letrare.

Qe disa shembuj:

Une t ishna kãn n vën tãnin, pa fo:l dishka s **kishna me lãnën; T um kish kallu:** me vakt, s **kishna me u mërzitën; T um kish thã:n** a po vjen edhe ti, **ishna shkue**, etj.

Siç e ka vënë re me të drejtë L. Mulaku në studimin e tij për të folmen e Shalës së Bajgorës⁶⁶, edhe në të folmen e Petreshticës përdoren format e thjeshtuara të mënyrës kushtore: **kishna folën, kishna lidhën, kishna thãnën**, pra pa pjesëzën **me**. P. sh.: **T kish thãn** aÿ dishka, **kishna thãn** edhe une, se kam pasën shka me thãnën bõll; **Ta kish lãnën** aÿ me çaç, e **kishna lãnën** edhe un; Mus **t kish fo:lën**

⁶⁶ Shih, L. Mulaku, *vep. cit.*, f. 124,125.

aj, edhe une **ishna durue**, e s e **kishna çelën** gojën etj.

Mënyra dëshirore

Dijetarët dhe studiuesit më të shquar që janë marrë me çështjen e dëshirores së shqipes e konsiderojnë këtë mënyrë të foljes si një formin të brendshëm të gjuhës sonë, e cila nuk ka ngjashmëri me asnjërën nga gjuhët fqinje⁶⁷. Kjo mënyrë e foljeve, nëpërmjet së cilës folësi shfaq dëshirën e tij për çështje të ndryshme që e interesojnë, në të folmen tonë na shfaqet në dy kohë:

- a) Në të tashmen, dhe
- b) Në të kryerën

Koha e tashme e foljeve të mënyrës habitore përdoret shumë më shpesh në krahasim me kohën e kryer, e cila përdoret më rrallë.

Shembuj të përdorimit të foljeve në kohën e tashme të dëshirores në trajtën veprorë: **rrnofsh!**; Mír **vofsh!**; **Vofsh** si je ni:s!; **Paçi** kāmën e ma:r!; **Kofshi** shnosh!; Bereqet **paç!**; Xhithmo:n **pa:st!**, **Kofshi** shnosh!; Mi:r **vofshi!**; **Kofshi** faqeba:rdh! etj.

Ja dhe format e dëshirores në diatezën pësore-vetvetore : **u guxofsh!**, Zoti ju **gxo:ft!** ; **u guxofshi** qi na pshtuet!; **u guxofshin!** ; **rrnofsha!**; **rrnofsh!**, **rrnoft!**; **rrnofshi!**, **m i marrsh** t ligat!; **U rritsh** me faqe d ba:rdh!; Zoti ju **la:sht** shnosh!; Zoti **d dha:sht** bereqet!; Zoti **ju ardhhtë** hakesh!; **U rritsh** e **u bāfsh** plāk me mjekër! , etj.

Koha e kryer e dëshirores

Edhe koha e kryer e mënyrën dëshirore përdoret mjaft shpesh në të folmen e Petreshticës. Qe disa shembuj: T'i **past ma:rr** t ligat; **E paçin gje:t** çysh e **paçin ly:p!**; **Ta paça fa:l** hakun!; **Ta paça dhān** besën! , etj.

⁶⁷ Shih për këtë mënyrë foljore: Sh. Demiraj, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe (Pjesa II)*, Tiranë, 1976, f. 136-138; M. Domi, *Morfologjia historike e shqipes*, Prishtinë, 1969, f. 72,73.

Mënyra habitore

Funksioni i kësaj mënyre, siç vetëkuptohet është habia që shfaq folësi duke shfaqur qëndrimin e tij ndaj frymorëve a gjësendeve që e rrothojnë. Mënyra habitore e foljeve përdoret shumë shpesh në të folmen e Petreshticës si dhe në të folmet e gegërishtes përgjithësisht. Me këtë rast po theksojmë që mënyrën habitore e kanë përdorur në masë të madhe autorët e veprave të vjetra të shqipës, madje në më shumë forma dhe në më shumë kohë se që përdoret sot në të folmet e gjuhës sonë.

Në të folmen e Petreshticës kjo mënyrë e foljeve përdoret në tri kohë:

- a) Në kohën e tashme;
- b) Në kohën e pakryer;
- c) Në kohën e kryer

Koha e tashme e foljeve në mënyrën habitore

Foljet ndihmëse **kam** dhe **jam** në të tashmen e habitores dalin me format inversive, të ndërsjella me anë të metatezës **kam + pasunë > paskam**, përkatësisht **kam + qenë > qenkam**, mirëpo duke e humbur ë-në e pjesores, si dhe duke marrë forma dialektore: (un) **paskna**, (ti) **paska**, (ai) **paska**, (na) **paskmi**, (ju) **paskni**, (ata) **paskan**, dhe (un) **kokna**, (ti) **koke**, (ai) **koka**, (na) **kokmi**, (ju) **kokni**, (ata) **kokan**.

Folja që përdor folësi në kohën e tashme të habitores karakterizohet me pjesëzën **po**, e cila përdoret bashkë me foljen që bart veprimin dhe i paraprin asaj, si p.sh. Shëm **po folkan!**; **po bājkan** zhurum!; **po punojkan** kadall!; Nuk **po hājka** kurrxha! **Po nirthka** shëm!; S **po niejke** mi:r!; Po **bujkan** sântel!; **Po ardhkan**

mas darke me në:jt!; **Po shkojkan** herët n mäll!; **Po lypka** rre:h! , **Po këyrka** shtrëmt!, etj. Ka disa raste në të folurit ekspresiv të subjektit që pjesëza **po** ngjitet me trajtën e shkurtër të përemrit **e** (<atë), pra: **po + e > pe**, dhe **pje** : Çit pu:n nuk **pe (pje) dishna**, ti nuk **pe (pje) dishe**, ai nuk **pe (pje) dika**, na nuk **pe (pje) dishmi**, ju nuk **pe (pje) dishi**, ata nuk **pe (pje) dishin** etj.

Koha e kryer e habitores

E kryera e habitores formohet nëpërmjet ndërrimit të vendit të foljeve ndihmëse të së kryerës **kam qenë> qenkam** në formën dialektore kokna dhe me foljen që bart veprimin: **kokna lo:dhën** sod shumë tye punu:, përkatësisht **kam pasunë < paskam** , në formën dialektore **paskna** dhe me foljen kryesore, p.sh.: **paskna fo:l** dishka n xhu:m; **paskna harru:** qi sod është e xhumã:!: N Shkodër i **paska pa:s** da:jt! ; **koke çue** n kräh t shmájt sod!; **i paskan çue** msitt me ma:rr fjalën e nuses!; etj.

Mënyra urdhërore

Format e mënyrës urdhërore ashtu si përdoren në të folmen e Petreshticës nuk paraqesin ndonjë dallim të veçantë prej të folmeve të tjera të gegërishtes verilindore, e as dallime të theksuar prej të folmeve të mbarë shqipes. Edhe në këtë të folme ato, në pikëpamje të funksionit që kanë, folësi i përdor për ta urdhëruar a për ta catur personin a personat, të cilëve u drejtohet që të veprojnë ashtu si dëshiron ai, p.sh.: **fol!, folni!**

Siç shihet, folja në mënyrën urdhërore ka vetëm forma gramatikore të kohës së tashme, por ka, gjithashtu vetëm vetën e dytë të njëjësit dhe të shumësit, p.sh.: **shko!**, dhe **shkoni!**, **puno!**, dhe **punoni!**, **pi!**, dhe **pini!**, etj. Këto folje, si dhe disa të tjera si: **pi!**, **pini!**, **rri!**, **rrini!**, **ha!**, **hani!**, **dil jasht!**, **dilni!**; mos **merr!**, **merrni !** etj., nuk kanë fare dallimi në asnjërën nga të folmet e shqipes.

Një dallim dialektor që e karakterizon të folmen e Petreshticës së bashku me të folmet e gegërishtes verilindore e veriperëndimore prej të folmeve të gegërishtes

jugore dhe prej atyre të toskërishtes për sa u përket formave të urdhërores së foljeve të vetës së dytë shumës është pjesëza përemërore –u e disa foljeve, p.sh.: **hap- u-ni!**, e cila zhvendoset në fund të foljes: **hapnu!**, **lanu!** (<lah-u-ni), **vishnu!** (< vish-u-ni), **çonu!** (<çoh-u-ni), **kapnu!** (<kap-u-ni) etj. Në këtë të folme janë karakteristike këto forma të urdhërores: **epja!**, **epnja!**; **bërtitnju!**; **leë!**; **lenë!**; **theë!**; **thenë!**; **préje!**, **prénë!**; **dájë!**, **dánë!**; **vnoe!**; **vnone!**; **avitu!**; **avitnu!**; **zine!** ; **zini!**; **bïma!** (edhe **bjerma!**)do u:j!; **bimna!** (edhe **bjermna!**) do u:j!; **unxhu!** (edhe **ulu!**) dhe **unxhnu!**.

Edhe format foljore të mënyrës urdhërore që përdoren në gjuhën standarde me trajtën e shkurtër të përemrit dëftor –e- (<atë), ndërmjet temës së foljes dhe mbaresave të saj si: **hap-e-ni** (derën, dritarën); **korr-e-ni** (grnin/grurin), **mil-e-ni** (lopën) etj., në të folmen tonë trajta e shkurtër –e- e përemrit dëftor zhvendoset në fund: hapne (derën), korrne (grunin) , **milne** (lopën), çitne plehin n a:r etj.

Shënim. – Folja **zë** në vetën e dytë shumës të urdhërores në të folmen e Petreshticës përdoret sikurse në gjuhën standarde të shqipes, **zine!** . Kjo folje në shumë të folme të Kosovës në urdhërore përdoret në formën **nxãne!**

Format e pashtjelluara

Pjesorja

Sikurse në një numër të madh të të folmeve të gegërishtes, edhe në të fomen e Petreshticës trajtat e foljeve në pjesore na dalin të reduktuara, të thjeshtuara, sepse nuk i kanë ruajtur format e plota që i kanë pasur. Për dallim nga format e ndryshuara të pjesores që kanë të folmet e gegërishtes, si pasojë e ndryshimeve dialektore dhe si rrjedhojë edhe e disa faktorëve të tjerë, të cilët me këtë rast nuk do t'i shtjellojmë, të folmet e toskërishtes në gjendjen e sotme i kanë ruajtur të plota dhe të ndryshuara trajtat e pjesoreve të foljeve. Po shtojmë që edhe shkrimtarët e vjetër gegë të shekujve XVI – XVIII, Buzuku, Budi, Bardhi, Bogdani, Kazazi etj. i kanë të plota në veprat e tyre trajtat e pjesoreve të foljeve.